



Editorial: "Një herë UBT – gjithë jetën UBT"

Faqe 2

UBT me numër rekord të të punësuarve në sektorin privat të arsimit të lartë

Faqe 6



Akademitë verore mbledhin qindra ekspertë, zgjojnë interesim të madh




Faqe 10 -17

Rrëfime sukcesi të studentëve të UBT-së



Faqe 18-23; 33 -39

UBT nderon gazetaren e njohur të DW, Adelheid Feilcke



Faqe 6

Kosova zë vendin e parë në shtetin që nuk na e ka njohur pavarësinë



Mbi 1000 pjesëmarrës dhe 400 punime në Konferencën Ndërkombëtare të UBT-së

(faqe 4-5)

Editorial

Edmond Hajrizi

Një herë UBT – gjithë jetën UBT

UBT po e përmbyll vitin 2018 me rezultatet kulmore në të gjitha fushat dhe po bëhet gati të hyjë në vitin e radhës, për t'i shtuar këto rezultate e për të depërtuar në fusha të reja, nismëtar si gjithnjë në këto 17 vite të funksionimit.

E një nga shtyllat më të rëndësishme të rezultateve dhe rritës së UBT-së janë pikërisht studentët. Në institucionin tonë vlen dhe vlerësohet lart maksima "Një herë UBT – gjithë jetën UBT". Kjo për faktin se, që nga dita kur regjistrohen në studime, studentët tanë në çdo hap e ndjejnë kujdesin dhe rëndësinë që UBT u kushton atyre.

Nuk janë vetëm planprogramet e përzgjedhura e mësimdhëniesit e përgatitur për punë me studentët sipas metodave moderne të mësimdhënies. E gjithë infrastruktura e UBT-së është e ndërtuar në mënyrë që studentëve t'u krijohen mundësi sa më të mëdha për përgatitjen e tyre profesionale.

Literatura e fundit, bibliotekat më të mëdha e më të pasura, laboratorët për punë praktike, në të gjitha fushat e studimeve që ofrohen në UBT, vizitat studimore brenda dhe jashtë vendit, përcjellja dhe simulimi i punës profesionale e shumë mundësi të tjera u ndihmojnë studentëve tanë që të përgatiten për tregun e punës. Dhe kjo nuk është një përgatitje dosido. Ata janë, pa asnjë dyshim, studentët më të përgatitur. Dëshmi për këtë janë garat dhe konkurset ku gjithnjë në disa vende të para janë studentët e UBT-së, pastaj vijnë të tjerët. Është tashmë e vërtetuar se studentët tanë janë të veçantë dhe ndryshe nga të tjerët.

UBT-në e dallojnë nga të tjerët edhe dy elemente shumë të rëndësishme: punësimi i studentëve ende pa i mbaruar studimet, si dhe, ajo që duhet theksuar gjithmonë me krenari, që UBT prin në nivel vendi e ndoshta edhe më gjerë me shkallën e punësimit të të diplomuarve.

Statistikat këtu janë bindshëm në anën tonë. Por, ka edhe një element shumë të rëndësishëm, që UBT-në e bën edhe më të veçantë – punësimi i studentëve të UBT-së në UBT. Ndërsa UBT prin bindshëm me numrin e stafit të punësuar, me dallim të madh nga institucionet e tjera, janë dhjetëra të punësuar në institucionin tonë që janë bërë pjesë e mësimdhënies ose punës administrative sapo kanë kryer studimet në UBT.

Për ne, kjo paraqet një vlerë shumë të mad-

he. Janë njerëz që kanë regjistruar studimet në UBT, me shumë ëndrra për të ardhmen. Por, që i kanë përfunduar studimet dhe janë punësuar brenda institucionit, pa e kaluar stresin e kërkimit të një vendi të punës në tregun e parregulluar dhe me shumë probleme të Kosovës.

Me krenari shikojmë studentët tanë që janë bërë pjesë e stafit akademik, pjesë e ekipeve mbështetëse të punës akademike dhe humltuese të UBT-së, autorë projektsh e novacionesh, drejtues të mediave të UBT-së... Mirëpo, ata nuk janë ndalur asnjëherë në ngritjen e mëtejme profesionale dhe UBT ka qenë gjithnjë në krah të tyre, duke u krijuar lehtësira për shkallët e mëtejme të studimeve master brenda institucionit.

Por, UBT ka edhe një karakteristikë tjetër. Mundësuar nga marrëveshjet e shumta të bashkëpunimit me universitet më të rëndësishme anekënd globit, UBT u ka mundësuar dhjetëra ish-studentëve të vet regjistrimin dhe kryerjen e studimeve të doktoratës.

Nuk ka ndjenjë më të mirë sesa kur sheh se një student i UBT-së, që vite më parë ka nisur studime me drojë e dilema për të ardhmen, kthehet po në UBT me titullin doktor shkence, të fituar në SHBA, në Angli, në Austri, në Hungari, në Shqipëri, në Maqedoni e në vende të tjera.

Ata e nisën rrugëtimin në UBT, duke e parë këtë institucion si të ardhmen e tyre. Sot janë krenaria dhe e ardhmja e UBT-së!

Për 17 vite me radhë, UBT e vuri studentin në radhë të parë. Këtë do të bëjë gjithnjë, sepse kjo është rruga e suksesit të përbashkët – rruga e dijes, e vlerësimit të vetvetes, e suksesit ndërkombëtar. Rrugë e dëshmuar dhe e vlerësuar: për studentin që menjëherë e kupton se ka bërë zgjidhjen e duhur kur është bërë pjesë e UBT-së; për UBT-në, që është adresa numër një e partnerit të institucioneve ndërkombëtare të arsimit nga e gjithë bota; për institucionin që, me të drejtë, numëron dhe krenohet me sukseset e studentëve të tij.

Në emër të institucionit që vlerëson lart studentët dhe që vlerësohet prej tyre:

Përgëzime për vitin e zgjerimit dhe afirmimit – 2018!

Fat e shëndet në vitin në të cilin qysh tash kemi bërë planet për ta bërë më të madh dhe më të vlerësuar UBT-në.

Gëzuar 2019!



IMPRESUM

UBT News – gazetë e studentëve

Botues: Edmond Hajrizi

Numrin e përgatitën: Jehona Kapllani, Anisa Rada, Edona Jerliu, Fatbardhë Kiqina dhe studentët e Media dhe Komunikimit

Adresa: www.ubt-uni.net / Tel: 038 541 400, 044 541 400

Përgatitje grafike: Milot Reçica

Në Baku të Azerbajxhanit

Kosova zë vendin e parë në shtetin që nuk na e ka njohur pavarësinë



UBT ka arritur ta prezantojë Kosovën me 15 punime shkencore dhe një delegacion shumë të përgatitur profesionalisht në edicionin e 18-të të konferencës "TECIS 2018" organizuar nën ombrellën e IFAC (International Federation of Automatic Control), që u mbajt në Baku të Azerbajxhanit

Si të vetmit pjesëmarrës nga Kosova, duke pasur parasysh rrethanat politike për shkak të mosnjohjes së pavarësisë së Kosovës nga ky shtet, Qeveria e Azerbajxhanit ka ndihmuar në lehtësimin e procedurave për pjesëmarrësit nga Kosova. Në këtë konferencë shpërblehen edhe shkencëtarët e rinj më të mirë dhe nga qindra punime shkencore u zgjedhën pesë më të mirat, e që në këtë listë të ngushtë ia dolën të hynin dy punime nga UBT, të realizuara nga ligjëruesit, Valmir Hoxha dhe Ines Bula, me ç'rast kjo e fundit u shpall "Shkencëtarja më e mirë e re". Me këtë, UBT dëshmoi jo vetëm që është pranues, por edhe partner i barabartë në

dhënien e kontributit për ngritjen e vlerave shkencore në botë. Rezultatet e arritura të UBT-së bënë që Kosova të jetë kandidat për mbajtjen e konferencës së radhës "TECIS", teksa të njëjtën konferencë UBT e ka organizuar edhe tri herë të tjera ndër vite. Delegacioni nga UBT zhvilloi edhe disa takime me përfaqësues të universiteteve të atjeshme, me të cilët u pajtuan për fillimin e bashkëpunimeve të reja ndëruniversitare. Deri tani, UBT ka mbi 300 institucione partnere dhe këtë mundësi e ka shfrytëzuar për të ushtruar diplomaci edhe tek vendet që nuk e kanë njohur ende Kosovën si shtet

Ligjëruesja Ines Bula sjell në Kosovë titullin e shkencëtares së re më të mirë



Ish-studentja e UBT-së, tash ligjëruese, PhD Cand. Ines Bula është përzgjedhur si shkencëtarja e re më e mirë në konferencën ndërkombëtare "TECIS 2018, duke lënë kështu prapa shkencore qindra shkencëtarë nga 38 vende pjesëmarrëse, të cilët u mblodhën në Baku të Azerbajxhanit për të shfaqur kërkimet dhe gjetjet e tyre shkencore. Ky çmim ka ardhur si rezultat i punës së saj shkencore në temën "Robotët nga mbetjet mekatronike- Roboti Lypsar", që është njëherësh edhe temë në kuadër të studimeve të doktoratës.

Roboti Lypsar si produkt i këtij hulumtimi është kryer tërësisht në laboratorët e UBT-së, me ndihmën e rektorit të UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, ligjëruesit Valmir Hoxha dhe disa studentëve të Fakultetit të Mekatronikës në UBT.

Punimi propozon një mundësi të re të përdorimit të mbetjeve mekatronike, që është ndërtimi i robotëve, ide e cila është mbështetur dhe pëlqyer nga mbarë komiteti shkencor i konferencës, që ndikoi që edhe të përzgjidhej si më i miri.

Këta robotë janë të orientuar në kosto të ulët, janë funksionalë për kërkesa të ndryshme, ndihmojnë në procesin e edukimit dhe që ndihmojnë në ruajtjen e ambientit,

përmes futjes në funksion të mbetjeve mekatronike.

Të gjitha këto kanë ndikuar në krijimin e një modeli të ri mbi atë se si mund të fillojmë të marrim pjesë nga niveli individual në krijimin e strategjive të reja të trajtimit të mbeturinave mekatronike.

Vetë autorja, Ines Bula thekson se pa mbështetjen e UBT-së nuk do të mund të arrinte këto rezultate, të cilat dëshmojnë për nivelin e lartë të të bërit shkencë në UBT.

"Si studente e mëhershme e nivelit mastrë në fushën e mekatronikës, kam pasur përkrahje të vazhdueshme nga ana e rektorit, jo vetëm si pjesë e ekipit të UBT-së, por më është mundësuar zhvillimi i mëtejshëm i doktoratës në Universitetin Teknik të Vjenës, ku me njohuritë e përfituara atje do të ndihmojë në zhvillimin akademik të gjeneratave të reja", tha Bula.

UBT ka arritur ta prezantojë Kosovën me 15 punime shkencore dhe një delegacion shumë të përgatitur profesionalisht në edicionin e 18-të të konferencës "TECIS 2018", teksa dy nga këto punime, nga pesë gjithsej, kanë qenë të nominuara për çmimin "Shkencëtarja më e mirë e re".



UBT, përsëri i pari në Kosovë për cilësi

UBT është ricertifikuar me standardin më të ri dhe më të njohur në botë për menaxhimin e cilësisë, ISO 9001:2015, dhe me këtë bëhet institucioni i parë dhe i vetëm arsimor në Kosovë dhe rajon që e përmbushë një kriter të tillë.

Ky është treguesi më i qartë për nivelin e lartë të cilësisë që e posedon UBT tash e 17 vite.

Për të matur e verifikuar standardin e cilësisë, në UBT ka qëndruar për një javë auditori austriak, Wolfgang Fest, i cili pas matjeve dhe auditimeve të bëra, konstatoi se UBT i ka të përmbushura të gjitha kriteret që kërkohen nga standardi ISO 9001:2015, i cili që nga gushti do të jetë edhe i vetmi version.

Ky standard bazohet në një numër parimesh të menaxhimit të cilësisë, duke pasur në fokus të qartë marrësit e shërbimeve, motivimin dhe implikimin e menaxhmentit të lartë, qasjen e procesit dhe përmirësimin e vazhdueshëm, lidhshërinë, menaxhimin e dijes, menaxhimin e riskut, e shume kriterëve të tjera në bazë të praktikave më të mira në botë.

Me plotësimin e këtij standardi, UBT vazhdon të mbetet model dhe shembull për institucionet e arsimit, bizneset dhe institucionet qeveritare, për menaxhim dhe organizim modern, duke ofruar cilësi konform vlerave dhe kriterëve më të larta evropiane dhe ndërkombëtare. E tërë kjo arritje dhe vlerësim ndërkombëtar më së miri dëshmohet edhe nga rezultatet e punësimit dhe zhvillimit të studentëve, alumnit dhe stafit, kështu duke dëshmuar tërë kohën që UBT është e studentëve dhe po ndihmon në zhvillimin e Kosovës

Konferenca e shtatë Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion

Mbi 1000 pjesëmarrës dhe 400 punime shkencore pasuruan Konferencën Ndërkombëtare e UBT-së për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion



Edicioni i shtatë i Konferencës Ndërkombëtare për Shkencë, Teknologji, Biznes dhe Inovacion mbylli punimet pas tri ditësh intensive me aktivitete të shumta.

Përveç numrit rekord të pjesëmarrësve dhe punimeve të prezantuara, veçoria e kësaj konference të shndërruar tashmë në traditë, ishte organizimi për herë të parë në Kosovë. Në këtë mënyrë, konferenca u shndërrua jo vetëm në një organizim ku u paraqitën punime shkencore, por edhe në një platformë të ndarjes së ekspertizave në fusha të ndryshme, lidhjes së bashkëpunimeve ndërmjet hulumtuesve shkencorë dhe sidomos, ndikoi pozitivisht në promovimin e kapaciteteve njerëzore dhe natyrore të Kosovës përpara partnerëve ndërkombëtarë.

Kjo konferencë mbledhi afër 1200 pjesëmarrës, mbi 700 hulumtues shkencorë, prej të cilëve 233 ndërkombëtarë. Pjesëmarrësit vinin nga 24 shtete të botës dhe katër kontinente të botës.

Punimet u vlerësuan si jashtëzakonisht profesionale, inovative dhe të nevojshme, nisur nga fakti se u punuan në 15 fusha të ndryshme studimi, që momentalisht po krijojnë perceptim të ri në botë mbi të bërit shkencë.

Përmes organizimit të konferencave shkencore, UBT po jep kontribut të drejtpërdrejtë në zhvillimin e shkencës dhe të hulumtimit, duke u mundësuar profesorëve, profesionistëve dhe studentëve të fushave të ndryshme, të prezantojnë rezultatet e punës së tyre shkencore, me ndikim në proceset akademike, por edhe me interes për publikun.

Konferenca shtriu aktivitetin e vet në 15 fusha të ndryshme, që u mbajtën njëkohësisht, përfshirë fushat: Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Sistemet e Informacionit dhe Siguri, Mekatronikë, Sisteme Inxhinierike dhe Robotikë, Inxhinieri e Energjisë Efiçiente, Sisteme të Informacionit dhe Siguri, Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, Inxhinieri e Ndërtimit, Infrastrukturë dhe Mjedis, Juridik, Shkenca Politike, Gazetari, Media dhe Komunikim, Shkenca të Ushqimit dhe Teknologji, Shkenca Mjekësore, Stomatologjike dhe Farmaceutike, Dizajn i Integruar, Psikologji dhe Edukim e Zhvillim.

Ndër të tjerë, pjesë e konferencës ishin:

Në SHKI: Felix Breiteneker, Niki Popper, Gazmend Krasniqi, Besnik Qehaja, Andras Gabor, My Zetterholm, Päivi Jokela, Lina Nilsson, Edin Bula, Ines Bula, Arton Jashari, Diellza Berisha, Blerina Çeliku, Rafail Prodan, Emis Simo, Edlira Martiri, Gentjana Muça, Alma Stana, Kristel Bozhiqi, Robert Kosova, Kastriot Gashi, Bertan Karahoda, Goran Bjelobaba, Ana Savic, Radosav Veselinovic, Hana, Vassil Guliashki, Armend Salihu, Fatlinda Salihu, Konstantinos Polyzos, Evangelos Dermatas, Emin Emini, Azir Jusufi, Ruhada Emini, Valdet Abdurrahmani, Galia Marinova, Dennis, Florinda Imeri, Agon Memeti, Noman Mazher, Deepika Saxena, Geetika Malik, Navneet Sharma, Besnik Korca, Krenare Pireva Nuci, Edrina Gashi, Xhafer Krasniqi, Blaž Rodič, Alenka Baggia, Ramiz Krasniqi, Zhibert Tafa, Eda Tabaku, Kliv Shaplo, Senada, Dhori Beta, Donjeta Mulaj, Edmond Jajaga, Ferihane Nuhiji, Bersart Pllana, Virtyt Lesha, Josef Bushati, Dea Strica, Blerim

Zylfiu, Lavdim Menxhiqi, Ramiz Hoxha, Maria Dojçe, Arbër Mula, Edmond Laja, Antonino Scarrelli, Andrea Profili dhe Valentina Sinaj.

Në Arkitekturë: Burbuqe Hydaverdi, Binak Beqaj, Blerta Vula Rizvanolli, Julia Georgi, Cristina Musacchio, Bardha Meta, Rineta Jashari, Safete Veliu, Gelina Maliqi, Fjolla Abazi, Elvida Pallaska, Ylber Limani, Doriana Musaj, Kaltrina Elezi Kuliqi, Agron Kuliqi, Ferhat Bejtullahu, Merita Dalipi, Mimoza Sylejmani, Lulzim Beqiri, Besian Sinani, Franceska Delia, Ariana Nepravishita, Zeke Islamaj, Zejnullah Rexhepi, Blertë Sylejmani, Rrahim Sejdiu, Agron Bajraktari, Zana Prelvukaj, Faton Spahiu, Skender Kosumi, Banush Shyqeriu, Driton Lleshi, Leana Mahmuti, Nexhat Balaj, Sadije Deliu Kelmendi, Arsim Murseli, Arton Qorri, Robert Kosova, Fabiana Cullhaj, Teuta Thanasi, Arben Reka, Taulant Kullolli, Gjergji Thanasi, Filiz Sönmez, Arber Sadiki, Arnisa Kryeziu, Caroline Jaeger-Klein, Lorika Hisari, Arba Baxhaku.



MBE: Elena Ralinska, Zlatin Saraštov, Nehat Ramadani, Violeta Madzova, Liudmila Guzikova, Besmire Aliu, Liridona Ismaili, Zelfije Osmani, Plamen Iliev, Arton Celina, Lirim Lani, Nehat Dobratiqi, Perseta Grabova, Meril Canameri, Merlina Guni, Jona Hoxha, Peter P. Groumpos, Mentor Geci, Edrina Gashi, Merita Gjyshinca Peja, Mirela Mersini, Kristian Prifti, Ylber Limani, Edmond Hajrizi, Bernard Došti, Elena Polo, Chigozie Ugo-Okoro, Kenneth Njoku, Kenneth Ekechi, Armend Muja, Zef Dedaj, Kaltrina Bunjaku, Dugagjin Sokoli, Carlos Gutierrez, Enver Krasniqi, Sehare Maliqi, Dea Krasniqi, Meriman Suka, Ermal Lubishtani, Iraj Hashi, Ian Jackson, Besnik Krasniqi, Rajan Arapi, Gonxhe Beqiri, Osman Sejfiqaj, Bejtush Ademi, Shpresa Sylja, Mirjeta Domniku, Labeat Mustafa, Olta Allmuça, Gentjan Ramallari, Irina Petkova Kazandzhieva, Enver Daci, Bukurie Imeri, Blerta Kondri, Fidane Gjokolli Spahija, Sejdi Xhemaili, Feim Brava, Diamanta Skenderi, Besnik Skenderi, Ardian Hyseni, Arta Mulliqi, Diandra Nela, Hasan Metin, Hamëz Rama, Bashkim Nuredini, Aida Dibra, Vedat Shaqiri, Marigona Markaj, Ramadan Limani, Hazer Dana, Tomor Qela, Faton Kabashi, Azir Jusufi, Blert Podvorica, Farie Aliu, Arbiana Govori, Agon Halabaku, Elirjeta Beka, Jashari, Muhamet Gërvall.



Në Shkencat Politike: Arian Starova, Pop Ivanov Lazar, Mirchevska Marija, Valon Krasniqi, Alfred Marleku, Ilir Zylfiu, Ridvan Peshkopia, Ardit Arifi, Gresa Sheqiri, Mehlika Özlem Ultan, Abdullah Sencer Gözübenli, Nazli Tekeshanoska, Ruzhdi Matoshi, Enver Abdullahi, Belul Beqaj, Adea Beqaj, Kushtrim Ahmeti, Lothar Tschapka, Xhemail Çupi, Flora Kadriu, Leon Kadriu, Gurakuq Kuçi, Bejtush Gashi, Dritëro Arifi, Ngadhjim Brovina, Gjylja Çeliku, Muaz Agushi.

Në Media dhe Komunikim: Agron Kurtishi, Arbër Çeliku, Safet Zejnullahu, Musa Sabedini, Rajan Arapi, Fatbardhë Kiqina, Adelheid Feilcke, Asuman Kutlu, Bujar Hoxha, Fatime Lumi, Ferid Selimi, Alda Jashari, Anisa Rada, Johannes Tanzler, Felix Breiteneker, Bashkim Gjergji, Gjylie Rexha, Adnan Merovci, Rriollza Agolli, Pajtim Çuni, Edona Jerliu, Muhamet Hajrullahu, Besa Ismaili, Dafina Lata, Jehona Kapllani-Ilazi, Adea Beqaj, Fiqnete Ago, Bujar Ago, Brikela Qelemeni, Mariglen Bita, Irena Nikaj, Albina Jashari

Në Arsim dhe Zhvillim: Michele Gibney, Anita Mirjamdotter, Mary Somerville, Patrik Elm, Krenare Pireva Muja, Niraj Caudhary, Besjana Tosuni, Selami Klaiqi, Hysen Hoti, Stefanie Winkler, Andreas Körner, Ruth Leskovar, Johannes Tanzler, Felix Breiteneker, Denis Çelçima, Votim, Karoly Nagy, Edrina Gashi, Muhamet Gervalla, Gkarnara Rodoula, Fatbardha Qehaja, Alma Lama, Florim Ajdini, Alisa Sadiku, Ardian, Trendeline Haliti, Marigona Sefedini, Silvishah Miftari, Vlora Ejupi, Halil Bashota, Redi Papa, Feride Lohaj, Rabije Murati, Selim Hilmi Ozkan, Nikolle Loka, Mitjana Profiri, Mustafa Sagdic.

Në Juridik: Marina Mokoseeva, Armend Muja, Miah Gibson, Behar Selimi, Artan Tahiri, Agni Aliu, Elvina Jusufaj, Ismail Zejneli, Donalb Xibraku, Ervin Pupe, Osuagwu Ugochukwu, Elochukwu Vincent, Ersida Teliti, Kestrin Katro, Ilda Melo (Kovaci), Zhaklina Peto, Anxhelina Zhidro, Arbesa Kurti, Klodjan Skënderaj, Jorida Xhafaj, Altin Maliqi, Nexhat Balaj, Egzona Osmanaj.

Në Dizajn të Integruar: Aferdita Statovci, Miran Mohar, Artrit Bytyci, Drenusha Kryeziu, Vladan Jeremic, Corina L. Apostol, Liburn Jupolli, Ari Lehtela, Albulena Bilalli, Sezgin Boynik, Ali Akay, Seza Paker, Organ Factory, Hana Marina Mohar, Ayhan Ensici, Arbër Jashari, Sebil Spat, Gazmend Ejupi, Cennet Lika.

Në Mekatonikë dhe Inxhinieri e Energjisë Efiçiente: Peter P. Groumpos, Besa Veseli, Vehebi Sofiu, Sami Gashi, Afrim Sylja, Marsida Ibro, Gerti Kallbaqi, Fevzi Osmani, Lutfi Bina, Marigona Krasniqi, Risto Filkoski, Robert Kosova, Fabiana Cullhaj, Teuta Thanasi, Arben Reka, Taulant Kullolli, Gjergji Thanasi, Gashi Sami, Drini Petrit, Nafije Shabani, Vjollca Komoni, Ines Bula, Edmond Hajrizi, Mariana-Florentina Stefanescu, Liviu Drughean, Gabriel Naştase, Mihaela Ciocan, Sorin Bucsa, Alexandru Dobrovicescu, Imer Zenku, Afete-Shala Musliu, Veton Gjellaj, Felix Breiteneker, Liburn Jupolli, Liridona Ajeti, Zemerart Asani, Selvet Rexhepi, Xhemajl Mehmeti,

Peteacek, Griselda Alushllari, Valmir Hoxha, Edona Kadriu, Betim Shabani, Vladimir Dukovski, Fatmir Azemi, Liridon Dauti, Fatmir Prekupi, Uran Mujku.

Në Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastrukturë: Paul Munters, Feti Selmani, Rinaldo Garziera, M. Beddar, Radmila Sindić Grebović, Ilir Hetemi, Elvida Pallaska, Besa Jagxhiu, Marjan Ivezaj, Driton R. Kryeziu, Anjeza, Alaj, Hazir Çadraku, Faruk Hajrizi, Sokol Xhafa, Tasevska M, Josifovski, Bekim Selimi, Hysen Ahmeti, Musa Shabani, Emine Daci, Nol Dedaj, Izet Ibrahim, Arsim Rapuca, Arberesha Kastrati, Mehmedi Vehbi Gökçe, Lavdim Osmanaj, Nexhmi Krasniqi, Visar Krelani, Binak Beqaj, Ramadan Topuzi, Ahmet Bytyqi, Muhamet Ahmeti, Jeton Zogaj, Arton Thaqi, Besim Duraku, Burim Sopaj, Milaim Ahmetaj.

Në Psikologji: Ibrahim Neziri, Naser Ramadani, Edmond Dragoti, Emanuela Ismaili, Denis Celcima, Violeta Zefi, Vahide Morina, Redona Dudushi, Moshe Landsman, Vjollca Pllana Shahini, Elmedina Česko, Psychosocial Centre for Trauma Therapy-Diakonie, Bekrije Maxhuni, Arta Bunjaku.

Në Shkencat Mjekësore, Kimike dhe Farmaceutike: Dafina Gexha Bunjaku, Naser Ramadani, Arijana Kallaveshi, Anita Sadikaj, Artemisi Shehu, Xhevat Pllana, Gojart Pllana, Sejran Abdushi, Fadil Kryeziu, Shpend Abdushi, Zejnë Buja, Hysni Arifi, Enver Hoxha, Elfrida Kote Ollomani, Ada Pema, Saimir Heta, Kastriot Haxhirexha, Virtut Velmishi, Nevila Alliu, Naser Kamberi, Erëkënda Ajeti, Edona Deva, Luljeta Gashi, Pranvera Kaçaniku Gunga, Faran Emmanuel, Altin Erindi, Elton Spahiu, Indrit Bimi, Çağatay Dayan, Burim Kiseri, Ilma Robo, Vera Oštreni, Eriola Meta, Alert Xhaja, Sahmedin Sali, Zana Agani, Jetmire Alimani Jakupi, Visar Bunjaku, Mirjana Popovska, Shefqet Mrasori, Ferijale Perjuci, Salih Sh. Krasniqi, Besnik Elshani, Ismet Shaqiri, Isa Haxhiu, Dafina S. Krasniqi, Rexhep Gjyliqi, Florije Krasniqi, Rifat Bajrami, Salih Krasniqi, Fllanza Spahiu, Doruntina Ismaili, Fëllënza Spahiu, Lirije Beqiri, Afërdita Berisha, Florjana Ruštemi, Ledjan Malaj, Ela Hoti, Enida Balla, Fitim Alidema, Zaim Gashi, Fadil Sherifi, Argjira Juniku Shkololli, Daniela Bimi, Agim Prokshaj, Jeta Kubati, Blerim Llunji, Vjosa Hamiti Krasniqi, Mergime Prekazi Loxha, Aida Rexhepi, Jehona Ahmed, Nexhmije Ajeti, Xhevdet Elezi, Agran Halimi, Merita Barani, Edmont Laho, Arianit Jakupi, Shpend Dragusha, Valon Ejupi, Agon Hoti, Qëndresa Spahiu, Vlora Lipa, Eda Mehmeti, Enver Përzhaku, Kaltrina Kastrati, Qëndresa Istrefi, Fatjonë Krasniqi, Rina Krasniqi, Arleta Rifati-Nixha, Griselda Alushllari, Mirela Alushllari, Liljana Hallkaj, Shkëlzim Ukaj, Hyzer Rizani, Elgadaf Bakalli, Visar Sylejmani, Mehdi Ukaj, Shkumbin Shala, Magbule Rizani, Skender Radoniqi, Qëndresa Spahiu, Engjëll Thaqi, Zlata Kocan, Dafina Krasniqi.

Në Shkenca të Ushqimit dhe Bioteknologji: Ylberina

Makolli, Ilirian Malollari, Ismail Ferati, Namik Durmishi, Diellëz Arifi, Sara Selimi, Ardit Hoti, Gafur Xhabiri, Era Bruçi, Agron Millaku, Anisa Dhroso, Hasime Manaj, Ilirjan Malollari, Varvara Berisha, Kosovare Luma, Arleta Rifati-Nixha, Fatjona Isufaj, Miribane Dërmaku-Sopjani, Diola Došti, Endra Luzha, Fatbardh Gashi, Naser Troni, Ardian Rexhepi, Avdyrrahman Gashi, Sami Gashi, Taulant Mitrush, Gani Kastrati, Gylxhane Kastrati, Milan Sýs, Tahir Arbneshi, Karel Vytřas Radovan Metelka, Luljeta Pinguli, Imri Demelezi, János Vas, Jeton Spahiu, Dritan Topi, Manfred Gareis, Adem Rama, Kurtesh Sherifi, Luljeta Ajdini, Dhurata Premti, Mirela Alushllari, Nikolla Civici, Mufail Salihaj, Diellon Salihaj, Afete-Shala Musliu, Marjola Mala, Drita Abazi, Teresa Ferreira, Cristina Barrocas Dias, Ana Manhita, Margarida Nunes, Suzana Aliu, Blinera Potera, Fjolla Vllasaliu, Miranda Sahiti, Xhavit Bytyqi, Nazmi Hasanaj, Arianeta Nura, Naser Ramadani, Etleva Hamzaraj, Misini B, Freinbichler E, Coliëicchi M.A, Liner E, Tripton K.F, Della Corte L, Sami Makolli, Redi Buzo, Jonilda Llupa, Lorikë Salihu, Dilaver Salihu, Medin Zeqiri, Ergent Pire, Smajl Rizani, Ylli Biçoku.

Në Sisteme të Informacionit: Anita Mirjamdotter, Blerton Abazi, Romina Agaçi, Ylber Limani, Edmond Hajrizi, Rina Sadriu, Edi Bushati, Albhora Hoti, Ruzhdi Jashari, Art Hoxha, Atdhe Buja, Gazmend Krasniqi, Veton Bejtullahu, George Telonis, Peter P. Groumpos, Kaltrina Sylaj, Hasan Metin, Naim Preniqi, Muhamet Gërvalla, Bujar Lushta, Murat Retkoceri, Albert Aliu, Arbnor Halili, Vehebi Sofiu, Driton S. Bejtullahu.



UBT kontribuon në uljen e papunësisë në Kosovë.

UBT shënon numër rekord të të punësuarve në sektorin privat të arsimit të lartë

Politika e punës dhe funksionimit të UBT-së që nga viti i parë e deri sot, në 17-vjetorin e themelimit, është përgatitja e gjeneratave të reja për tregun e punës dhe punësimi i tyre, si dhe shndërrimi i UBT-së në një vatër punësimi për të tjerët.

UBT tashmë është bërë vend pune për 678 persona, prej të cilëve 132 janë angazhuar vetëm gjatë këtij semestri, si të punësuar dhe praktikantë.

Duke nisur funksionimin me vetëm pak akademikë, dhe atë kryesisht nga rrafshi ndërkombëtar, sot UBT ka mbledhur qindra profesionistë dhe akademikë nga mbarë trojet shqiptare, të cilët janë shkolluar nëpër universitetet më me renome botërore, ndërkaq tash i janë bashkuar UBT-së për ta ndarë përvojën dhe ekspertizën e tyre me studentët.

Miranda Haxhiu nga Departamenti i Burimeve Njerëzore në UBT, tha se të punësuarit në UBT kanë një nivel të lartë të kompetencave profesionale dhe gradave të shkollimit, e kjo përbën vlerë të shtuar për institucionin dhe Kosovën.

“UBT kryesisht përbëhet nga një staf akademik, ku numri me i madh i tyre janë doktor shkence, ose janë në proces të përfundimit të doktoratës. Politika e institucionit është që t’i përkrahë intelektualët e rinj që kanë studiuar jashtë vendit dhe që tani kanë gjetur hapësirë për angazhim në UBT, e ky trend fatmirësisht po rritet në secilin vit”, theksoi ajo.

Stafi i UBT-së është shkolluar nëpër institucione të njohura arsimore ndërkombëtare, përfshirë University of Vienna, London School of Economics, Leiden University, Trinity College Dublin, University of Graz, Salsburg University, John Hopkins University, Polytechnic University of Milan, Duke University, Linnaeus University, Gent Univeristy, George Town University, si dhe në shumë universitete të tjera prestigjioze.

Përpos kontributit në uljen e papunësisë në Kosovë,



UBT i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe aspektit gjinor, në aspektin e fuqizimit dhe përkrahjes së grave në shkencë dhe menaxhment.

“Numri i përgjithshëm i të punësuarve në UBT është pothuajse i barabartë, marrë për bazë aspektin gjinor, me ç’rast numri më i madh i të punësuarve femra është në sektorin e menaxhmentit dhe koordinimit, me 50%, përkatësisht 80%”, tregoi Haxhiu.

Ajo konstatoi se UBT nuk ka synim që të reduktojë numrin e stafit, por përkundrazi, me rritjen e numrit të studentëve, do të shtojë në vijimësi edhe numrin e stafit akademik dhe administrativ.

“UBT nuk do të kursejë në aspektin e investimit në burime njerëzore, për shkak se jemi të vetëdijshëm

që jemi institucion akademik dhe njerëzit profesionalë janë potencial dhe vlerë e shtuar”, potencoi Haxhiu.

Përpos punësimit, UBT ndihmon dhe motivon stafin në të gjitha mënyrat për ngritje në grada akademike, për këtë arsye, shumë anëtarë të stafit në çdo vit kalojnë ose përfundojnë një nivel më të lartë akademik, ku një numër i madh i tyre përkrahen nga ana e institucionit në studimet e tyre të doktoratës nëpër universitete evropiane dhe amerikane. Po ashtu, stafi përkrahet edhe për ndjekje të trajnimeve, pastaj bëhen pjesë e proceseve të certifikimit, mobiliteteve, shkëmbimeve, si dhe angazhohen si profesorë vizitorë nëpër universitete të njohura botërore.

UBT nderon me Çmimin “Excellence Leadership Award” drejtoreshën, për Evropë në DW, Adelheid Feilcke

UBT ndau Çmimin “Excellence Leadership Award” për drejtoreshën e programeve për Evropë në Deutsche Welle, Adelheid Feilcke, për kontributin e saj të çmuar në fushën e gazetarisë, me theks të veçantë për ndikimin e saj në hapjen e shërbimit në gjuhën shqipe në Deutsche Welle.

Pas pranimit të Çmimit nga rektori, prof. dr Edmond Hajrizi, ajo tha se ndjehet e nderuar për vlerësimin me këtë çmim, megjithëse meritat për punën e bërë ia atribuoi edhe ekipit me të cilin ka punuar për vite

të tëra.

“Që nga koha e Millosheviçit jemi munduar t’ju informojmë, të jemi pranë jush dhe me ju, si dhe t’i mbështesim njerëzit e Kosovës përmes informacioneve dhe raportimit, tash po mundohemi që të njëjtën gjë ta bëjmë edhe në liri”, tha Feilcke.

“Excellence Leadership Award” është Çmimi më i lartë që e dhuron UBT për personalitete të shquara vendore e ndërkombëtare, që kanë dhënë kontribut dhe kanë shënuar arritje në fusha të ndryshme.



UBT, model i institucionit që bashkon të gjitha etnitë në Kosovë

Gjuhë të ndryshme dëgjohen e kultura të llojllojshme shprehen nëpër kampuset e degët e UBT-së përreth Kosovës, kjo sepse UBT është qendër ku të rinjtë kosovarë të të gjitha etnive e gjejnë një vend të lirë për t’u shprehur, duke studiuar mbi parimin e ndërtimit të një shoqërie të shëndoshë, që më vonë i shndërron në ambasadorë të promovimit të paqes dhe tolerancës.

Këta studentë kanë zgjedhur që të studiojnë në UBT pasi vlerësojnë se janë bërë pjesë e institucionit që përçon më së miri frymën evropiane të studimeve dhe të njëjtë arrijnë të integrohen aq mirë, sa qysh në semestrin e dytë të studimeve mësohen të flasin rrjedhshëm e të komunikojnë në gjuhën shqipe.

Një prej tyre është studentja Elona Azari, e cila gjithmonë kishte ëndërruar të bëhej infermiere. Për të realizuar këtë ëndërr ajo vazhdoi shkollimin universitar në Fakultetin e Infermierisë në UBT, me qëllim që të dalë së më e përgatitur dhe e gatshme për t’ju ofruar ndihmë mjekësore atyre që kanë nevojë.

“Jam regjistruar në Fakultetin e Infermierisë dhe kam zgjedhur UBT-në për t’i vazhduar studimet sepse ka infrastrukturë të mirë dhe është i certifikuar ndërkombëtarisht për cilësi. Këtu kam ardhur për t’u bërë profesionale në profesionin tim”, ka theksuar ajo.

Ndërkohë, studenti Samir Salihu i fton të gjithë të rinjtë e komuniteteve të vazhdojnë studimet në UBT.

“Kam përzgjedhur UBT-në për të studiuar sepse diploma është e njohur në vendet më të zhvilluara në botë”, tregoi Salihu.

UBT ka kampuset dhe degët e veta në Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj e Gjilan, dhe përmes tyre po krijon hapësirë që të jetë sa më afër komunitetit e të ofrojë shërbime universitare për ta. Falë kësaj, deri më sot pjesë e UBT-së kanë qenë dhe janë mijëra studentë, nga të gjitha etnitë që jetojnë në Kosovë.

Gjenerata 2018/19 e studentëve fillon studimet në 27 programe studimi, në bachelor e master

UBT pret me ceremoni madhështore studentët e rinj

Mijëra fytyra të lumtura të të rinjve nga mbarë trojet shqiptare i kanë zbuluar objektet e UBT-së në Prishtinë dhe Lipjan me praninë e tyre, me rastin e fillimit të rrugëtimit universitar, që pas pak vitesh do t'i shndërrojë në lider të pakrahasueshëm në tregun vendor e ndërkombëtar të punës.

Kjo ceremoni madhështore u mbajt për studentët e rinj të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës, Inxhinierisë së Energjisë, Mekatronikës dhe Menaxhmentit, Dizajnit të Integruar, Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, Infermierisë, Stomatologjisë dhe Farmacisë.

Hapjen e të gjitha ceremonive të pritjes nëpër fakultetet përkatëse e bëri rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, i cili përmes një fjalimi motivues u tregoi studentëve që e kanë nisur rrugëtimin për të qenë prijës të ndryshmeve të mëdha teknologjike, ekonomike dhe shoqërore në vend e më gjerë.

“Në UBT nuk do të gjeni vetëm një institucion ku do të merrni një diplomë, por

një institucion që do të qëndrojë prapa jush në secilin hap të rrugëtimit tuaj sepse ne kemi përgjegjësi morale e shoqërore të përgatisim kuadro prej të cilave do të përfitojë Kosova dhe mbarë bota”, theksoi Hajrizi.

Ai tha se studentët janë ata që i kanë dhënë reputacion dhe imazh pozitiv UBT-së, përmes përfaqësimeve dinjitoze të institucionit dhe Kosovës në mbarë botën dhe u shpreh i bindur se po të njëjtin sukses do ta arrijnë me punë dhe përkushtim edhe studentët e rinj.

Për kurrikulat, marrëveshjet e bashkëpunimit, mundësitë për punë praktike e punësim, para studentëve folën edhe përfaqësuesit e fakulteteve përkatëse, studentët e dalluar, si dhe përfaqësues të kompanive me të cilat UBT ka marrëveshje, e që të njëjtat në kuadër të stafit të tyre kanë një numër të madh të studentëve të UBT-së.

Falë zgjerimit të kompetencave profesionale dhe punës intensive në ngritjen e nivelit të cilësisë në arsim, të ardhmen e tyre deri tani ia kanë besuar UBT-së mijëra studentë, e ky numër po shënon rritje në secilin vit akademik.



Përfaqësuesit në UBT, presin në takim pune drejtorin e Microsoft-it në Shqipëri, Sokol Vladi



Me qëllim të zgjerimit të bashkëpunimit dhe hartimin e planeve të përbashkëta, drejtori për Produkte Profesionale dhe Zhvillimore në UBT, Besnik Skenderi, ligjëruesi e udhëheqësi i ICT Akademisë në UBT, Blerton Abazi si dhe zyrtarja për Marrëdhënie Ndërkombëtare në UBT, Lirigonë Morina kanë prituri në takim pune drejtorin e përgjithshëm të Microsoft Albania & Territory Channel Manager, Sokol Vladi.

Gjatë këtij takimi është diskutuar për hartimin e projekteve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale,

në zhvillim të qëndrueshëm dhe inovacion.

Konkretisht ata diskutuan për krijimin e grupeve për zhvillim të produkteve dhe zgjedhjeve për biznese përmes platformave të Microsoft-it që bazohen në shërbimet cloud.

Me theks të veçantë, ata diskutuan edhe për integrimin e teknologjisë në edukim sepse vlerësohet se do të ndihmojë institucionin në kurrikulat e studimit dhe studentët për integrim në teknologji.

UBT anëtarsohet në GUESSS

UBT bëhet pjesë e projektit më të madh global hulumtues rreth ndërmarrësisë së studentëve

GUESSS (Global University Entrepreneurial Spirit Students' Survey) është projekt që ka filluar në vitin 2003, në University of St.Gallen dhe University of Bern (Zvicër).

Këtë vit, më shumë se 1000 universitete nga 50 vende do të jenë pjesë e këtij projekti.

Përmes UBT-së, Kosova do të jetë një nga shtetet pjesëmarrëse në këtë projekt të rëndësishëm të identifikimit të potencialeve për ndërmarrësi të studentëve.

GUESSS konsiderohet si një nga projektet më të mëdha hulumtuese në fushën e ndërmarrësisë.

Qëllimi i hulumtimit është që të identifikojë nivelin e ndërmarrësisë tek studentët, të analizojë mënyrat se si mund të fillohet dhe të rritet një biznes i ri, si dhe të shikohet roli i bizneseve familjare në këtë proces.

Përmes këtij hulumtimi do të identifikohen faktorët që ndikojnë dhe motivojnë një individ për të filluar një biznes të ri, si dhe të përcaktohet roli i edukimit nga fusha e ndërmarrësisë në formimin e një ndërmarrësi të ri.

Gjithashtu, përmes këtij hulumtimi do të mund të shihet roli i faktorëve makroekonomikë, institucionet që promovojnë ndërmarrësinë dhe ndikimi i kulturës në ambientin e përgjithshëm të të bërit biznes.

Ky projekt është i pari i këtij lloji në Kosovë dhe do të mund të përdoret si një platformë shumë e mirë për dizajnimin e politikave që promovojnë ndërmarrësinë tek studentët dhe tek të rinjtë në përgjithësi.

Ndërmarrësia mendohet të jetë një nga metodat për të zvogëluar papunësinë e lartë në Kosovë, duke e bërë kështu këtë projekt të rëndësishëm së veçantë për UBT-në dhe vendin.

Ngacmimi online, sfidë për njerëzimin në epokën digjitale

Tash e disa vite, ngacmimet online kanë ndikuar në prishjen e rehatisë dhe sigurisë personale të njerëzve, dhe në veçanti, të vajzave e grave.

Ngacmimet që vijnë veçanërisht nga rrjetet sociale dinë të jenë sa të pakëndshme, aq edhe të rrezikshme, andaj duhet bërë më shumë përpjekje për raportimin e rasteve të tilla. Hapat e parë për mbrojtje janë edukimi mbi ngacmimet, mbrojtja e llogariver personale, mbajtja private e fotografive, shmangia e linqeve të panjohura, shkyçja nga llogaritë online, postimi, komentimi dhe pëlqimi i postimeve të

duhura, shfrytëzimi i kontrolleve të privatësisë dhe mosngacmimi i të tjerëve.

Kështu është shprehur kryetari i komunitetit “Cyber Security and Privacy”, Mentor Hoxhaj, me rastin e trajnimit të mbajtur për studentët e UBT-së, në temën “Identifikimi, reagimi dhe raportimi i ngacmimit online”, që është shënuar në kuadër të Ditës Botërore kundër dhunës ndaj gruas, organizuar nga komuniteti “Cyber Security and Privacy”, mbështetur edhe nga UBT. Hoxhaj ka theksuar se ngacmimi online është çështje që shkakton shqetësim, pasi këto ngacmime kanë

kontribuar edhe në sjelljen e problemeve të shumta pasuese tek të rinjtë. “Ngacmimet online po ndodhin çdo ditë. Bisedat e shkëmbyera përmes sms-ve, email-ve ose rrjeteve sociale, mund të rezultojnë në keqpërdorim. Vlen të përmendet që në disa raste, ngacmimet online kanë sjellë një numër problemesh dhe kanë shkaktuar shqetësim emocional tek adoleshentët”, vlerësoi Hoxhaj.



Avancim në fushën e mjekësisë

UBT hapi Poliklinikën Universitare më të madhe në Kosovë

Dëshira për të sjellë inovacion në fushën e mjekësisë në Kosovë dhe nevoja e qytetarëve për të marrë shërbim cilësor e profesional mjekësor, ka bërë që UBT të hapë Poliklinikën Universitare më të madhe në Kosovë dhe rajon.

Poliklinika e UBT-së tashmë ka marrë licencën nga Ministria e Shëndetësisë, dhe përpos kësaj, është certifikuar nga standardi më i lartë i cilësisë në botë, “ISO 9001: 2015”.

Me një infrastrukturë tejet moderne, laboratorë të pajisur me mjetet e nevojshme për ofrimin e të gjitha llojeve të shërbimeve mjekësore dhe me 31 ambulanca që do të jenë në çdo kohë në shërbim të pacientëve, kjo poliklinikë synon të bëhet referencë e profesionalizmit dhe ekspertizës, ku ndër tjerash do të zhvillohen edhe ekspertët e ardhshëm më të mirë në rajon për të gjitha fushat e mjekësisë.

Shërbimet shëndetësore nuk janë dobia e vetme, bash-

kë me këtë klinikë në Kosovë po vijnë mjekët dhe ligjëruesit më të mirë nga e mbarë bota, të cilët po e ndajnë përvojën dhe njohuritë e tyre me studentët dhe të gjithë të interesuarit e tjerë mbi inovacionet e fundit mjekësore në botë, dhe tash me hapjen e poliklinikës, vizitat dhe ligjëratat do të intensifikohen.

UBT, tash e disa vite po ndërton gjeneratën e ardhshme të mjekëve dhe infermierëve, të cilët tash do të kenë mundësi që tërë pjesën praktike të profesioneve të tyre ta ushtrojnë brenda klinikës, gjithmonë duke marrë mësim dhe duke qenë të dirigjuar nga ekspertët më të mirë vendorë e ndërkombëtarë të mjekësisë.



UBT dhe Konsorciumi i Spitaleve Gjermane krijojnë mundësi punësimi për studentët e infermierisë



Rektori i UBT-së prof. dr Edmond Hajrizi zyrtarisht po qëndron në Gjermani me ftesë të përfaqësuesve të Konsorciumit të Spitaleve Gjermane, më të cilët po takohet për të prezantuar mundësitë e bashkëpunimit që studentët të integrohen në tregun ndërkombëtarë të punës në fushën e mjekësisë. Studentët e fakulteteve të mjekësisë në UBT, me arritjen e marrëveshjes së bashkëpunimit me Konsorciumin e Spitalëve Gjermane, përveç që

do të bëjnë praktikë në këto institucione, atyre u ofrohet edhe mundësi e punësimi në spitale e qendra ambulatorie gjermane, njëherësh të kryejnë edhe trajnime profesionale. UBT ka të hapur qendrën më të madhe të inovacionit për mjekësi në Kosovë, andaj, kjo ka shtyrë edhe KSGJ-në që të ofrojë bashkëpunim sepse UBT shihet si model i së ardhmes për mjekësi. Qendra e inovacionit për mjekësi në UBT ka

mbi 80 laboratorë me standarde evropiane për të gjitha fushat e shëndetësisë: Stomatologji, Mjekësi e Përgjithshme, Farmaci, Infermieri, Kirurgji, Interno, Pediatri, Psikiatri, Biokimi, Mikrobiologji dhe shumë të tjera. UBT ka përvojën më të mirë për bashkëpunim në rrafshin ndërkombëtarë duke përfshirë edhe shtetin e Gjermanisë, sepse posedon edhe Institutin e Gjuhëve të huaja në të cilën ofrohet edhe gjuha gjermane.

Laboratori Austriak për shëndetësi digjitale themelohet në Kosovë

UBT po sjell në Kosovë dhe rajon edhe një risi tjetër, që ka të bëjë me digjitalizimin e shëndetësisë, nismë kjo që do të jetë në shërbim të studentëve dhe të komuniteti. Ky laborator do të jetë i pari dhe i vetmi i këtij lloji në Kosovë dhe rajon.

UBT dhe kompania e njohur austriake AME International, kanë krijuar një bashkëpunim strategjik që synon të promovojë zgjidhje teknologjike për shëndetësi digjitale, për të ndarë përvojën dhe njohuritë austriake në fushën e e-shëndetësisë dhe të krijojë një qendër të njohurive për shëndetësi digjitale në UBT, nga e cila do të përfitojë sektori i industrisë dhe kujdesit shëndetësor në Kosovë. Leksionet e para të modulit “Hyrje në Shëndetin Digjital” dhe përdorimi i provave të laboratorit të shëndetit të AME-s u zhvilluan më 16-18 maj, në UBT.

Sipas prof. dr Edmond Hajrizi, një modul edukativ i përgatitur bashkërisht, që mbulon aspekte të ndryshme të shëndetit digjital, tash e tutje do të mësohet në UBT.

“Ne jemi të lumtur të njoftojmë se laboratorit e-shëndetësi (shëndetësi digjital) i AME-s është themeluar në UBT. Laboratori shëndetësor i AME-s do të ofrojë zgjidhjet më të mira bashkëkohore të TIK-ut për shëndetin digjital. Ky aktivitet do të kontribuojë në një shkëmbim më të mirë të njohurive dhe ekspertizës, të cilat ne besojmë se do të hapin horizonte dhe mundësi të reja në epokën e shëndetësisë digjitale në Kosovë”, tha drejtori i AME International, Heinz Messinger.

Studentët dhe stafi akademik do të kenë qasje akademike në sistemin elektronik të shënimeve shëndetësore, portalin e pacientit dhe platformën e shkëmbimit të informacionit shëndetësor të ofruesit të njohur të zgjidhje shëndetësore në fushën e TIK-ut, “Tiani Spirit”.

Përveç kësaj, një shikues i gjeneratës së re i radiolog-

jisë, “MedDream”, ofruar nga Softneta dhe një shikues i avancuar i radiologjisë 3D, i ofruar nga “VisuApps”, do të jenë në dispozicion të studentëve.



Bashkëpunimi ndërkombëtar

Rektori Hajrizi e përfaqësoi Kosovën në Asamblenë e Përgjithshme të EOQ-së

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi e ka përfaqësuar Kosovën në Asamblenë e Përgjithshme të Organizatës Evropiane të Cilësisë (EOQ), që u mbajt në Paris të Francës.

Ai e përfaqësi vendin në cilësinë e presidentit të organizatës "Quality Kosova", përmes të cilës Kosova edhe u pranua dhe u bë anëtare me të drejta të plota në EOQ.

Temë kryesore e diskutimit në këtë takim ishte plotësimi i kriterëve të cilësisë në inovacion dhe kënaqësi të klientëve, të cilat vazhdojnë të mbesin vlerat më të rëndësishme dhe më me interes në botë.

Me këtë rast, Hajrizi u shpreh se ndërmarrjet dhe institucionet e Kosovës duhet të investojnë shumë më tepër për të ngritur aftësitë konkurruese.

"Kosova ka edhe shumë punë për të bërë për t'u ndjerë e trajtuar të barabartë në treg me të gjithë konkurrentët në mbarë botën dhe për t'u dhënë kushte të barabarta të gjithë investitorëve vendorë", vlerësoi ai.

Ai pati edhe dhjetëra takime me përfaqësues të vendeve të ndryshme të Evropës., të cilët shprehën gatishmërinë e tyre të plotë për bashkëpunim dhe shkëmbim të përvojave.

Po ashtu, gjatë këtij takimi u vendos që mbledhja e radhës e Këshillit të Përgjithshëm të EOQ-së të mbahet në Kosovë, në qershor të vitit të ardhshëm.

Kosova u bë anëtare me të drejta të plota në Organizatën Evropiane të Cilësisë (The European Organization for Quality) në vitin 2009.

EOQ është organizatë ndërdisiplinore evropiane që përqipet për përmirësim efektiv në sferën e cilësisë në kuptimin e saj më të gjerë, duke vepruar si organ koordinues dhe katalizator i Organizatave të Përfaqësuesve Kombëtare brenda saj.



Delegacioni i UBT-së viziton Universitetin Sttafordshire



Një delegacion i UBT-së, i udhëhequr nga rektori, prof. dr Edmond Hajrizi, ka vizituar Universitetin Sttafordshire, në Stockon-Trent, në Angli, në kuadër të bashkëpunimit të ngushtë dhe shumëvjeçarë që UBT ka me këtë universitet.

Këto dy institucione kanë zgjeruar bashkëpunimin në shumë fusha, përfshirë atë të ekonomisë, ndërmarrësisë, teknologjisë dhe informacionit.

Të gjitha këto bashkëpunime po ndiko-

jnë në mënyrë të vazhdueshme ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë në Kosovë, duke ndihmuar njëkohësisht në ngritjen e kapaciteteve akademike dhe në mobilitetin e kompetencën e studentëve. Krahas shpërblimit me të holla, ekipi fitues do të ketë mundësinë e pjesëmarrjes në "Europe Code Week 2018", aktivitet ky që do të mbahet në Bruksel, me ftesë nga Komisionerja e Bashkimit Evropian, Mariya Gabriel.

Rektori Hajrizi, pjesëmarrës në konferencën ndërkombëtare akademike të SAP-it, në Gjermani

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi po e përfaqëson UBT-në dhe Kosovën në Konferencën Ndërkombëtare Akademike të SAP-it, që po mbahet në Mynih të Gjermanisë dhe ku përvojën dhe ekspertizën e tyre mbi teknologjinë dhe inovacionin po e ndajnë profesionistë të shquar nga 58 vende të botës.

Gjate kësaj konference Hajrizi prezantoi të arriturat në UBT dhe në Kosovë gjatë periudhës së fundit, me fokus në fushat që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm, ndërmarrësinë, inovacionin, teknologjitë e reja për digjitalizim, robotikë, internetin e gjërave, inteligjencën artificiale dhe digjitalizimin.

Përpos pjesëmarrjes në konferencë, ai u takua me shumë partnerë nga universitete të ndryshme nga e gjithë bota, me përfaqësuesit e stafit menaxhues të kompanisë

SAP, si dhe të kompanive tjera botërore. Falë këtij partneriteti, studentet dhe stafi i UBT-së do të kenë mundësi të përfitojnë në fushën e teknologjisë dhe ndërmarrësisë.

I tërë ky aktivitet UBT-në e bënë pjesë të komunitetit më të madh në botë për ndërmarrësi, inovacion, për pjesëmarrjen e femrës në teknologji dhe për digjitalizim, duke ndikuar direkt në synimet globale të zhvillimit të qëndrueshëm, të aprovuar disa vite më parë nga Kombet e Bashkuara.

Me prezencën, aktivitetet dhe rezultatet e UBT-së, Kosova po përfaqësohet në shumë raste shume më mirë se sa vendet në regjion.

UBT mbetet institucioni me i madh dhe lider në teknologjitë e reja në regjionin e Ballkanit Perëndimor.

UBT-CERT, pjesëmarrës në garën "Balkan Hackathon", në Bullgari

Ekipi i UBT-CERT, i përfaqësuar nga rektori, prof. dr Edmond Hajrizi, Blent Kurtalani, Betim Gashi, Blerona Cakolli dhe Edi Bushati, po marrin pjesë në garën "Balkan Hackathon", që po mbahet në Sofje të Bullgarisë.

Ky aktivitet organizohet nga Sofia Development Association, nën patronazhin e Komisioneres Evropiane për Ekonomi Digjitalë dhe Shoqëri, nj+her+sh ministre e Presidencës Bullgare në Këshillin Evropian, Mariya Gabriel.

Gara Balkan Hackathon është sfidë ku përgjatë 24 orëve mirëpritën ekipet e ndryshme të përbërë nga zhvillues, dizajnerë, studentë dhe profesionistë të TIK-ut nga të gjitha vendet e Ballkanit, për të prezantuar projektet e tyre.

Sfida kryesore e garës Balkan Hackathon Digital Divide në të gjitha format lidhet me sigurinë, qasjen në internet nga pa-

Në fund të garës, një juri e përbërë nga personalitete të shtetit bullgar dhe Bashkimi Evropian, do të vlerësojë sipas kriterëve që kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemeve, aplikueshmërinë në treg, vetë prezantimi – komunikimi

Për nisjen e këtij bashkëpunimi ka dhënë kontribut të çmuar profesori Roberto Capata, i cili kohë më parë ka ligjëruar në UBT.

Sapienza University of Rome është një universitet kërkimor me seli në Romë të Italisë.

"La Sapienza" është një nga universitetet më të mëdha evropiane për nga numri i studentëve dhe një nga më të vjetrit në histori, i themeluar në vitin 1303.

Matësit e cilësisë e kanë renditur këtë institucion si të parin në renditjen kombëtare të Italisë dhe në atë të Evropës Jugore.



Rektori Hajrizi zhvillon takim pune me anëtarë të Fondacionit të Kolegjit të Mbrojtjes të NATO-s

Bashkëpunimi i ngushtë i krijuar ndër vite ndërmjet UBT-së dhe Fondacionit të Kolegjit të Mbrojtjes të NATO-s, ka bërë që rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi të pritët në Romë nga vetë anëtarët e këtij institucioni.

Hajrizi është pritur në takim nga gjeneralët, Giuseppe Morabito dhe Giorgio Battisti, të cilët e rikonfirmuan mbështetjen dhe vazhdimin e bashkëpunimit me UBT-në. Morabito dhe Battisti, së bashku edhe me kolegë të tjerë nga Kolegji i Mbrojtjes të NATO-s, kanë shfaqur gatishmërinë e tyre që të kontribuojnë në Akademinë Ndërkombëtare Verore të UBT-së, me anë

të simulimit në modelin e punës së NATO-s.

Kujtojmë se bashkëpunimi ndërmjet UBT-së dhe Kolegjit të Mbrojtjes ka marrë formë tash e disa vite, me ç'rast përgjatë tyre në vijimësi janë mbajtur konferenca, tryeza diskutimi e seanca simulimi të përbashkëta, me qëllim të njohjes së studentëve me historikun, rolin, ndikimin dhe modelin e funksionimit të NATO-s përgjatë viteve, duke marrë mësim nga gjeneralët dhe veteranët e kësaj organizate me ndikim global.

Akademiti verore në UBT

Aktiviteti i SHKI-së, Sistemeve të Informacionit dhe Sigurisë Kibernetike në ANV

Aktiviteti i ANV-së në fushën e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, është një ndër shkollat që ka mbledhur më së shumti pjesëmarrës në secilin edicion, duke përfshirë edhe edicionin e sivjetmë.

Në këtë edicion, që është i shtati, ANV-ja e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë nisi me ligjëratën e profesorit, dr Felix Breitenesker nga Universiteti për Teknologji i Vjenës, i cili trajtoi temën: “Simulimi dhe Vizualizimi”, për të vazhduar atë me ligjëratën e përfaqësuesve të kompanisë FRAKTON, të cilët ligjëruan për temën: “Zhvillimi i Aplikacioneve për Celularë”.

ANV-ja e SHKI-së ka vazhduar punimet me ligjëratën e kandidatit për doktoraturë në Universitetin e Sheffield-it, Fesal Baxhaku, i cili ligjëroi për rëndësinë e përfshirjes dhe përhapjes së teknologjisë në jetën e përditshme, në kuadër të lëndës “Inteligjenca Artificiale”.

Ai tregoi se deri në vitin 2020 pritet të jenë përafërsisht 20.8 miliard pajisje do të kenë efekt të jashtëzakonshëm në përmirësimin e kushteve, por që, sipas tij, kjo do të ndodhë nëse të gjitha të dhënat voluminoze që prodhohen, do të shfrytëzoheshin me të vetmin qëllim që të parashikohet e ardhmja.

“Të dhënat që marrim nga pacientet do të mund të shërbenin si masa parandaluese për ndonjë sëmundje vdekjeprurëse. Kjo mund të arrihet vetëm nëse të dhënat voluminoze të prodhuara vazhdimisht, të mund të shfrytëzoheshin duke përdorur inteligjencën artificiale”, tregoi Baxhaku.

Tutje, ai sqaroi se shfrytëzimi i Rrjetave Neurale do të mundësojë që jo vetëm të gjejmë informata të fshehura duke zbuluar shkaktarin, por edhe mund të shërbejnë si masë që të bëjmë parashikime në të ardhmen ose optimizime për probleme të caktuara.

Për pjesëmarrësit e ANV-së, dy kompani nga industria, e me të cilat UBT ka bashkëpunim të ngushtë, “Zombie Soup” dhe FRAKTON”, i kanë dërguar përfaqësuesit e tyre për të ligjëruar për pjesëmarrësit e ANV-së së SHKI-së.

Përfaqësuesit e ZombieSoup, Agnesa Belegu dhe Endrit Xhemaili kanë vazhduar me ligjërimin për sektorin “Gaming”, me ç’rast pjesëmarrësit mësuuan mbi metodat e efikasitetit të krijimit dhe trendet e fundit në këtë sektor.

Aktiviteti pasoi me ligjërimin e përfaqësuesit të kompanisë “FRAKTON”, Mergim Krasniqi, i cili dha leksione për temën: “Zhvillimi i aplikacioneve për mobilë”.

Në vazhdim të aktivitetit të Akademisë Ndërkombëtare Verore të Shkencave Kompjuterike dhe Sigurisë Kibernetike dhe Privatësisë në UBT, ka ligjëruar profesori nga Universiteti “Bloomsburg” në Pensilvani të SHBA-së, Scott Inch.

Ai ka trajtuar temën “Forenzika Digjitale”, derisa ka prezantuar rastet konkrete që profesori Scott Inch ishte i përfshirë në ofrimin e ekspertizës, llojet e lëshimeve të sigurisë, rreziqet nga IP Theft Intellectually Property etj. Profesor në UBT, Xhelal Jashari, i mbështetur nga asistentët, Blerim Zylfiu dhe Lavdim Menxhiqi, kanë ligjëruar dhe kanë ndarë me studentët përvojat më të reja për botën e teknologjisë, që lidhen me teknologjinë e zhvillimit të ueb aplikacioneve, për teknologjitë Microsoft .net, konceptet MVC dhe modelet inxhinierike të zhvillimit.

Me këtë rast, me mbikëqyrje dhe përkrahje të asistentëve, Blerim Zylfiu dhe Lavdim Menxhiqi, studentët kanë arritur të zhvillojnë ueb aplikacione, duke përdorur trendet e fundit të teknologjive Microsoft .net, duke integruar libraritë më të reja të JavaScript-it, si: React JS dhe Vue JS, për zhvillimin e ndërfaqeve të përdoruesit në projektet të cilat i përkasin fushave të ndryshme të aplikimit, të tilla si: Menaxhimi i aseteve dhe inventarit, Arkiva e Audio/Video materialeve, etj.

Në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore të SHKI-së në UBT, është mbajtur kuizi argëtues për pjesëmarrësit, ku dhjetëra studentë i testuan njohuritë e tyre.

Kuizi përmbante rreth 20 pyetje logjike, derisa më së shumti përgjigje ka qëlluar studentit Kushtrim Cubolli.

Me këtë rast ai ka fituar edhe një trajnim falas në UBT, që do ta mbajë në muajin shtator.

Kuizi është zhvilluar online, teksa është monitoruar nga asistentët në UBT, Blerim Zylfiu dhe Lavdim Menxhiqi. Akademianë Ndërkombëtare Verore të SHKI-së e ka pasuruar ligjëratat e zv.kryeshefit të KOSTT-it, Kadri Kadriu, i cili ka ligjëruar për temën “Smart Grid”.

Ai ka shpjeguar në mënyrë të detajuar mbi sfidat e digitalizimit të sistemit të energjisë dhe mbajtjen e rrjetit të transmetimit të qëndrueshëm, duke i balancuar rezervat nga burime të përhershme si era dhe dielli.

Matja e parametrevë truporë përmes programeve elektronike dhe zhvillimin e aplikacioneve elektronike janë temat që u trajtuan në kuadër të ANV-së së Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, të cilat ngjallën interesimin e dhjetëra pjesëmarrësve.

Profesori nga Universiteti për Teknologji i Vjenës, dr Felix Breitenesker shpjegoi për mënyren e llogaritjes së temperaturave të trupave në intervale të ndryshme kohore, dhe e tërë kjo duke e përdorur vetëm programin Excel.

Ekipi nga kompania “FRAKTON”, shefi ekzekutiv, Çelik Nimani, shefi i Zyrës së Teknologjisë, njëherësh edhe student i UBT-së, Edon Sekiraqa dhe zhvilluesi i Android-it në FRAKTON, Mergim Krasniqi, ligjëruan mbi rëndësinë e të pasurit njohuri për zhvillimin e aplikacioneve dhe në veçanti u fokusuan në aspektin e zhvillimit të aplikacioneve për Android.

Pjesëmarrësit e ANV-së e SHKI-së, kanë realizuar vizitë në kompaninë e njohur vendore, “FRAKTON”, ku janë prituri nga stafi përgjegjës i kësaj kompanie, konkretisht nga drejtori i teknologjisë, njëherësh edhe student i UBT-së, Edon Sekiraqa, zhvilluesja Full Stack, Erza Maxhuni dhe zhvilluesi për Android, Mergim Krasniqi.

Për shkak të interesimit të madh, pjesëmarrësit janë ndarë në tri grupe për ta realizuar këtë vizitë.

Gjatë kësaj vizite, pjesëmarrësit janë njoftuar me hapësirat punuese ku vepron kompania “FRAKTON”, teksa panë nga afër edhe projektet e zhvilluara.

Tutje, Erza Maxhuni ka sqaruar mbi ndarjen e detyrave dhe kryerjen e punëve në baza ditore, si dhe sqaroi kërkesat dhe aftësitë që kërkohen prej kësaj kompanie, me qëllim të punësimit të njerëzve të rinj.

Duke e parë potencialin e pjesëmarrësve brenda akademisë, kompania “FRAKTON” do të ofrojë mundësi për punë praktike për studentët e dalluar.

Studentët e SHKI-së mësojnë hapat e parë për krijimin e lojërave elektronike

“Hyrje në modelim dhe simulim nga inxhinieria në kujdesin shëndetësor dhe nga logjistika në sistemet socio-ekonomike” dhe “Gaming”, janë temat të cilat u ligjëruan në ditën e pestë të ANV-së së SHKI-së.

Gjatë këtij leksioni, profesori dr Felix Breitenesker nga Universiteti i Vjenës për Teknologji, tregoi për metodat e zhvillimit të eksperimenteve në fushat paraprake. Gjithashtu, studentët praktikuan se si t’i fitojnë rezultatet e eksperimenteve në mënyrë elektronike me anë të programit Excel.

Në pjesën e dytë, ligjëruesja Agnesa Belegu, drejtore shë e Departamentit të Lojërave në kompaninë “Zombie Soup”, shpjegoi hapat e parë të krijimit të lojërave elektronike, teksa në ditët në vazhdim studentët do të fillojnë të krijojnë lojërat e tyre.

Në ditën e nesërme, dr Felix Breitenesker do të vijojë me temën: “ Simulimi dhe Vizualizimi”, si dhe studentët do të mësojnë rreth zhvillimit të web-it nga profesori Xhelal Jashari.

Ndërkaq, profesori Xhelal Jashari ka mbajtur një leksion mbi zhvillimin e ueb-it, në të cilin shtjelloi karakteristikat e procesit të zhvillimit të një uebfaqeje, si: gjuhët programuese, protokollet dhe teknologjitë të cilat përdoren për zhvillimin e saj. Po ashtu, ai u dha udhëzime shtesë studentëve që do t’ju ndihmojnë atyre për zhvillimin e aplikacioneve.

Në kuadër të Akademisë së Sistemeve të Informacionit ka



ligjëruar profesori në UBT, Fisnik Prekzi. Për pjesëmarrësit ai trajtoi temën “Programimi i bazës së të dhënave”, që bëhet përmes programit Excel.

Ndër tjerash, ai tregoi për rëndësinë e të pasurit memorie RAM, me qëllim të ruajtjes së të dhënave të programit dhe kombinimin e mëtejshëm të fajleve.

Ligjëratat u përmbyll me shembuj konkret në program, në mënyrë që të krijohet më lehtë ideja se si duhet të punohet në programin Excel dhe se si mundemi të përcaktojmë të dhëna dhe t’i paraqesim statistikisht ato.

Pjesëmarrësit e Akademisë Ndërkombëtare Verore të Juridikut dhe të Sistemeve të Informacionit, kanë ndjekur ligjëratat e rregullta të profesorit nga Universiteti i Vjenës, Lothar Hoffman.

Profesori Hoffman ka ligjëruar për temën “Çështjen e mbrojtjes së të dhënave si pasojë e Rregullores së re”, temë kjo që tash e dy ditë po trajtohet në këndvështrime të ndryshme. Konkretisht, tema u fokusua në procesimin e kategorive speciale të të dhënave personave.

Në ANV-në e Sistemeve të Informacionit ka ligjëruar profesori në UBT, prof. dr Zhilbert Tafa, i cili shpjegoi për temën “IoT- Internet of Things”.

Ai ka sqaruar në terma të përgjithshëm këtë sistem i cili aktualisht po gjen zbatim në secilën fushë dhe jo vetëm në atë të informacionit.

Sipas profesorit Tafa, e rëndësishme ishte të fokusoheshin në dy domene të rëndësishme, si energjia dhe privatësia.

Pjesa e fundit e ligjëratës mbaroi me një prezantim nga studenti i UBT-së, Fatlondër Cakolli, që praktikisht shpjegoi për sistemin e ri të menaxhimit të kualitetit të ajrit duke përdorur sensorë.

Në ANV-në e Sigurisë Kibernetike dhe Privatësisë praktikohet hakimi i bardhë

Nisi punimet Akademia Ndërkombëtare Verore e Syber Security & Privacy, e cila është duke u mbajtur në Tiranë. Kjo akademi po mbahet falë bashkëpunimit me Autoritetin Kombëtar për Certifikim Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike AKCESK.

Hapjen e akademisë e bëri drejtoresha e AKSHI, Mirlinda Karçanaj, drejtoresha e AKCESK Vilma Tomco dhe përfaqësuesi i UBT-CERT Team Atdhe Buja.

Në ANV-në e Cyber Security & Privacy do ketë ligjërues nga gjithë bota si SHBA, Japonia, Evropa, Shqipëria, Kosova etj., të cilët do të mbajnë ligjëratat para studentëve duke trajtuar temat nga fusha të ndryshme si: IT Security, Communications Systems covering Windows and Linux Forensics, Network Security, Ethical Hacking, Data Privacy and Security, Cyber Forensic and Cyber Crimes, Mobile Forensics.

Akademiti verore në UBT

ANV-ja e Ekonomiks, Financa, Bankim, Sigurime dhe Ndërmarrësisë mbledh ekspertë të mirënjohur nga Kosova

ANV-ja e Ekonomiks, Financa, Bankim dhe Sigurime mbledhi ligjërues dhe ekspertë të njohur të këtyre fushave, përfshirë kryeekonomistin e BQK-së, Arben Mustafa dhe kryeshefin e ProCredit Bank, njëherësh kryetar i Shoqatës së Bankave të Kosovës, Ilir Aliu.

Në praninë e shumë pjesëmarrësve, kryeekonomisti Arben Mustafa ligjëroi për temën me titull: “Roli i BQK-së në stabilitetin e sistemit financiar në Kosovë”. Ndërkaq, kryeshefi i ProCredit Bank, Ilir Aliu ligjëratën e tij e fokusoi tek tema: “Performanca e sektorit bankar në Kosovë dhe Q&A”.

Akademia e fushës Ekonomiks, Financa, Bankim dhe Sigurime, në ditën pasuese të aktivitetit të vet, ka zgjuar interesim të madh në mesin e pjesëmarrësve, të cilët dëgjuan ligjëratë mbi sigurinë e të dhënave personale dhe për kriptovalutat, si monedha që janë përhapur e po përdoren pothuajse në gjithë botën.

Aktiviteti vazhdoi punimet me ekspertin për mbrojtjen e të dhënave, njëherësh edhe ligjërues në UBT, Blerton Abazi, i cili ligjëroi për temën “GDPR – implementimi në vendet joanëtare të BE-së dhe impakti financiar në organizata”.

Ai shtjelloi rregulloren e GDPR-it, duke filluar nga mbledhja e të dhënave personale, pastaj përgjegjësia për sigurimin e tyre dhe reagimi në rast të manipulimit të tyre.

Këshilltari financiar, Kreshnik Ahmeti mbajti ligjëratë me temë “A janë kriptovalutat zgjidhje për problemet aktuale të ekonomisë?”, në të cilën me theks të veçantë shpjegoi ndikimin e monedhave digjitale në fushën e ekonomisë dhe mënyrat e përdorimit të tyre për përmirësimin e kësaj fushe.

Në ANV-në e fushës Ekonomiks, Financa, Banka dhe

Sigurime, ka ligjëruar edhe drejtoresha e Bankës Ekonomike, njëherësh edhe ish-studente e UBT-së, Merita Gjyshinca – Peja.

Ajo u pjesëmarrësve të ANV-së për historinë e sistemit bankar në Kosovë, për zhvillimin e bankave ndër vite, praninë e tyre në Kosovë, për të vazhduar deri tek sfidat e bizneseve të sektorit të bankave dhe siguria kibernetike. Ndërkaq, ligjëratë u fokusua edhe tek strategjitë dhe praktikatat më të mira të menaxhimit.

Aktiviteti i Ekonomiks, Banka, Financa dhe Sigurime në Akademinë Ndërkombëtare Verore është përmbyllur me një vizitë studimore të kryer nëpër disa nga bankat e Kosovës.

Pjesëmarrësit kanë realizuar vizitë në BpB Bank dhe në ProCredit Bank, me ç’rast janë pritur nga zyrtarët e këtyre bankave, të cilët i njoftuan me organizimin e tyre, mënyrën e funksionimit, si dhe për mundësitë e punësimit për studentet e rinj.

Gjatë vizitës pati edhe diskutime me studentët, që ishin të interesuar të marrin informata rreth praktikave të këtyre bankave në aspekte të ndryshme të funksionimit të tyre. Aktiviteti i ANV-së së Ndërmarrësisë nisi me ligjëratën e profesorit Engelert Selenko, i cili ligjëroi për “Krijimin e ideve të projekteve”, teksa mori disa shembuj për pjesëmarrësit e ANV-së.

Ai i ndau studentët në grupe, të cilët prezantuan disa ide inovative për ndërmarrësi.

Tutje, pjesëmarrësit patën rastin të dëgjojnë ligjëratë nga drejtori për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Irfan Lipovica, i cili për temë diskutimi kishte “Ndikimin e MSA-së në konkurrueshmëri”.

Në kuadër të ANV-së së Fakultetit të Ndërmarrësisë dhe

Inovacionit u realizua vizitë në kompaninë “Buka-Meridian” dhe “Vipa”, me ç’rast u pritën nga menaxherja e prodhimit në Buka-Meridian, Vlora Imeri dhe nga menaxheri i prodhimit dhe cilësisë në Vipa, Agron Halimi. Gjatë kësaj vizite pjesëmarrësit patën rastin të shohin nga afër dhe të njoftohen me procesin e prodhimit të produkteve, ambientet dhe mjetet e punës, eksportin, importin, shpërndarjen në tregun vendor, si dhe janë njoftuar për sfidat dhe sukseset e këtyre kompanive.

Tutje, pjesë e punimeve të kësaj akademie ishte edhe ligjëruesi në UBT, Bejtush Ademi, i cili trajtoi temën me titull: “Inovacioni dhe modelet e biznesit”, me ç’rast trajtoi aspekte të ndryshme të të bërit biznes, si dhe ndikimin e inovacionit në të.

Kjo ligjëratë shënoi edhe përmbylljen e punimeve të ANV-së së Ndërmarrësisë dhe Inovacionit, pas një cikli ligjëratash e vizitash nëpër kompani të ndryshme vendore.



Në ANV-në e Karrierës, Edukimit dhe Psikologjisë ligjërohet për tema të ndryshme

Akademia Ndërkombëtare e Qendrës së Karrierës në UBT, ka zhvilluar punimet me ligjëruesin dhe ekspertin e njohur nga Maqedonia, Visar Ademi, i cili u ka shpjeguar pjesëmarrësve konkretisht për shkrimin e letrës motivuese dhe për intervistën në punë. Ai ka thënë se letra e motivimit shërben si letër e interesit, e cila u dërgohet organeve tek të cilat kandidatët janë të interesuar për të aplikuar për një vend pune ose për edukim të mëtejshëm.

Ademi tregoi se kjo letër shkruhet me fjalë të shkurta që paraqesin motivet dhe interesimin për vendin e punës ose për studime.

Tutje, ai tregoi sfidat me të cilat ballafaqohen kandidatët gjatë intervistave në punë, ku tha se qëndrimi, gjuha verbale, gjuha joverbale dhe veshja, janë elementet kryesore të një interviste të suksesshme.

Në ditën pasuese, dhjetë kompani nga Kosova dhe Shqipëria prezantuan produktet, punën, kushtet për punësimin të të rinjve në Panairin e Karrierës që u organizua në kuadër të ANV-së së Karrierës, që njëherësh shënon edhe aktivitetin përmbyllës të kësaj shkolle për këtë edicion.

Kompanitë pjesëmarrëse në këtë panair ishin: IPKO, Deloitte, Dua Punë, Raiffaisen Bank, Shkolla Digjitale, Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Banka për Biznes (BPB), Asseco, BeoSoftware, PECB dhe KPMG, të cilat paraqiten para studentëve të interesuar kushtet dhe detyrat që duhet t’i përbushin individët në mënyrë që të kenë mundësi praktike e punësimi.

Ky panair mundësoi krijimin e kontakteve mes studentëve dhe kompanive, madje shumë nga studentët pjesëmarrës patën mundësi që të aplikojnë për punë.

Studentët u ndanë shumë të kënaqur dhe sipas tyre kjo ishte një mundësi shumë e mirë pasi që konsiderojnë se kanë nevojë të marrin informacione mbi tregun e punës dhe kërkesat e tij.

Aktiviteti i Qendrës së Karrierës u mbyll me shpërndarjen e certifikatave për studentët pjesëmarrës të kësaj ANV-je.

Në ANV-në e Edukimit ligjërohet për mësimin e kombinuar, mendimin kritik, vlerësimin e studentëve dhe arsimin gjithëpërfshirës

Akademia Ndërkombëtare Verore e Edukimit ka zhvilluar aktivitetin e saj një ditë, me një cikël të ligjëratave ku janë trajtuar tema shumë të rëndësishme në fushën e edukimit.

Aktiviteti i kësaj akademie nisi me ligjëratën e rektorit të UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, i cili trajtoi temën me titull: “Mësimi i kombinuar; mësimi tradicional dhe përmes teknologjisë”, me ç’rast foli rreth kombinimit të teknologjisë në mësimdhënie

dhe mësimdhënie në institucionet shkollore, përfshirë edhe ato të nivelit universitar.

Rektori Hajrizi tha se për të pasur edukim modern duhet të sjellën praktikatat më të reja ndërkombëtare, ku sipas tij, profesorët duhet të përdorin metodologji dhe teknika për të arritur objektivat mësimore dhe synimet e shoqërisë.

Akademia e Edukimit punimet i vazhdoi me ligjëratën e drejtoreshës së departamentit të arsimit të lartë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Drita Kadriu, e cila ligjëroi temën me titull: “Mendimi kritik dhe lidhshmëri”.

Kadriu tha se mendimi kritik u mundëson liderëve në çdo nivel që të kuptojnë ndikimin e vendimeve të tyre në punës, si tërësi, dhe siguron përafrimin e qëllimit të organizatës dhe llogaridhënien në rezultate.

Tutje, në kuadër të ANV-së së Edukimit ka ligjëruar edhe profesoresha e Universitetit të Evropës Juglindore, Teuta Sali, ku prezantoi temën: “Arsimi gjithëpërfshirës”.

Ajo ka përmendur strategjitë mësimdhënies për arsimin gjithëpërfshirës dhe problemet me të cilat ballafaqohen nxënësit, ku tha se ato janë pasiguria, mungesa e të shprehurit, qasja negative etj.

Në fund ka ligjëruar edhe ekspertja e arsimit të lartë në Kosovë, Gjylbehare Llap, ku prezantoi temën me titull: “Vlerësimi i studentëve në kohërat digjitale dhe motivimi i studentëve”.

Llapi vlerësoi se teknologjia në fushën e edukimit ofron mundësi të larmishme dhe autenticitet në dizajnimin e vlerësimeve, përmirëson angazhimin e studentëve, përfshirje e shumë shkathtësive dhetributeve që vështirë, sipas saj, vlerësohen në mënyrë tjera etj.

Kjo ligjëratë shënoi edhe përmbylljen e punimeve të ANV-së së Edukimit, që në UBT organizohet për herë të parë në kuadër të edicionit të shtatë të Akademisë Ndërkombëtare Verore.

Në ANV-në e Psikologjisë, Rezilenca ishte temë bosht e këtij edicioni

Akademia Ndërkombëtare Verore e Psikologjisë, këtë vit u organizua për herë të parë nga Qendra Këshilluese për Studentë e UBT-së.

Tema që shënoi hapjen e kësaj akademie ishte “Rezilenca”, për të cilën ligjëruan disa ekspertë të kësaj fushe, duke i përfshirë në diskutim edhe dhjetëra pjesëmarrës të kësaj akademie.

Hapjen e kësaj akademie e bëri psikologjia dhe udhëheqësja e Qendrës Këshilluese për Studentë e UBT-së, Vjollca Pllana-Shahini, e cila e sqaroi në terma të gjerë domethënien e rezilencës dhe mënyrën se si arrihet deri tek ajo.

Në ligjëratën pasuese ligjëroi ligjëruesja në UBT, Violeta Zefi, e cila kryesisht u fokusua në faktorët kërcënues të këtij koncepti, si: stresi kronik dhe ngjarjet madhore jetësore.

Në kuadër të kësaj ANV-je ligjëratë interaktive mbajti profesori Dashamir Bërxulli, i cili zgjoi diskutim rreth luftës dhe çrregullimeve mendore në reziliencë.

Ndërkohë, Qendra Këshilluese për Studentë në UBT, në bashkëpunim edhe me Rrjetin e Edukatorëve Bashkëmoshatarë “PEN”, në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore realizuan punëtori dhe aktivitet të shumta me qëllim të zhvillimit të shkathtësive të komunikimit efektiv, shkathtësitë e buta, socializimit punës në grup, menaxhimit të konflikteve, zhvillimin e mendimit kritik dhe analitik, si dhe shkathtësive vendimmarrëse.

Po ashtu, pjesëmarrësit e ANV-së përfituan mundësinë e përfshirjes në projekte të ndryshme dhe të bëhen pjesë e të rinjve, të cilët me realizimin e aktiviteteve mund të evokojnë për riedukimin dhe integrim, për parandalimin e dhunës, promovimin e barazisë gjinore, përkrahjen e grupeve të margjinizuara.

Në kuadër të kësaj punëtorie Rrjeti i Edukatorëve Bashkëmoshatarë “PEN”, po ashtu prezantoi projektet dhe programet e ndryshme të cilat kanë për qëllim të fuqizimit e të rinjve në sfera të ndryshme jetësore si dhe ngritjen e shkathtësive të tyre për të bërë ndryshimin pozitiv në shoqëri.

Në vazhdim të trajtimit të temave në ANV-në e Psikologjisë, u fol për temën kryesore “Trauma dhe elementet e Reziliencës të cilat ndihmojnë në ballafaqimin dhe tejkalimin e saj”.

Tema “Trauma” u trajtua nga traumatapistja dhe drejtoresha e Qendrës Psikosociale për Traumatëri “Diakonie Kosova”, Xhevahire Balaj, e cila sqaroi se rezilencia si koncept i gjerë përfshin aftësi dhe shkathtësi të ndryshme individuale të personave, për të qenë rezistentë dhe për t’i përballuar vështirësive jetësore.

Para të pranishmëve ajo elaboroi më gjerësisht për shkaktarët që shkaktojnë trauma dhe faktorët mbrojtës të saj. Njëherësh ajo sqaroi edhe rolin dhe fushëveprimin e qendrës që ajo e udhëheqë.

Në kuadër të akademisë së Psikologjisë ligjëroi Vjollca Pllana-Shahini, psikologe dhe udhëheqëse e Qendrës Këshilluese për Studentë e UBT-së, bëri të ditur se kjo qendër është e vëmja e këtij lloji në Kosovë, ku studentëve u ofrohet përkrahje profesionale për vështirësitë dhe problemet me të cilat studentët përballen. Në ligjëratën pasuese është prezantuar platforma online “Nukjevet.net”, platformë e cila i dedikohet të rinjve dhe ka për qëllim të ofrojë këshilla online duke siguruar anonimitet të plotë.

Akademiti verore në UBT

ANV-ja e Arkitekturës, Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Dizajnit të Integruar të pasura me shumëllojshmëri temash

Akademia Ndërkombëtare Verore e Arkitekturës, mbajti aktivitetin me studentët e ndarë në grupe ku patën mundësinë të dëgjojnë ligjërata e të bëjnë ushtrime për fusha e dimensione të ndryshme të arkitekturës.

Hapjen e Akademisë e ka bërë dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, prof. dr Lulzim Beqiri, i cili para studentëve theksoi rëndësinë që ka ky aktivitet për ta.

“Përmes kësaj akademie do të mundohemi të sjellim module shtesë nga industria që lidhen me drejtimin tuaj, në mënyrë që të jeni sa më të përgatitur për tregun e punës” tha ai.

Menjëherë pas fjalimit, studentët u ndanë në grupe dhe vazhduan punën me ligjërues e tema të ndryshme.

Ligjëruesi në UBT, Binak Beqaj ka trajtuar temën “Transformimi urban/social i hapësirave publike”, i cili krahas ligjërimit për këtë temë, studentëve ua dha një detyrë, të cilën duhet ta mbarojnë deri në përfundim të këtij moduli. Qëllimi i kësaj detyre është që studentët jo vetëm të njihen me problemet urbane/sociale të hapësirave publike, por të ofrojnë edhe zgjidhje të cilat duhet të bazohen në funksionalizim urban të mirë, multifunksionalitet, ekologji dhe ruajtje të ambientit, eficiencë dhe racionalitet, gjithëpërfshirje në qasje dhe shfrytëzueshmëri, ruajtje të vlerave të trashëgimisë, identitet të ri dhe estetike.

Për tri ditë, studentët punuan në punë ekipore të mbikëqyruar nga asistentet, Blerta Vula, Modest Gashi, Sadije Kelmendi, Gresa Ramosaj.

Njëra prej fushave ku u fokusua kjo akademi është “Arkitektura digjitale” dhe për të ligjëroi asistenti në UBT, Faton Spahiu, i cili konkretisht trajtoi temën më titull “Ilustro me Ilustrator”.

Ai i njoftoi studentët me programin softuerik, “Ilustrator”, që shërben për dizajn grafik, manipulim me forma të ndryshme gjeometrike dhe dizajn të diagrameve arkitektonike.

Me anë të këtij softueri, studentët deri në fund të akademisë patën për detyrë të ilustronjë objekte me forma të ndryshme.

Ligjëratat vazhduan me Zekë Islamaj, ligjërues në UBT, i cili trajtoi temën “Arkitektura e brendshme dhe mobilet në arkitekturë”, në të cilën hyjnë projektimi, dizajnimi dhe ndërtimi i hapësirave të brendshme, që shfrytëzohen nga njeriu si objekte banimi, bare, hotele,

Ligjëruesi në UBT, Nexhat Balaj shtjelloi temën “Roli i zonave të gjelbra në mjediset urbane dhe arkitekturën e peizazhit”, ku theks të veçantë i kushtoi rëndësisë së këtyre zonave në mjedis, sa i kushtojnë rëndësi qytetet hapësirave të gjelbra, si dhe ndikimi i tyre në aspektin estetik të një vendi.

ANV-ja e Arkitekturës, në të cilën studentët janë ndarë në grupe punuese, ka vazhduar me aktivitetin intensiv me ligjërata nga profesorë dhe ekspertë të njohur.

Në modulin e ANV-së “Konkurset e Arkitekturës”, që nisi punimet për herë të parë në kuadër të këtij edicioni, është ligjërues për temën “Çështja e rëndësisë së konkurseve publike në fushën e arkitekturës”, për të cilën ligjëruan ligjëruesit Arbër Sadiki dhe Rron Tresi.

Në UBT, në kuadër të punimeve të ANV-së së Konkursit të Arkitekturës, u trajtuan temat rreth “Publikut dhe Arkitekturës”.

Ata ligjëruan për procesin e konkurimit në konkurset e mirëfillta, rëndësinë e pjesëmarrjes dhe atë të publikimit në platformën online.

Me studentët u diskutua rreth veprimeve që duhet të ndërmerren që të përmirësohet niveli i arkitekturës në vendin tonë.

Në modulin tjetër, profesori Artan Behluli sqaroi për pjesëmarrësit procesin e dizajnit, të materialeve, teknikave dhe prezantimit përmes modeleve në Arkitekturë, teksa u njohën edhe me historikun e modelimit, mjetet e punës që përdoren për modelim, teknikat themelore të montimit dhe përbërësit e modelit.

Pas tij, Betim Vitija nga COCRA-Concrete Crafts, në Prishtinë i njoftoi studentët me anën praktike në punën me Printerët Tredimensional.

Gjatë kësaj dite u trajtua edhe çështja e përdorimit të softuerit “Archicad”, për krijimin e modelit të energjisë së

ndërtimit dhe strategjive pasive për të përmirësuar performancën energjetike të ndërtesave, që ishte edhe modul në vete në kuadër të ANV-së.

Me këtë rast u trajtuan tema të tilla si: “Çka është BIM?”, “Çka është BEM?” dhe “Çka janë strategjitë pasive?”.

Profesori Ferhat Bejtullahu trajtoi problemet tipike në industrinë e ndërtimit, procesin BIM, ndikimin e BIM-it në problemet e industrisë, ndikimin e faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm klimatikë, si dhe strategjitë aktive dhe pasive.

Në kuadër të modulit “Mobile të brendshme në arkitekturë”, ligjëruesi Zekë Islamaj trajtoi dallimet mes arkitekturës së brendshme dhe dizajnit të brendshëm, kurse në veçanti u shtjellua çështja e mobileve në arkitekturë, evoluimi në kohëra të ndryshme në historinë e tyre, e deri tek kohët moderne të punimit të mobileve.

Në modulin e Arkitekturës Digjitale, nga ligjëruesi Faton Spahiu, pjesëmarrësve u tregoi rreth punës me programin e Ilustrator-it, përfshirë edhe krijimin e diagrameve dhe dizajnimin e objekteve.

Po ashtu, gjatë kësaj ligjërate studentët u njoftuan edhe me ndarjen e funksioneve për punët e bëra në këtë softuer. Në modulin “Mobilet e brendshme dhe arkitektura”, pas konsultimeve të punimeve dhe skicave për modelimin e bibliotekës dhe hapësirave të përbashkëta në hollin e kampusit të UBT-së, me ligjëruesin Zekë Islamaj, studentët patën rastin që të njihen nga afër me punën rreth mobileve, ku edhe realizuan vizita në fabrikën e mobileve “EL-NOR”, në të cilën u pritën nga drejtori i fabrikës, inxhinieri Milazim Ukaj.

Ndërsa, në pjesën e fundit të ligjëratës, studentët u njohën më detajisht rreth disa materialeve dhe produkteve të drurit dhe punës me to.

“Përdorimi i softuerit “ArchiCAD” për krijimin e modelit të energjisë së ndërtimit dhe të strategjive pasive, për të përmirësuar performancën energjetike në ndërtesa”, është moduli i cili po vazhdon të trajtohet nga prof. dr Ferhat Bejtullahu, i cili, së bashku me pjesëmarrësit, praktikoi veglat e modelimit të energjisë përmes softuerit të ArchiCAD-it dhe manipulimet me të për arritje më të madhe të performancës energjetike të ndërtesave.

Në modulin “Arkitektura Digjitale”, që po vazhdon të trajtohet nga ligjëruesi Faton Spahiu, po mësohen veglat e softuerit “Adobe Illustrator”, me ç’rast studentët po mësojnë dhe praktikojnë teknika të reja që punimet e tyre të kenë sa më shumë përmbajtje të qartë grafike dhe vizuale.

Në modulin “Procesi i dizajnit, materialet, teknikat dhe prezantimet përmes modeleve në Arkitekturë”, ligjëruesi Artan Behluli i udhëzoi studentët rreth finalizimit dhe krijimit të modeleve arkitektonike me teknikat me të favorshme që studentët të kenë mundësi të krijojnë modele më të bukura dhe më inovative gjatë realizimit të punimeve të tyre.

Profesorët në UBT, Arbër Sadiku dhe Rron Tresi, në modulin “Gara arkitektonike”, i kanë ndihmuar studentët në zhvillimin e ideve të ndryshme inovative, të cilat mund të kenë ndikim të madh tek institucionet dhe tek qytetarët, për trajtimin e gjendjes kaotike e cila është krijuar në kryeqytet në lëmin e arkitekturës.

Ndërsa në pjesën e dytë, së bashku me profesorët, studentët u konsultuan rreth ideve të tyre, me qëllim që të njëjtat të jenë sa me të plota dhe më të realizueshme.

Në modulin tjetër, studentët kanë qenë të ndarë në grupe, me ç’rast nën udhëheqjen e profesori Binak Beqaj, kanë punuar rreth temës “Transformimi ubrano-social në hapësirat publike”, teksa ideja e këtij projekti ishte që hapësirat e pashfrytëzuara të bëhen të shfrytëzueshme për qytetarët. Idetë e tyre ishin të larmishme dhe përgjatë prezantimeve të bëra u pa që studentët kishin punuar shumë në projektet e tyre dhe kishin zgjedhur objekte të ndryshme

për t’i shndërruar ato në parqe të fëmijëve, në fusha të sportit dhe në hapësira ku mund të argëtohen të gjitha grupmoshat.

Në modulin “Arkitektura dhe Gara” ka vazhduar me ligjërimin e ligjëruesve në UBT, Arbër Sadiki dhe Rron Tresi, të cilët realizuan një diskutim me studentë, ku shqyrtuan propozimet për intervenimet e mundshme për zhvillimin



Po ashtu, u punua edhe rreth idesë se si ta rrisim vëmendjen e gjitha shtresave të shoqërisë, duke filluar nga qytetarët, investitorët, arkitektët dhe institucionet udhëheqëse. Në modulin “Procesi i dizajnit”, profesorët, Artan Behluli dhe Betim Vitija, sqaruan procesin e projektimit, materialet, teknikat dhe paraqitjen përmes modeleve në, teksa pjesëmarrësit u njoftuan hap pas hapi me konceptin dhe teknikat e modelimit.

Ndërsa, në pjesën e dytë të ligjëratës, studentët patën mundësi që të praktikojnë në mënyrë grupore njohuritë e fituara në aspektin e modelimit.

Arkitektura Digjitale si modul në vete, u trajtua nga ligjëruesi Faton Spahiu, i cili sqaroi veglat kryesore të softuerit “Adobe Illustrator”, që ndihmojnë studentët që prezantimet e tyre finale në lëndët projektuese të përmbajnë më pak pamje teknike dhe më shumë përmbajtje profesionale, grafike dhe artistike.

Studentet zgjedhën që punimet të cilat i kanë përfunduar në lëndët projektuese t’i krijojnë konceptet në formë diagrami, duke përdorur softuerin e Ilustratorit si detyrë finale të modulit.

Moduli “BEM” solli në ANV-në e Arkitekturës ligjëruesin Ferhat Bejtullahu, i cili tregoi mbi përdorimin e softuerit “ArchiCAD” për krijimin e modelit të energjisë së ndërtimit dhe të strategjive pasive, për të përmirësuar performancën energjetike.

Tutje, u trajtua detajisht puna me modelet më të thjeshta të energjisë për ndërtesa, hapat për krijimin e një sistemi të energjisë, vlerat dhe përfitimet nga sistemi BEM, si dhe dallimet ndërmjet sistemit BEM dhe BIM, ku studentët, nën përkujdesjen e profesorit, patën rastin që ta praktikojnë dhe të ushtrorin detyra me sistemin BEM.

Në kuadër të modulit “Mobile të brendshme në arkitekturë”, profesori Zekë Islamaj trajtuan idenë e përfshirjes së bibliotekës në hapësirat e përbashkëta të fakultetit, më saktësisht trajtuan çështjen e shndërrimit të bufësë së tanishme në një hapësirë moderne dhe atraktive, ku përfshihen hapësira të ndryshme për kalimin e kohës së lirë, duke përfshirë bibliotekën, hapësirat rekreative për kalimin e kohës së lirë, etj.

Studentëve iu kërkua që të praktikojnë këto ide dhe të fillojnë të imagjinojnë zgjidhje rreth mundësisë më të mirë të mundshme duke i praktikuar ato në hollin e fakultetit.

Në pjesën e dytë të këtij moduli, arkitektja e enterierit, Sibel Spat ka ligjëruar në lidhje me enterierin dhe mobilet në arkitekturë, teksa studentëve u tregoi edhe disa punime të ndryshme nga portfolio.

Pjesëmarrësve të ANV-së u ligjëroi edhe profesori në UBT, prof. dr Nexhat Balaj, i cili trajtoi temën “Roli i hapësirave të gjelbra urbane dhe arkitektura e peizazhit”, teksa së bashku vizituan edhe Parkun e Qytetit, në Prishtinë, ku janë pyetur për gjendjen e parkut dhe nevojat për përmirësimin e gjendjes së tij.

Gjatë punës disaditore në grupe, studentët do të vazhdojnë

Akademiti verore në UBT

të japin disa ide dhe zgjidhje për mundësitë e përmirësimit të gjendjes së këtij parku, përfshirë shtimin e llojeve të drurëve dhe luleve sipas stinëve të vitit, mirëmbajtja e drurëve të parkut dhe shtimi i këndit të lojërave për fëmijë, shtimi i vendeve rekreative, si amfiteatri, etj.

Pas aktiviteteve të shumta intensive me punë praktike dhe ligjërata nga ekspertë të njohur vendorë e ndërkombëtarë, përmbylli punimet Akademia Ndërkombëtare e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT.

Në kuadër të ANV-së së Arkitekturës janë projektuar ide të shumta të pjesëmarrësve, ku paraprakisht me anë të ligjëratave teorike ata janë njoftuar me procesin e projektimit, konceptin dhe teknikat e modelimit etj.

Njohuritë e fituara studentët patën mundësinë që ti praktikojnë në mënyrë grupore, teksa punimet finale si detyrë e moduleve janë prezantuar në ditën e fundit të Akademisë së Arkitekturës.

Interesimi për të marrë pjesë në këtë Akademi ka qenë jashtëzakonisht i madh, derisa pjesë e kësaj shkolle ishin studentë vendorë dhe të huaj.

Pas përfundimit të punimeve të kësaj shkolle, pjesëmarrësit janë certifikuar si rezultat i vijimit të suksesshëm të akademisë.

Në ANV-në e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës – ligjërohet për ujërat e zeza dhe trajtimin e tyre

Para një numri të madh pjesëmarrësish ka zhvilluar punimet ANV-ja e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT.

Hapjen e Akademisë e bëri rektori i UBT-së prof.dr Edmond Hajrizi, i cili të pranishmit i njoftoi më shumë për rrjedhën e akademisë së sivjetme.

“Këtë vit jemi munduar të sjellim për diskutim tema nga fusha të ndryshme të Ndërtimitarisë që janë në interes të të gjithëve, si ujërat e zeza, mbrojtja dhe siguria në punë etj., tema këtyre që u duhet kushtuar rëndësi të veçantë secila kompani, por edhe sis”, tha Hajrizi.

Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës, prof. dr Muhamet Ahmeti theksoi se UBT po mundohet që përmes kësaj ANV-je të sjell trendet e fundit botërorë në inxhinieri.

“Me qëllim që të marrim shije nga zhvillimet e fundit në botë, ne kemi ftuar ekspertë e profesorë nga vendet evropiane, por edhe vendorë, kjo sepse çështjet që do të trajtohen përgjatë kësaj akademie janë të një rëndësie të madhe”, vlerësoi dekan Ahmeti.

Klaas Visscher, profesor në Universitetin e Shkencave të Aplikuara, në Holandë, tregoi më gjerësisht për veçantitë që ka trajtimi i ujërave të ndotura.

“Trajtimi i ujërave të zeza është një shkencë e integruar për të cilën nuk mjafton të jeni vetëm inxhinierë ndërtimorë, por duhet të keni njohuri edhe mbi mikroorganizmat, ndryshimet fiziko-kimike etj.”, u shpreh Visscher. Në ligjëratën hyrëse, Klass Hoek Spaans, student në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Holandë, trajtoi temën “Efekti i shkarkimit të ujërave të ndotura në ujë sipërfaqësor”.

Ai shtjelloi mënyrat e përdorimit të ujit nga industritë e ndryshme të cilat pas përdorimit të tij, atë e hedhin në lumenj, duke shkaktuar shkallë të lartë të ndotjes së ambientit.

Arnold Mulder, këshilltar mjedisor në Holandë, mbajti ligjëratën me temë “Karakterizimi i ujërave të zeza komunale”, ku me theks të veçantë ai u ndal tek rëndësia e rregullimit mjedisor që ndikon në ngritjen e nivelit të oksigjenit në një vend, si dhe parametrat që ndikojnë në rritjen e ndotjes së ujërave të zeza.

ANV-ja e Inxhinierisë së Ndërtimit pati ditën e saj më të pasur me ligjërata dhe me profesorë e ekspertë që qenë ligjërues.

“Makinat për punimet gjeoteknike”, “Propozimet e zgjidhjes së shpateve anësore nga rrëshqitjet e dheut në autostradën Ibrahim Rugova”, “Auditimi i sigurisë në kryqëzimin e rrugëve të Prishtinës”, “Trajtimi i bazës së ndërtimit duke aplikuar sistemin mbrojtës të diafragmës” dhe “Rrëshqitjet në Kosovë, domosdoshmëria e monitorimit të tyre”, janë të gjitha temat të cilat u diskutuan gjatë në ANV.

Ahmet Bytyqi, profesor në UBT, tregoi për ndryshimet historike që ndodhën ndër shekuj në aspektin e profesionalizimit të makinerive në fushën e ndërtimitarisë. Pos kësaj, ai, me anë të ilustrimeve para studentëve, shpalosi llojet e makinerive, si dhe zgjedhjen e duhur të tyre për vendin e

duhur ku do të përdoren.

Profesori në UBT, ndërkaq, Hysen Ahmeti shpalosi dy zgjidhjet që ai i kishte propozuar për zgjidhjen e problemit në autostradën “Ibrahim Rugova”, të cilat kanë nivel të lartë të sigurisë, dhe në të njëjtën kohë kanë edhe kosto jo shumë të lartë të realizimit.

Pjesën e dytë të ligjëratave e filloi eksperti i komunikacionit, njëherësh ligjërues në UBT, Nol Dedaj i cili studentëve u tregoi se si t’i evitojnë dhe përmirësojnë gabimet rrugore që ndodhin gjatë auditimit të rrugëve. Për këtë qëllim, të gjithë shembujt që u përdorën si ilustrim ishin gabimet në qytetin e Prishtinës dhe në Autostradën “Ibrahim Rugova”.

Ndërsa inxhinieri i ndërtimitarisë, Armend Mujaj shtjelloi para studentëve çështjen e kodeve që shërbejnë për projektimin e strukturave – Eurokodet, teksa theksoi se çdo inxhinier duhet t’i njohë fazat e para të projektimit.

Hazir Çadraku, profesor nga UBT, ligjëroi për studentëve arsyet e rrëshqitjeve të dheut dhe dëmet që bëhen nga ato. Ndër tjerash, ai i njoftoi studentët për rajonin që ka më së shumti rrëshqitje të dheut në Kosovë.

Akademia Ndërkombëtare Verore e Inxhinierisë së Ndërtimit ka vijuar me ciklin e ligjëratave të rregullta, teksa ka ligjëruar edhe dekanin e këtij fakulteti në UBT, dr. Muhmet Ahmeti.

Ai ka trajtuar temën: “Vlerësimi i mbrojtjes, sigurisë dhe shëndetit në punë në sektorin e ndërtimit”, i cili tha se si rezultat i nivelit të ulët të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë në sektorin e ndërtimit, si pasojë, humbin jetën punëtorët dhe shumë të tjerë mbesin të lënduar.

Në ANV-në e Ndërtimitarisë sot janë trajtuar edhe temat: “Sistemi i trajnimit në KEK për sigurinë e punës dhe aplikimin në fushën e Inxhinierisë Civile”, nga Safet Ymeri, “Betoni në masë”, nga Driton Kryeziu”, “Siguria në punë që ndërlidhet me Inxhinierinë Civile”, nga Elvida Pallasaka, “Problemet me të cilat ballafaqohet industria e ndërtimit dhe ekspozimet e sistemit të ndërtimit”, nga Afrim Sylja.

Në kuadër të ANV-së së Inxhinierisë së Ndërtimit dhe infrastrukturës u realizua vizitë në kompaninë për prodhimin e betonit “Vëllezërit e Bashkuar”, në Prizren.

Studentët, ishin të shoqëruar nga profesorët, Visar Krelani dhe Driton Kryeziu, me ç’rast ky i fundit i njoftoi pjesëmarrësit e ANV-së nga afër me makinerinë që e posedon kompania, ciklin e prodhimit të betonit dhe prodhimin të kubëzave të betonit.

Pos kësaj, studentët patën rastin të shohin edhe laboratorin për testim, ku para tyre u testuan mostra të copëzave të ndryshme të betonit.

Më pas studentët vazhduan vizitën në gurthyesin e kësaj kompanie, në të cilin atyre iu shpjegua në tërësi procesi i përfundimit të zallit nga përpunimi i gurit.

Udhëtimi vazhdoi për në kampusin e UBT-së, në Prizren, ku studentët u pritën nga profesori Vehbi Sofiu, i cili edhe i njoftoi më shumë për ambientet, infrastrukturën dhe sallat e mësimit.

Inxhinieria e Ndërtimit mbylli punimet në kuadër të ANV-së së UBT-së, ku përgjatë pesë ditëve janë mbajtur një varg ligjëratash tematike nga ligjërues vendorë e ndërkombëtarë, në lidhje me çështjet më të përfolura momentalisht në Kosovë.

Para certifikimit për kontributin e tyre, pjesëmarrësit dëgjuan ligjëratë nga profesori Ilir Hetemi, i cili shpjegoi mbi murit sizmike dhe projektimin e tyre.

Për të njëjtën çështje ligjëroi edhe profesori Arsim Rapuca, i cili trajtoi temën: “Mbështetësit për izolim sizmikë në ura”, me ç’rast shpjegoi për dëmtimet në ura, ngarkesat sizmike në ura, si dhe për mbështetësit e tyre.

Pas përfundimit të ligjëratave, ANV-ja e Inxhinierisë së Ndërtimit u përmbyll me certifikimin e pjesëmarrësve që kanë qenë pjesë e kësaj shkolle.

Në ANV-në e Dizajnit të Integruar ligjeronë artistë e dizajnerë të njohur

Akademia Ndërkombëtare Verore e Fakultetit të Dizajnit të Integruar ka zhvilluar punimet, me një numër jashtëzakonisht të lartë të pjesëmarrësve.

Në hapje, dekan i Fakultetit të Dizajnit të Integruar, Ajhan Bajmaku tregoi se kjo akademi ka një laramani temash, të cilat do të pasurohen me pjesën praktike të punës.

Për rëndësinë e kësaj akademie foli edhe dekanin e Fakultetit



të Arkitekturës në UBT, prof. dr Lulzim Beqiri, i cili potencoi se kjo akademi do të ketë karakter artistik, gjë sipas tij, mungon në shumë profesione të tjera.

Dekan i Fakultetit të Dizajnit të Integruar, Ajhan Bajmaku tregoi se kjo akademi ka një laramani temash, të cilat do të pasurohen me pjesën praktike të punës.

Temat që u trajtuan gjatë ditës së parë ishin: “Metodat e përdorimit të artit në vende publike” dhe “Moda e Qëndrueshme”, ligjërues të së cilave ishin artisti Vladan Jeremic dizajnerja e njohur, Afërdita Statovci.

Artisti Vladan Jeremic para pjesëmarrësve shpalosi disa nga instalacionet e tij në vende të ndryshme publike, teksa iu tregoi edhe metoda arti për thyerjen e barrierave në shoqëri përmes instalacioneve artistike.

Dizajnerja, njëherësh edhe profesoresha në UBT, Afërdita Statovci e trajtoi modën nga një prizëm tjetër, nga ai i shkencës, meqë sipas saj, çdo ditë e më tepër është duke u njohur si shkencë në vetë.

Ligjërata pasoi me një ushtrim praktik, ku pjesëmarrësit mësuan se si mund të krijohen rrobat e reja nga ato të përdorura.

Akademia e Dizajnit të Integruar ka realizuar njërën nga aktivitetet më të rëndësishme dhe më të atraktive të kësaj shkolle.

Artisti Karlo Mustafa ka mbajtur punëtorinë “Jehona e Skulpturës”, me ç’rast synoi të demonstrojë një formë të praktikave skulpturore në artin bashkëkohor dhe mundësitë përtej nocionit të thjeshtë të informacionit të skulpturës si një objekt.

Kjo punëtori i lejoi studentët pjesëmarrës të punonin me procesin e hedhjes së sheqerit si material për të bërë vepra arti.

Nxënësit u ndanë në grupe, dhe secili grup bëri një vepër arti që punonte me objekte të ndryshme që ata gjetën përreth. Pas kësaj, ata mblodhën punët e tyre dhe instaluan një të vetme.

Moduli përfundoi me ‘detyrat e shtëpisë’, për të dhënë përkufizimin e fjalëve: vepruar, skulpturë, subjekt, publik, impuls, stendë, etj.

Pjesa e dytë e akademisë vijoi me ligjëratën e dizajnerëve, Afërdita Statovci dhe Mendime Gashi, të cilat vazhduan mësimin e pjesëmarrësve për konceptet se si të mendojnë që të krijojnë modën nga gjëra të ndryshme, kryesisht të përdorura më parë.

Gjatë kësaj ligjërata u shpalosën dhe u diskutuan punimet e studentëve gjatë viteve të studimeve, në Fakultetin e Dizajnit të Integruar.

Në ANV-në e Dizajnit të Integruar ka ligjëruar edhe Tefik Rada, kritik i artit, i cili ka prezantuar temën “Metropoli, montazhi dhe filmi”. Ai ndau me studentët përvoja të tij këtë fushë, si dhe dha vlerësime rreth artit në Kosovë.

Në Akademinë e Dizajnit të Integruar ligjëroi edhe artisti, Bekim Retkoceri, i cili bashkërisht me studentët ka zhvilluar punë praktike, ku qëllimi i punimeve ishte koordinimi i trurit me dorën.

Në ANV-në e Dizajnit të Integruar ligjëroi artistja e njohur kosovare Rudina Xhaferi, e cila ka trajtuar temën më titull: “Rudinizmi”, me ç’rast ajo ndau përvojat e saj në fushën e skenografisë, dizajnit të modës.

Duke folur për rudinizmin, Xhaferi ka thënë se në këtë fushë është shumë e rëndësishme tipografia e modës urbane. Akademia Ndërkombëtare Verore e Dizajnit të Integruar për disa ditë me rrallë ka mbledhur ligjërues të shumtë e artistë të njohur nga vendi dhe bota. Ata ligjëruan tema shumë në interes të kësaj fushë, teksa i mbylli punimet me certifikimin e pjesëmarrësve.

Akademiti verore në UBT

Aktivitetet e Fakulteteve të Shkencave Politike dhe Juridikut në Akademinë Ndërkombëtare Verore

Akademia Ndërkombëtare e Shkencave Politike mbledhi në UBT ish-gjeneralët e NATO-s dhe ekspertë ndërkombëtarë të sigurisë, të cilët simuluan mënyrën e punës, funksionin dhe procesin e vendimmarrjes në NATO.

Kjo akademi u pasua me një cikël ligjëratah, qëllimi kryesor i të cilave ishte futja e studentëve në rrjedha të mënyrës së funksionimit të NATO-s, si dhe përgatitja e tyre për përfaqësim sa më të denjë në seancën e simulimit.

Ish-gjenerali i NATO-s, tash pjesëtar i Kolegjit të Mbrojtjes të NATO-s, Giuseppe Morabito, sqaroi konceptet, interesin dhe pozicionet aktuale të organizatës, teksa vuri në pah çështjet të cilat aktualisht po i preokupojnë më së shumti çështjet e shteteve anëtare.

Morabito tha se çështjet që për momentin gjenden në fokus të organizatës i kanë ndarë shtetet anëtare në dy pjesë.

“Një grup i shteteve anëtare janë të mendimit që Rusia përbën një problem në vete, për shkak të tendencave për destabilizim të vendeve që kanë luhajtje në demokraci. Ndërkaq, grupi i dytë pohon se problemi real është migrimi ilegal dhe terrorizmi i përhapur në botë”, potencoi ai.

Morabito tregoi se shtetet anëtare të NATO-s mblidhen çdo dy vite për të diskutuar mbi çështje të ndryshme dhe për të marrë vendime që lidhen me të gjitha shtetet anëtare të NATO-s dhe, sipas tij, kjo është edhe arsyeja se pse kjo punëtori simulimi është kaq e nevojshme për studentët e UBT-së, në mënyrë që ata të kenë ide se funksionon NATO.

“Duhet të bëhet ky ushtrim për të ditur se cila do të jetë e ardhmja juaj, andaj e kaluara duhet të lihet prapa sepse vetëm e ardhmja ka rëndësi”, konstatoi Morabito.

Eksperti i çështjes së sigurisë, Kevin Koehler i njoftoi pjesëmarrësit me strukturën, procedurat, rregullat dhe rregullat jozyrtare, në mënyrë që simulimi të bëhet sa më real.

“NATO shquhet për mbrojtjen e anëtarëve dhe partnerëve të vet. Nëse njëri nga aleatët sulmohet, konsiderohet se janë duke u sulmuar të gjithë anëtarët. Mirëpo, duhet pasur parasysh që NATO nuk është një organizatë sulmuese, por mbrojtëse”, theksoi Koehler.

Ai tregoi se NATO i merr vendimet diplomatike në komitetin diplomatik dhe kjo bëhet vetëm atëherë kur të gjitha vendet anëtare të gjejnë konsensus.

Drejtori ekzekutiv i Institute of Southeast European Studies, njëherësh edhe profesor në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Enver Bytyçi trajtoi çështjen e konfliktit shqiptaro-serb dhe rrjedhat që e karakterizuan këtë konflikt mesjetar.

“Që nga Mesjeta, Serbia e ka pasur për synim që t’i aneksojë trojet shqiptare dhe ta asimilojë popullsinë vendase, por kjo tendencë mori nuanca të konfliktit të hapur në vitet e ’90-ta, për të përfunduar me ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë”, sqaroi Bytyçi, duke sqaruar edhe arsyet që e shtynë këtë organizatë drejt një vendimi të tillë.

“Nuk mund të rrezikohet shfarosja e një populli të tërë, qëllimi i dobësisë të ushtrisë serbe që të mos ndërhyjë në vende të tjera dhe mosbindja e Serbisë ndaj bashkësisë ndërkombëtare për shuarje të konfliktit ndaj Kosovës, janë vetëm disa nga arsyet pse vendet aleate e ndihmuan Kosovën, dhe të njëjtat arsye i përdori edhe presidenti Clinton për të arsyetuar ndërhyrjen në Kosovë para popullit amerikan”.

Në të njëjtën vijë pasoi edhe ligjërata e ish-gjeneralit të NATO-s, Giorgio Battisti, i cili pohoi se NATO nuk është organizatë që tenton të sulmojë, por që synon që të gjitha konfliktet t’i zgjidhë në mënyrë paqësore dhe pa armë.

“NATO nuk ka për qëllim që të armiqësohet me ndonjë vend, po ka për synim t’i mbrojë vendet që përfshihen në kuadër të saj ose edhe ata që nuk kanë forcë të mbrohen kur sulmohen padrejtësisht, duke u mbështetur në fuqinë njerëzore e ushtarake dhe në pajtim të plotë me 29 vendet anëtare”, theksoi Battisti.

Pas ligjëratave, studentët pjesëmarrës mësuan nga

këshilltarët për simulim në NATO, Cornel Turdeanu dhe Jazlyn Melnychuk, se cilat janë procedurat nëpër të cilat do të kalohet përgjatë simulimit, si dhe sqaruan procesin, qëllimin e debatit dhe këshillat që çojnë drejt suksesit dhe përfaqësimit sa më të denjë.

Simulimi treditore i bërë nga delegatët imagjinarë të shteteve të ndryshme të botës, rol i ushtruar nga pjesëmarrësit e ANV-së së Shkencave Politike, ka përfunduar me arritjen e konsensusit të të gjitha palëve, sa i përket zgjidhjes së konfliktit fiktiv mes Rusisë dhe Ukrainës.

Ky similib përbën një ngjarje tejet unike për shkak se një aktivitet i tillë është i pari i pari këtij lloji i organizuar ndonjëherë në një institucion arsimor, por edhe për faktin se ky aktivitet u organizua dhe u mbajt nga ish-gjeneralët e NATO-s, tash anëtarë të Fondacionit të Kolegjit të Mbrojtjes të NATO-s.

Me një ceremoni të veçantë dhe në praninë e dhjetëra pjesëmarrësve u përmyll Akademia Ndërkombëtare Verore e Shkencave Politike, madhështinë e së cilës e shtoi edhe më shumë prania e delegacionit të KFOR-it, i kryesuar nga komandanti, Major Gjeneral, Salvatore Cuoci, i cili edhe i ndau certifikatat e pjesëmarrjes për studentët që morën pjesë në këtë akademi.

I lumtur për këtë përfundim dinjitoz të akademisë, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se kjo është hera e dytë që UBT po bashkëpunon me KFOR-in për organizimin e kësaj akademie, teksa u shpreh i bindur që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në vitet në vijim.

“Ne po mundohemi tërë kohën që t’i bëjmë të vetëdijshëm të rinjtë tanë mbi rëndësinë e të ardhmes dhe ndërtimit të paqes. Megjithatë, aktiviteti ynë gjatë kësaj akademie do të vazhdojë edhe me fusha të tjera, pasi në UBT janë duke u zhvilluar e do të zhvillohen edhe 20 sosh”, theksoi Hajrizi.

Komandanti i KFOR-it, Major Gjeneral Salvatore Cuoci tha se eprorët që u kanë ligjëruar pjesëmarrësve janë të klasit të parë dhe se ata janë shumë me fat që kanë pasur mundësi të marrin njohuri më të thella prej tyre.

“Është e shumë e rëndësishme ta kuptoni mënyrën sesi NATO-ja punon, sepse Kosova ka qëllim të jetë pjesë e saj në një të ardhme. Ju jeni e ardhmja e Kosovës, andaj duhet të jeni të përgatitur”, ishin fjalët me të cilat komandanti Cuoci iu drejtua studentëve pjesëmarrës.

Ish-gjenerali i NATO-s dhe anëtar i Fondacionit të Kolegjit të Mbrojtjes të NATO-s, Giuseppe Morabito vlerësoi se kjo akademi e ka arritur efektin dhe ka përfunduar në mënyrë më të mirë të mundshë.

“Punëtorja ka qenë një lloj simulimi për studentët, për të parë mënyrën se si ambasadorët e vendeve të Këshillit Veriatlantik mbajnë mbledhje dhe marrin vendime kur ndodh diçka nëpër zonat që janë nën përgjegjësinë e NATO-s”, tregoi ai.

Aktiviteti i ANV-së së Shkencave Politike u mbyll me ndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit, të cilët u ndanë të kënaqur nga ky organizim dhe u shprehën të gatshëm që këto njohuri t’i shfrytëzojnë kurdo nëpër konferenca e punëtori për ndërtimin e paqes.

Në Akademinë Ndërkombëtare të Juridikut ligjërohet për reformimin, sfidat e sistemit të drejtësisë dhe për rregullimin e mediave

Fakulteti i Juridikut në UBT, ka zhvilluar punimet me aktivitete e ligjërata në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore, ku përgjatë disa ditëve do të ligjërojnë ekspertë të fushës përkatëse, vendor e ndërkombëtar.

Hapjen e këtij aktiviteti e ka bërë ligjëron drejtori i Laboratorit Forenzik në Policinë e Kosovës, njëherësh ligjëruesi në UBT, Blerim Olluri, i cili ka ligjëruar temën “Përfshirja e provave shkencore në strategjinë e avokimit”.

Duke trajtuar këtë temë, Olluri ka diskutuar rreth provave materiale ku tha se mund të klasifikohen në dëshmitë direkte, dëshmi rrethore dhe dëshmi të vërteta. Teksa, sipas tij, në këndvështrimin e shkencës së forenzikës dëshmitë kanë karakteristika klasore dhe individuale.

Po ashtu, ai ka folur rreth mbledhjes së provave materiale, ku tha se për mbledhjen e dëshmive, varësisht nga lloji, gjendja dhe kushtet në të cilën gjenden gjurmët, duhet të përdoren pajisje dhe teknika e veçantë. Dëshmitë më të ndjeshme, sipas tij, janë gjurmët e gishtërinjve, pastaj gjurmët e gjakut dhe mikrogjurmët.

Akademia Ndërkombëtare Verore e Juridikut, pas një mori temash mbi ligjin dhe të drejtën, ka fokusuar debatin në rolin e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së në procesin e integritimit evropian.

Ligjërata u mbajt nga drejtori ekzekutiv i Institutit Evropian për Politikë Publike, Emrush Ujkani.

Pjesa e dytë e modulit nisi me ligjëratën e profesorit nga Universiteti i Vjenës, Lothar Hoffman, i cili e fokusoi ligjëratën e tij tek tema me titull: “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në moshën digjitale”, si një sferë e drejtësisë që po diskutohet kudo në botë, kjo për shkak të ndikimit të teknologjisë në sistemin e drejtësisë.

Në Akademinë Ndërkombëtare Verore të Juridikut pjesëmarrësit ndoqën leksione nga ligjëruesja në Universitetin e Tiranës, Brikena Kasmi, e cila trajtoi çështjen e rregullimit të mediave nga prizmi i së drejtës ligjore.

Ajo trajtoi llojllojshmërinë e mediave, ndikimin e tyre në shoqëri, dallimin në mes mediave publike e private, si dhe keqpërdorimin dhe manipulimin që vjen nga mediat për interesa të caktuara.

Në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore të Fakultetit Juridik dhe atë të SI-së, ka ligjëruar profesori nga Universiteti i Vjenës, Lothar Hoffman, i cili në pjesën e parë të ligjëratës ka vazhduar me temën “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në epokën digjitale”, teksa ligjëratën e pasuroi me ndarjen e përvojave të tij personale gjate viteve të punës në këtë aspekt.

Pjesa e dytë e ligjëratës u fokusua në temën me titull: “Çështjet e mbrojtjes së të dhënave si pasojë e Rregullores së re”, ku sqaroi zgjidhjet më të thjeshta, më fleksibile, më të thjeshta dhe më të sigurta në fushën e ruajtjes dhe mbrojtjes së të dhënave.

Hoffman përmendi edhe parimet e paanësisë, pavarësisë, efikasitetit, efektivitetit të procesit të duhur, drejtësisë, llogaridhënies dhe transparencës, si elemente që e pasurojnë fushën.

Në ANV-në e Juridikut janë zhvilluar një cikël ligjëratah, nga të cilat pjesëmarrësit morën të dhëna mbi funksionimin dhe rolin e Odës së Avokatëve të Kosovës, si dhe për reformimin e sistemit të drejtësisë në vend.

Kryetarit i Odës së Avokatëve të Kosovës, Osman Havolli, të pranishmëve iu shpjegoi për organizimin dhe funksionimin, rëndësinë dhe përbërjen e OAK-së.

Ligjëruesi në UBT, Ismail Zejneli trajtoi çështjen e globalizimit dhe reformimit të sistemit të drejtësisë.

Ai i informoi pjesëmarrësit me aspektin e reformimit ligjor, si dhe për definimin e konceptit të globalizimit e ndikimin e tij në aspektin ligjor, proces prej të cilit janë krijuar edhe disa ligje të reja, siç është ai i Të Drejtës së Autorit.

Aktiviteti i Akademisë Ndërkombëtare Verore të Fakultetit Juridik në UBT, është përmyllur me praktikimin e mësimëve teorike që janë trajtuar nga ligjëratat tematike përgjatë disa ditëve.

“Shitblerja, posedimi dhe shpërndarja e substancave narkotike” ishte simulimi seancës gjyqësore që u zhvillua nga studentët e kësaj fushe. Në këtë aktivitet studentët ishin ndarë në role të ndryshme si: gjykatës, prokurorë, avokatë dhe të akuzuar, teksa seanca udhëhiqej nga prokurori disiplinor në Odën e Avokatëve të Kosovës, Florim Shefqeti.

Iniciativa për një shfaqje të tillë ishte nga dekanja e Fakultetit Juridik në UBT, Jorida Xhafa, derisa për të parë performancën e studentëve në simulimin e seancës gjyqësore të pranishëm ishin prindër e familjarë, si dhe mysafirë të shumtë.

Në fund studentët u pajisjen me certifikata për vijueshmëri dhe për simulim të seancës.

Akademitë verore në UBT

ANV-ja e Medias dhe Komunikimit pasurohet me aktivitete të shumta

Akademia Ndërkombëtare Verore e Fakultetit Media dhe Komunikim, që këtë vit vjen me një formë të veçantë të veprimtarisë, ka tërhequr numër të madh pjesëmarrësish edhe nga jashtë.

Ky edicion i ANV-së së Medias dhe Komunikimit ka ofruar një mundësi të jashtëzakonshme, ku pjesëmarrësit do të bëjnë përcjelljen e ngjarjeve, shkrimin e lajmeve, realizimin e fotografive, montazhin e videove, si dhe realizimin e intervistave me personalitete të ndryshme vendore e ndërkombëtare, e tërë kjo do të zhvillohet në kuadër të 24 shkollave verore të ANV-së.

Dekani i Fakultetit Media dhe Komunikim, Ferid Selimi dhe ligjëruesi në UBT, Safet Zejnullahu, kanë ligjëruar për mënyrën e shkrimit të lajmit dhe të bërit gazetari. Kurse, tutorja në këtë fakultet, Anisa Rada ka shpjeguar për pjesën e fotografisë, montazhit, organizimit dhe rregullave të akademisë.

Po ashtu është mbajtur edhe pjesa praktike e përgatitjes së redaksisë, me ç'rast secilit pjesëmarrës do t'i ofrohet mundësia e njohjes dhe e takimit me studentë të programeve të ndryshme e institucioneve të shumta arsimore, si dhe njohja dhe kontakti me njerëz nga fusha të ndryshme, industria dhe nga jeta akademike.

Pjesëmarrësit e Akademisë Ndërkombëtare Verore të Medias dhe Komunikimit në mënyrë aktive po përcjellin gjitha ngjarjet që po zhvillohen në 24 shkollat e ANV-

së, të cilët po shkruajnë lajme, realizojnë fotografi, bëjnë montazhin e videove, si dhe po realizojnë intervista të shumta me studentë dhe ligjërues vendorë e ndërkombëtarë.

Sipas tyre, kjo është një mundësi e jashtëzakonshme sepse ky edicion i ANV-së ju ndihmoi atyre për të zhvilluar punën praktike në fushën e medias dhe komunikimit, konkretisht në sektorin për Media Sociale, Sektori për Multimedia, Sektori për Publikime të lajmeve etj.

Për të realizuar detyrat e tyre, ata u ndihmuan edhe nga Media Grupi i UBT-së, nga të cilët pjesëmarrësit u këshilluan profesionalisht rreth angazhimeve të tyre ditore në gjithë sektorët.

Lajmet dhe njoftimet për shtyp në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore në UBT, pjesëmarrësit i zhvilluan në bashkëpunim me Media Grupin e UBT-së, të cilat edhe u publikuan në kanalet e institucionit apo mediat sociale, siç është Facebook-u, Instagrami, YouTube.

ANV-ja e Medias dhe Komunikimit ishte ndër shkollat më të larmishme dhe më të pasura të këtij edicioni.

Përgjatë dy javëve, pjesëmarrësit e kësaj akademie përcjellën aktivitete të të gjitha shkollave tjera të akademisë, teksa vazhdimisht morën edhe njohuri mbi realizimin e fotografive dhe videove.

Një ligjëratë e tillë është mbajtur nga tutorja në UBT, Anisa Rada, e cila iu dha studentëve informacione bazike mbi përdorimin e programit Adobe Premiere, me qëllim

të realizimit të videove profesionale.

Ndër tjerash, ajo i njoftoi pjesëmarrësit me hapat e parë të krijimit dhe editimit të videove, teksa paralel me të, në laboratorin e këtij fakulteti, punonin edhe ata.

Pas një pune intensive me aktivitete e ngjarje të shumta, mbylli punimet Akademia Ndërkombëtare Verore e Medias dhe Komunikimit, e cila këtë vit u veçua me një numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish nga institucionet tjera arsimore të Kosovës dhe më gjerë.

Për tri javë rresht, pjesëmarrësit e kësaj akademie përcollën aktivitetet e 24 shkollave verore që vijuan punimet gjatë gjithë korrikut, me ç'rast për të njëjtat realizuan qindra artikuj dhe mijëra fotografi e video, të cilat u shfaqën të përmbledhura në një video të vetme.

Në këtë ANV nuk munguan as ligjëratat tematike mbi raportimin dhe shkrimin e duhur të lajmeve, realizimin e fotografive profesionale dhe montimin e videove, teksa akademia u pasurua edhe më shumë me punëtorinë për shkrim, lexim dhe mendim kritik, "PONDER", e realizuar në bashkëpunim me Unicef-in.

ANV-ja e Medias dhe Komunikimit u përmbyll me shpërndarjen e certifikatave për të gjithë pjesëmarrësit për praninë e tyre në akademi, si dhe për pjesëmarrjen në punëtorinë "PONDER", nga e cila katër studentë të përzgjedhur patën mundësi të vijojnë punën praktike njëmuore në njërin nga mediumet vendore.

Në ANV-në e Infermierisë, Stomatologjisë dhe Farmacisë ligjërojnë ekspertë vendorë e ndërkombëtarë

Fakulteti i Mekatronikës në UBT, ka filluar punimet me aktivitete e ligjëratat në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore, ku përgjatë gjashtë ditëve ligjëruan ekspertë të fushës përkatëse, si nga vendi ashtu edhe nga bota.

Hapjen e këtij aktiviteti e ka bërë ligjëruesi në UBT, Xhemajl Mehmeti, ku është fokusuar në temën: "Struktura Mekanike e Automjeteve", i cili u ka shpjeguar pjesëmarrësve krahasimin e automjeteve klasike me ato elektrike.

Ai për pjesëmarrësit ka prezantuar koncepte themelore të ndërtimit të automjeteve, po ashtu për dinamikën e automjeteve dhe për sistemet e automjeteve elektrike.

Profesor Xhemajli ka folur edhe për ndikimin që aktualisht automjetet elektrike kanë në zvogëlimin e ndotjes së ambientit.

"Kontrolli i makinave elektrike" ishte tema e radhës që u ligjërua e diskutua në ANV-në e Mekatronikës, temë e cila tërhoqi vëmendjen e shumë studenteve të këtij drejtimi.

Ligjëratat u mbajt nga profesori në UBT, Bertan Karahoda, i cili shpjegoi për studentët rreth komponentëve elektronikë që punojnë dhe kontrollojnë sistemet me fuqi të lartë.

Ai gjithashtu tregoi edhe për analizën e elementeve të fuqisë elektronike, që kontrollojnë shpejtësinë e motorëve, minimizojnë humbjet dhe e rrisin efikasitetin e veturave elektrike.

Pjesëmarrësit nga universitete publike dhe private të vendit, në ANV-në e Mekatronikës morën informacione nga profesori i Universitetit të Pavis në Greqi, dr Peter Groumpos, në lidhje me temën: "Automjetet Elektrike Autonome".

Ligjëratat e profesorit Groumpos nisi me një bisedë interaktive me pjesëmarrësit, për të vazhduar me temën kyçe, e që u fokusua tek njohja më e thellë e veturave elektrike, përparësitë dhe të metat e tyre, gjithnjë duke e shoqëruar teorinë me shembuj konkretë.

"Kontrolli i makinave elektrike" ishte tema e radhës që u ligjërua e diskutua në ANV-në e Mekatronikës, temë e cila tërhoqi vëmendjen e shumë studenteve të këtij drejtimi.

Ligjëratat u mbajt nga profesori në UBT, Bertan Karahoda, i cili shpjegoi për studentët rreth komponentëve elektronikë që punojnë dhe kontrollojnë sistemet me fuqi të lartë.

Ai gjithashtu tregoi edhe për analizën e elementeve të fuqisë elektronike, që kontrollojnë shpejtësinë e motorëve, minimizojnë humbjet dhe e rrisin efikasitetin e veturave elektrike.

"Funksionimi dhe benefitet e motorëve elektronikë në krahasim me modelet e motorëve", është tema që u trajtua në ANV-në e Mekatronikës, e që ngjalli interesim të madh në mesin e pjesëmarrësve, sidomos për faktin që një temë e tillë është jashtë kurrikulës studimore.

Ligjëratat u mbajt nga profesori në UBT, Valmir Hoxha, i cili për studentët tregoi nevojat dhe kërkesat e industrisë që ka për llojet e motorëve.

Ai shpjegoi format e mbrojtjes së ambientit me përdorimin e këtyre motorëve, koston e ulët dhe eficiencën që buron prej tyre.

ANV-ja e Mekatronikës përmbylli aktivitetin me ligjëratën e profesorit në UBT, Bertan Karahoda.

Ai trajtoi temën "Elektronikë e energjisë", me ç'rast bëri krahasim ndërmjet llojeve të ndryshme të kompjuterëve, si dhe mënyrën e shndërrimit të energjisë elektrike në energji mekanike.

Ligjëratat zgjoi interesim të madh ndër studentë, të cilët shfaqën ide dhe koncepte të reja mbi këtë sferë.

Akademinë e kësaj fushe gjatë tërë edicionit u pasuruan profesorë të shumtë vendorë e ndërkombëtarë, që trajtuan tema të trendëve të fundit botërorë.

Dhjetëra pjesëmarrës dëgjojnë ligjëratë mbi përfitim in-ovativ të energjisë nga dielli dhe ndërtimin me energji zero. Ka zhvilluar punimet Akademia Ndërkombëtare Verore e Inxhinierisë së Energjisë, e cila përgjatë disa ditëve ka mbledhur dhjetëra pjesëmarrës të interesuar.

Akademia është hapur me ligjëratën e profesorit të Universitetit Patras nga Greqia, dr Peter Groumpos, i cili u ligjëroi studentëve për çështjen e projektimit dhe ndërtimit të ndërtesave me energji zero dhe për dobitë që vijnë prej kësaj forme të ndërtimit, por që para trajtimit të kësaj teme, ai i njoftoi me konceptin e energjisë, përdorimin dhe shfrytëzimin e përgjithshëm të saj.

Në ANV-në e Inxhinierisë së Energjisë, ligjëruesi Kliton

Bylygbashi ka zgjuar interesimin e shumë studentëve të interesuar mbi temën: "Ndërtimi me energji zero, i furnizuar plotësisht nga dielli".

Në pjesën e parë të ligjëratës është diskutuar mbi formën dhe rëndësinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe termike vetëm përmes paneleve solare dhe për historikun e zhvillimit të direktivave të BE-së për energji. Ndërsa, në pjesën e dytë u fokusua në Analizën Statistike të Energjisë në Kosovë.

Studentët pjesëmarrës në ANV-në e Inxhinierisë së Energjisë kanë vazhduar me pjesën praktike, konkretisht me zgjidhjen e detyrave matematikore, me ligjëruesin Kliton Bylykbashi si vazhdimësi e ligjëratës që kishte të bënte me sqarimin teorik të kësaj teme.

Studentët ishin të përfshirë drejtpërdrejtë në zhvillimin e detyrave, gjë që rriti nivelin e interaktivitetit në sallë.

Profesori Kliton Bylykbashi, i cili përgjatë disa ditëve ka ligjëruar për pjesëmarrësit e ANV-së së Inxhinierisë së Energjisë, ku ka trajtuar temat, "Sistemet e gjelbërimit" dhe "Sistemet natyrore të ndriçimit e ventilimit", si forma të reja dhe që po gjejnë zbatim global.

Ligjëratat u fokusua tek mënyrat dhe karakteristikat e sistemeve natyrore të ndriçimit dhe ventilimit, e përcjellë edhe me ilustrime me foto, shembuj konkretë dhe zgjidhje të detyrave, proces gjatë të cilit pjesëmarrësit treguan shkallë të lartë interaktiviteti.

Për dallim prej herëve të kaluara, në ANV-në e Inxhinierisë së Energjisë, pjesëmarrësve iu mundësua mësimi dhe puna në grupe.

Profesori Kliton Bylygbashi, pas gjithë ligjëratave që ka mbajtur u krijoi hapësirë pjesëmarrësve, duke i ndarë për të punuar në grupe.

Ata morën informacione dhe u desh të punojnë për temën "Inxhinierë që punojnë në një objekt imagjinar".

Puna e tyre lidhej me konceptin e krijimit të një objekti imagjinar dhe u fokusuan në strategjitë e energjisë dhe ujit, më konkretisht, ata duhej të gjenin energjinë që nevojitet për të ngrohur dhe ftohur ujin në atë objekt përgjatë një viti.

Akademiti verore në UBT

Në kuadër të ANV-së së Shkencave të Ushqimit në UBT, zhvillohen vizita në kompani vendore

Akademia Ndërkombëtare Verore e Shkencave të Ushqimit, është shkollë e cila që në ditën e parë mbledhi një numër të madh pjesëmarrësish.

Hapjen e ANV-së e bëri rektori i UBT-së, prof.dr. Edmond Hajrizi, i cili para pjesëmarrësve tregoi se UBT i kushton shumë vëmendje rëndësisë së teknologjisë, ushqimit dhe mbi të gjitha njeriut, teksa tregoi se UBT është duke punuar shumë rreth këtyre aspekteve.

“Ne vazhdimisht jemi duke punuar në sigurimin e sa më shumë mjeteve të reja infrastrukturore për vitin e ardhshëm tek pjesa e procesimit e ruajtjes së ushqimit. Ne jemi duke krijuar laboratorë shtesë që studentët të punojnë sa më shumë dhe jemi duke krijuar kompetencë profesionale së bashku me partnerët tanë ndërkombëtarë në këtë fushë”, tha Hajrizi.

Në ligjëratën hyrëse, dietologia, Vala Pupovci trajtoi temën e “Kequshqyeshmëria e popullsisë, nevoja për ndryshim.”

Ajo shtjelloi problemet të cilat vijnë nga kequshqyerja, si dhe tregoi edhe për llojet e ushqimeve të cilat janë më të dobishme për organizmin e njeriut.

Akademia Ndërkombëtare Verore e Shkencave të Ushqimit ka vijuar punimet me ligjëratën e profesorit të Universitetit të Prishtinës, prof.dr Salih Salihu, i cili ka ligjëruar temën: “Përmirësimi gjenetik dhe përpunimi i drithërave”.

Gjatë kësaj ligjërate, profesor Salihu u ka treguar pjesëmarrësve lidhur me rëndësinë e përmirësimit gjenetik të drithërave, qëllimet e selektimit të tipareve që shtojnë kualitetin e drithërave dhe grurit, në kushtet klimatike të vendit, duke paraqitur rastin e krijimit të kultivarit të cilin vetë e ka përmirësuar gjenetikisht.

Tutje, ai foli edhe për përpunimin e drithërave, ku tha se në muajt në vazhdim ky proces do të pësojë ndryshime sidomos përpunimi i miellit dhe prodhimi i bukës.

Për herë të parë në Kosovë, në ANV-në e Shkencave të Ushqimit është ligjëruar tema: “Implikimet shëndetësore të akrilamideve në ushqime”, nga ligjëruesit në UBT, Gafurr Xhabiri dhe Hyrie Koraqi.

Ata kanë diskutuar për standardet apo nivelin e lejuar, për rrezikun dhe efektet shëndetësore të kësaj toksine. Po ashtu, ata theksuan rëndësinë e trajtimit të toksinës në teknologjinë e ushqimit, për të cilën thanë se studentët do ta praktikojnë gjatë punës praktike në UBT.

Akademia Ndërkombëtare Verore e Shkencave të Ushqimit krahas vizitave të shumta në kompani të ndryshme, njëherësh vijoi punimet me ligjëratat tematike nga ekspertë të fushës.

Me këtë rast, akademiku i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe ligjëruesi në universitetet e Greqisë dhe Italisë, Ilirjan Malollari, ka mbajtur ligjëratë me temë: “Inxhinieria në proceset ushqimore”.

Pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen më shumë me shkencën e inxhinierisë ushqimore, proceset në inxhinieri dhe teknologji të ushqimit dhe aspekte të rëndësishme të procesimit.

Akademik Malollari dhe profesori Sami Makolli bashkërisht treguan për mashtrimet që po ndodhin aktualisht me ushqime, të cilët theksuan rëndësinë etike të inxhinierëve e teknologëve të ushqimit.

Akademia Ndërkombëtare Verore e Shkencave të Ushqimit ka vijuar punimet me ligjëratën e titulluar: “Mikrobiologjia e Ushqimit”, ligjëruar nga profesori, Ibrahim Mehmeti.

Profesor Mehmeti me pjesëmarrësit e ANV-së ka diskutuar për rëndësinë dhe sfidat e jashtëzakonshme në industrinë e ushqimit, teksa rasti studimi ka marrë krahasimin e kësaj fushe në shtetin e Kosovës dhe Norvegjisë.

Në ANV-në e Shkencave të Ushqimit ka ligjëruar edhe dr.vet. Arsim Ademi, i cili ka trajtuar temën me titull: “Rëndësia e përdorimit të ushqimit të biofertilizuar të kafshëve i përdorur për konsum njerëzor”.

Ai bashkërisht me studentët ka analizuar mundësinë për

përmirësimin, pasurimin (biofertilizimin) e kualitetit të ushqimit në mënyrë natyrale, ende pa filluar përpunimi i tij në industri.

Akademia ka vazhduar punimet me vizitën në qumështoren “Bylmeti”, me ç’rast në shoqërim të ekspertëve përkatës pjesëmarrësit u njoftuan nga afër me sfidat, vizionin dhe kapacitetet prodhuese të fabrikës.

Në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore të Shkencave të Ushqimit u realizua vizitë në organizatën Iniciativa për Zhvillim Bujqësor e Kosovës “IADK”, me qendër në Vushtrri, organizatë e cila bashkëpunon ngushtë me fermerët me qëllim të zhvillimit të kapaciteteve prodhuese.

Gjatë kësaj vizite studentët u njoftuan nga afër me sfidat në sektorin e prodhimit dhe përpunimit të ushqimit jo industrial.

Aty janë pritur nga përfaqësuesit e organizatës, të cilët u treguan studentëve se që nga viti 2004, organizata është e angazhuar në mbështetjen e fermerëve përmes ofrimit të këshillave, krijimit e fermave model, pajisjeve për prodhim dhe përpunim, mbikëqyrjes të mbarëvajtjes së biznesit të krijuar etj.

Po ashtu, studentët patën rastin të shohin dhe të informohen nga ekspertët e fushës për pajisjet që përdoren në përpunimin e ushqimit.

Studentët patën mundësinë të vizitojnë edhe plantacionin shembull të Fatmire Limaj, e cila merret me përpunim të ushqim dhe çdo vit shet rreth 10 ton prodhim brenda dhe jashtë Kosovës.

Në ANV-në e Shkencave të Ushqimit, pjesëmarrësit realizuan vizitë në kompaninë “Devolli Group”, me ç’rast panë përpunimin e lëngjeve frutore dhe procesin teknologjik ku kompania përpunon lëngjet dhe qumështin. Në hapësirat e saj ligjëruan profesorët Namik Durmishi dhe Ismail Ferati, të cilët prezentuan para pjesëmarrësve hulumtimet për temën: “Prodhimi i lëngut të kthjellët me bazë mollën dhe aspektet mikrobiologjike”.

Pas prezantimit të profesorëve, menaxherja e cilësisë, njëherësh edhe teknologe kryesore e fabrikës, i ka njoftuar studentët me historikun e kompanisë, me kapacitet e tyre prodhuese dhe me aspektet teknologjike të përpunimit.

Pas prezantimeve të mbajtura nga ekspertë, studentët u njoftuan nga afër me laboratorët e fabrikës, hapat prej pranimit të lëndës së parë e deri tek paketimi i produktit final.

Teknologët e kompanisë i njoftuan studentët me pajisjet dhe me proceset në që përdoren në teknologjinë e qumështit, përkatësisht tek produktet e fermentuara të qumështit dhe me fokus të veçantë tek tri llojet e lëngjeve që prodhohen në fabrikë, freskuese, nektar dhe premium. Akademia Ndërkombëtare e Shkencave të Ushqimit mbylli punimet, ku përgjatë shtatë ditëve janë mbajtur një varg ligjëratash nga ekspertë që veprojnë brenda dhe jashtë vendit.

Punimet e akademisë janë mbyllur me ligjëratën e Dr.sc. Violeta Lajqi – Makolli, e cila ligjëroi temën: “Ndikimi i paketimeve në ushqime”.

Ajo ka folur fillimisht për shkencën e teknologjisë ushqimore dhe rolin e saj në jetën e njerëzve dhe gjithashtu për rolin e paketimit në ushqime dhe industri. Makolli ka shpjeguar se si ndikon edhe kontrolli dhe përzgjedhja e paketimeve në cilësinë dhe sigurinë e ushqimit.

Tutje, ajo ka prezantuar edhe metodat bashkëkohore për paketim dhe makineritë moderne që përdoren në këtë aspekt, derisa tha se janë disa kritere që duhet të plotësohen në paketime, në mënyrë që të mos ndikojë negativisht në ushqim.

Pak përfundimit të ligjëratave, pjesëmarrësit janë certifikuar si rezultat i vijimit të suksesshëm të kësaj akademie. Në ANV-në e Turizmit të Qëndrueshëm, vihet në pah nevoja për ekspertë të kësaj fushe

Në ANV-në e Turizmit të Qëndrueshëm, morën pjesë dh-

jetëra studentë të interesuar, ku hapjen e akademisë e bëri rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, i cili e vuri në pah rëndësinë e ndjekjes së një shkolle të tillë, për faktin që në vend mungon ekspertiza e nevojshme për menaxhim dhe zhvillim të duhur të turizmit.

“Kosova ka potencial për zhvillim, ka mundësi për punësim dhe zhvillim të turizmit, por nuk ka njerëz që janë ekspertë të kësaj fushe dhe që dinë të udhëheqin me këtë sektor, prandaj edhe është me rëndësi jetike marrja e njohurive dhe marrja në dorë e procesit”, vlerësoi Hajrizi.

Përfaqësuesi nga Ministria Tregtisë dhe Industrisë, Hysen Sogojeva ligjëroi temën me titull: “Trendët e turizmit në hotelieri dhe turizëm dhe trendët e zhvillimit të tyre në Kosovë”, me ç’rast tregoi për ndikimin institucional në ambientin e zhvillimit të turizmit në vend, fuqizimi i konceptit dokumentit për përmirësimin e legjislacionit në fushën e turizmit, si dhe lehtësirat që i ka bërë shteti për investitorët vendorë dhe të huaj në turizmin e Kosovës.

Ligjëruesi në UBT, prof. dr Nexhat Balaj ligjëratën që e trajtoi e fokusoi në temën: “Biodiversiteti, ekuilibri i lashtë i natyrës – Ekoturizmi në Kosovë”.

Ai ligjëroi nivelin e zhvillimit të ekoturizmit në Kosovë, destinacionet e ekoturizmit dhe zonat e mbrojtura në vend, që kanë rëndësi për zhvillimin e turizmit në Kosovë. Në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore të Turizmit të Qëndrueshëm, ka ligjëruar Gramen Taraku, menaxher i projektit “VIP Dinarica”, projekti i cili është financuar nga Bashkimi Evropian dhe ka të bëjë me zhvillimin dhe shtimin e aktiviteteve ekonomike ndërkufitare Kosovë – Shqipëri.

Ai ka thënë se projekti ka modele unike të turizmit të qëndrueshëm bazuar në vlera natyrore, tradicionale dhe kulturore, duke nxjerrë në pah karakteristikat e përbashkëta të rajonit.

Taraku tregoi më konkretisht, se projekti do të ndërtojë dy shtigje të reja ecjeje dhe biçikletash në distanca të gjata që do të lidhin Kosovën, Bjeshkët e Nemuna, komunën e Gjakovës, Deçanit, Junikut dhe Pejës, si dhe Shqipërinë, përfshirë bashkinë e Qarkut të Kukësit e Qarkut të Lezhës.

Ligjërues në ANV-në e Turizmit ishte edhe Skënder Thaqi drejtor ekzekutiv i “Austria – Albania Partnerschaft Mariane Graff”, ku ka ndarë përvojat e tij profesionale në këtë fushë.

Po ashtu, Besart Dreshaj, përfaqësues i kompanisë turistike “Air Prishtina”, në ligjëratën e tij ka prezantuar mënyrat se si turistët mund të bëjnë rezervime, përfshirë edhe ato online. Ai njëherësh ka prezantuar edhe udhëzimet turistike dhe strategjitë e agjencive për turizëm. Turizmi i Qëndrueshëm ka mbyllur aktivitetin në kuadër Akademisë Ndërkombëtare Verore, përgjatë së cilës u mbajtën ligjëratat dhe u organizuan disa vizita, me qëllim të njohjes së vende dhe pikave turistike në Kosovë, të cilat shërbejnë si atraksion edhe për vizitorët e huaj.

Ciklin e ligjëratave në kuadër të kësaj ANV-ja e përmbylli kryetari i Shoqatës së Turizmit Alternativ të Kosovës, Baki Hoti.

Ai trajtoi disa specifika dhe probleme me të cilat karakterizohet sektori i turizmit në Kosovë, duke i numëruar sfidat që vijnë si pasojë e mungesës së rregullores ligjore të institucioneve vendore, niveli i bashkëpunimit të shoqatave vendore e ndërkombëtare, mungesa e departamentit shtetëror për turizëm etj.

Një problem tjetër që u potencua nga Hoti është edhe mungesa e promovimit të turizmit vendor në nivel kombëtar përmes festivaleve e panairëve të ndryshme.

ANV-ja e Turizmit zgjati pesë ditëve tërëhoqi dhjetëra të rinj të interesuar për ta rregulluar gjendjen aktuale të turizmit në Kosovë.

Akademiti verore në UBT

Në ANV-në e Mekatronikës dhe Energjisë Efiçiente ligjërohet rreth makinave elektrike

Fakulteti i Mekatronikës në UBT, ka filluar punimet me aktivitete e ligjërata në kuadër të Akademisë Ndërkombëtare Verore, ku përgjatë gjashtë ditëve ligjëruan ekspertë të fushës përkatëse, si nga vendi ashtu edhe nga bota.

Hapjen e këtij aktiviteti e ka bërë ligjëruesi në UBT, Xhemajl Mehmeti, ku është fokusuar në temën: “Struktura Mekanike e Automjeteve”, i cili u ka shpjeguar pjesëmarrësve krahasimin e automjeteve klasike me ato elektrike.

Ai për pjesëmarrësit ka prezantuar koncepte themelore të ndërtimit të automjeteve, po ashtu për dinamikën e automjeteve dhe për sistemet e automjeteve elektrike.

Profesor Xhemajli ka folur edhe për ndikimin që aktualisht automjetet elektrike kanë në zvogëlimin e ndotjes së ambientit.

“Kontrolli i makinave elektrike” ishte tema e rradhës që u ligjërua e diskutua në ANV-në e Mekatronikës, temë e cila tërhoqi vëmendjen e shumë studenteve të këtij drejtimi.

Ligjërata u mbajt nga profesori në UBT, Bertan Karahoda, i cili shpjegoi për studentët rreth komponentëve elektronikë që punojnë dhe kontrollojnë sistemet me fuqi të lartë.

Ai gjithashtu tregoi edhe për analizën e elementeve të fuqisë elektronike, që kontrollojnë shpejtësinë e motorëve, minimizojnë humbjet dhe e rrisin efikasitetin e veturave elektrike.

Pjesëmarrësit nga universitete publike dhe private të vendit, në ANV-në e Mekatronikës morën informacione nga profesori i Universitetit të Pavis në Greqi, dr Peter Groumos, në lidhje me temën: “Automjetet Elektrike Autonome”.

Ligjërata e profesorit Groumos nisi me një bisedë interaktive me pjesëmarrësit, për të vazhduar me temën kyçe, e që u fokusua tek njohja më e thellë e veturave elektrike, përparësitë dhe të metat e tyre, gjithnjë duke e shoqëruar teorinë me shembuj konkretë.

“Kontrolli i makinave elektrike” ishte tema e radhës që u ligjërua e diskutua në ANV-në e Mekatronikës, temë e cila tërhoqi vëmendjen e shumë studenteve të këtij drejtimi.

Ligjërata u mbajt nga profesori në UBT, Bertan Kara-

hoda, i cili shpjegoi për studentët rreth komponentëve elektronikë që punojnë dhe kontrollojnë sistemet me fuqi të lartë.

Ai gjithashtu tregoi edhe për analizën e elementeve të fuqisë elektronike, që kontrollojnë shpejtësinë e motorëve, minimizojnë humbjet dhe e rrisin efikasitetin e veturave elektrike.

“Funksionimi dhe benefitet e motorëve elektronikë në krahasim me modelet e motorëve”, është tema që u trajtua në ANV-në e Mekatronikës, e që ngjalli interesim të madh në mesin e pjesëmarrësve, sidomos për faktin që një temë e tillë është jashtë kurrikulës studimore.

Ligjërata u mbajt nga profesori në UBT, Valmir Hoxha, i cili për studentët tregoi nevojat dhe kërkesat e industrisë që ka për llojet e motorëve.

Ai shpjegoi format e mbrojtjes së ambientit me përdorimin e këtyre motorëve, koston e ulët dhe efiçencën që buron prej tyre.

ANV-ja e Mekatronikës përmbylli aktivitetin me ligjëratën e profesorit në UBT, Bertan Karahoda.

Ai trajtoi temën “Elektronikë e energjisë”, me ç’rast bëri krahasim ndërmjet llojeve të ndryshme të kompjuterëve, si dhe mënyrën e shndërrimit të energjisë elektrike në energji mekanike.

Ligjërata zgjoi interesim të madh ndër studentë, të cilët shfaqën ide dhe koncepte të reja mbi këtë sferë.

Akademini e kësaj fushe gjatë tërë edicionit u pasuruan profesorë të shumtë vendorë e ndërkombëtarë, që trajtuan tema të trendëve të fundit botërorë.

Dhjetëra pjesëmarrës dëgjojnë ligjëratë mbi përfitimin inovativ të energjisë nga dielli dhe ndërtimin me energji zero

Ka zhvilluar punimet Akademia Ndërkombëtare Verore e Inxhinierisë së Energjisë, e cila përgjatë disa ditëve ka mbledhur dhjetëra pjesëmarrës të interesuar.

Akademia është hapur me ligjëratën e profesorit të Universitetit Patras nga Greqia, dr Peter Groumos, i cili u ligjëroi studentëve për çështjen e projektimit dhe ndërtimit të ndërtesave me energji zero dhe për dobitë që vijnë prej kësaj forme të ndërtimit, por që para trajtimit të kësaj teme, ai i njoftoi me konceptin e energjisë, përdorimin dhe shfrytëzimin e përgjithshëm të saj.

Në ANV-në e Inxhinierisë së Energjisë, ligjëruesi Kliton Bylygbashi ka zgjuar interesimin e shumë studentëve të interesuar mbi temën: “Ndërtimi me energji zero, i furnizuar plotësisht nga dielli”.

Në pjesën e parë të ligjëratës është diskutuar mbi formën dhe rëndësinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe termike vetëm përmes paneleve solare dhe për historikun e zhvillimit të direktivave të BE-së për energji. Ndërsa, në pjesën e dytë u fokusua në Analizën Statistikore të Energjisë në Kosovë.

Studentët pjesëmarrës në ANV-në e Inxhinierisë së Energjisë kanë vazhduar me pjesën praktike, konkretisht me zgjidhjen e detyrave matematikore, me ligjëruesin Kliton Bylykbashi si vazhdimësi e ligjëratës që kishte të bënte me sqarimin teorik të kësaj teme.

Studentët ishin të përfshirë drejtpërdrejtë në zhvillimin e detyrave, gjë që rriti nivelin e interaktivitetit në sallë.

Profesori Kliton Bylykbashi, i cili përgjatë disa ditëve ka ligjëruar për pjesëmarrësit e ANV-së së Inxhinierisë së Energjisë, ku ka trajtuar temat, “Sistemet e gjelbërimit” dhe “Sistemet natyrore të ndriçimit të ventilimit”, si forma të reja dhe që po gjejnë zbatim global.

Ligjërata u fokusua tek mënyrat dhe karakteristikat e sistemeve natyrore të ndriçimit dhe ventilimit, e përcjellë edhe me ilustrime me foto, shembuj konkretë dhe zgjidhje të detyrave, proces gjatë të cilit pjesëmarrësit treguan shkallë të lartë interaktiviteti.

Për dallim prej herëve të kaluara, në ANV-në e Inxhinierisë së Energjisë, pjesëmarrësve iu mundësua mësimi dhe puna në grupe.

Profesori Kliton Bylygbashi, pas gjithë ligjëratave që ka mbajtur u krijoi hapësirë pjesëmarrësve, duke i ndarë për të punuar në grupe.

Ata morën informacione dhe u desh të punojnë për temën “Inxhinierë që punojnë në një objekt imagjinar”.

Puna e tyre lidhej me konceptin e krijimit të një objekti imagjinar dhe u fokusuan në strategjitë e energjisë dhe ujit, më konkretisht, ata duhej të gjenin energjinë që nevojitet për të ngrohur dhe ftohur ujin në atë objekt përgjatë një viti.

Punën të cilën e bënë pjesëmarrësit shërbeu si një lloj testi për të arritur deri tek certifikimi i tyre.



Bashkëpunimi ndërkombëtar

Rektori Hajrizi përfaqëson Kosovën në forumin Asambleja Digjitale 2018

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi ka marrë pjesë në forumin "Asambleja Digjitale 2018", që u organizua nga Komision Evropian dhe Presidencën Bullgare e Këshillit të Bashkimit Evropian.

Forumi u mbajt më 25-26 qershor, në Sofje të Bullgarisë dhe morën pjesë më shumë se 1000 palë të interesit dhe politikëbërës të nivelit të lartë, të cilët diskutuan për politikën digjitale të BE-së dhe implikimet e zhvillimeve të fundit teknologjike.

Komisioni Evropian, së bashku me përfaqësues nga gjashtë partnerë të

Ballkanit Perëndimor, ku përfshihen Kosova, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia, janë bërë bashkë që të mbështesin tranzicionin e rajonit në një ekonomi digjitale.

Bashkëpunimi mes të gjitha këtyre palëve ka ndikuar në lancimin e programit Agjenda Digjitale për Ballkanin Perëndimor.

Kjo iniciativë pritet t'i sjellë qytetarëve të Evropës përfitimet të shumta, siç është rritja më e shpejtë ekonomike, më shumë vende pune dhe shërbime më të mira.

Agjenda digjitale do të mbështesë vendosjen e mjeteve të e-qeverisjes, e-prokurimit dhe e-shëndetësisë, si dhe do të ndihmojë në rritjen e shkathëtsive digjitale midis qytetarëve.

Kjo do të bëhet duke e mbështetur përfshirjen dhe përfaqësimin e Ballkanit Perëndimor në nismat dhe ngjarjet e BE.

Agjenda digjitale për Ballkanin Perëndimor është një përpjekje e përbashkët e gjashtë partnerëve të Ballkanit Perëndimor dhe Komisionit Evropian, që u prezantua më 6 shkurt 2018.



Rektori Hajrizi realizon vizitë pune në Universitetin e Kembrixhit



Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi ka realizuar vizitë pune në Universitetin e Kembrixhit, me ç'rast u takua me udhëheqësit e këtij institucioni.

Gjatë këtij takimi është diskutuar për hartimin e projekteve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe në zhvillim të qëndrueshëm në politika publike dhe inovacion.

Në kuadër të agjendës për vendosjen e partneritetit ndërkombëtar akademik, rektori Hajrizi po takohet me përfaqësues të universiteteve dhe institucioneve evropiane, me të cilët po zhvillon takime të shumta me qëllim të konsolidimit të bisedimeve në fushat e përbashkëta prioritare.

Rektori Hajrizi vizitoi Qendrën e Ndërmarrësisë së Universitetit Teknik të Mynihut

Gjatë vizitës së realizuar në Gjermani, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi ka vizituar Universitetin Teknik të Mynihut, përkatësisht Qendrën e Ndërmarrësisë së këtij universiteti, me ç'rast është pritur nga udhëheqësit e qendrës. Gjatë takimit është biseduar mbi mundësinë e bashkëpunimit institucional ndërmjet kësaj qendre dhe Inkubatorit të UBT-së, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të të dy palëve, si dhe është diskutuar edhe mundësia e qëndrimit të studentëve të UBT-së në këtë qendër, që konsiderohet si njëra ndër qendrat më të suksesshme të ndërmarrësisë në botë.

Universiteti Teknik i Mynihut është një nga universitetet më të mira të Evropës. Si i tillë është i angazhuar për përsosmëri në kërkime dhe mësimdhënie, edukim ndërdisiplinor dhe promovim aktiv të shkencëtarëve të rinj premtues. Universiteti gjithashtu krijon lidhje të forta me kompani dhe institucione shkencore anëmbanë botës.

Ky institucion është një nga universitetet e para në Gjermani dhe më parë quhej Universiteti i Ekselencës, teksa renditet rregullisht në mesin e universiteteve më të mira evropiane në renditjen ndërkombëtare.

Rektori i UBT-së e përfaqëson Kosovën në kongresin më të madh për cilësi në Evropë

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi ka marrë pjesë në edicionin e 62-të të kongresit më të madh të cilësisë në Evropë, që u mbajt në Paris të Francës, më 21-22 qershor.

Nën moton "Feel the new Quality way", mbi 300 përfaqësues nga të gjitha vendet e botës, drejtues biznesi dhe profesionistë të kualifikuar nga Evropa dhe bota, paraqitën pikëpamjet e tyre mbi zhvillimet dhe menaxhimin e cilësisë në botë.

Në këtë kongres Kosova u përfaqësua nga organizata Quality Kosova, president i të cilës është rektori Hajrizi, i cili atje paraqiti sfidat dhe zhvillimet e fundit në fushën e menaxhimit të cilësisë në vendin

tonë, teksa analizoi edhe zhvillimet e fundit që janë bërë në botë në këtë fushë.

Gjatë dy ditëve, përfaqësuesit e vendeve të Evropës dhe më gjerë kanë ndarë e zbuluar praktikën më të mira që mund të zbatohen në të ardhmen për menaxhimin e cilësisë.

Dy temat që janë favorizuar në këtë edicion janë: "Cilësia, aseti konkurrues për Evropë" dhe "Lideri i cilësisë, një rol kyç".

Kosova u bë anëtare me të drejta të plota në Organizatën Evropiane të Cilësisë (The European Organization for Quality) në vitin 2009.



Rektori Hajrizi takohet me përfaqësues institucionale të vendeve të Evropës

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi ka realizuar një varg vizitash në Evropë, konkretisht në Gjermani, Austri, Francë dhe Britani të Madhe, të cilat kanë dhënë rezultate të frytshme në sferën e zgjerimit dhe shtimit të bashkëpunimit mes UBT-së dhe institucioneve shtetërore të këtyre vendeve.

Këto takime përfaqësuesit institucionalë të këtyre shteteve, ka rezultuar me pajtim të palëve për nisjen e projekteve të përbashkëta për zhvillimin e ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë në Kosovë, realizimin e studimeve të përbashkëta me universitete prestigjioze, punësim, rezilencë, zhvillimi

të qëndrueshëm dhe inovacion.

Gjatë vizitës në Britani të Madhe, rektori Hajrizi është takuar edhe me ambasadorin e Kosovës atje, Lirim Graiçevci, me të cilin kanë bashkëbiseduar për mundësinë e ndërkombëtarizimit të sektorit të arsimit në Kosovë.

Përmes realizimit të vizitave e bashkëpunimeve të tilla, UBT po shënon arritje ndërkombëtare, duke kontribuar në projekte inovative në botë, që kanë të bëjnë me edukimin, zhvillimin e qëndrueshëm dhe inovacionin në shumë fusha të jetës.

Bashkëpunime

Rektori Hajrizi priti në takim presidentin e Mercy College of Health Sciences nga Iowa



Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi, ka pritur në takim presidentin e Mercy College of Health Sciences nga Iowa, në SHBA, Douglar Fiore, pasi ky i fundit ka realizuar një vizitë në Kosovë për të gjetur partnerë potencialë për investim dhe si një të tillë e ka parë UBT-në. Gjatë këtij takimi është biseduar mbi mundësitë e bashkëpunimit institucional në fushën e shëndetësisë, si dhe kanë diskutuar mbi mundësinë e realizimit të investimeve dhe projekteve të përbashkëta në dobi të të dy institucioneve, duke

qenë se përveç veprimit konform standardeve evropiane, programet mjekësore në UBT kanë për bazë edhe standardet amerikane, gjë që krijon lehtësira për studentët tanë, të cilët pas studimeve të kenë mundësi të kryejnë praktikë edhe në Amerikë.

Presidenti Douglar Fiore ka vizituar edhe Kampusin Inovativ, përkatësisht Poliklinikën e UBT-së, e pajisur me laboratorë dhe infrastrukturë moderne, teksa shfaqti gatishmërinë për pjesëmarrje edhe në konferencën ndërkombëtare të UBT-së, që do të organizohet

në tetor të këtij viti.

Mercy College of Health Sciences është universiteti që ka traditë akademike 115 vjeçare dhe që momentalisht studentët e këtij institucioni janë ndër më të mirët në fusha të ndryshme të shëndetësisë, ku përfshihen infermierë, asistentë të terapisë fizike, teknologë, radiologë, teknologë kirurgjikalë, asistentë mjekësorë, sonografë mjekësorë, paramedikë dhe udhëheqës në administratën shëndetësore.

Bashkëpunimi me institucionet shtetërore

UBT lidh memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi dhe sekretarja e përgjithshme e Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, Rozafa Ukimeraj Çuni, në emër të të dy institucioneve, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi me qëllim të lidhjes së bashkëpunimit, nga i cili më së shumti do të përfitojnë studentët e UBT-së.

Ky memorandum parasheh pranimin e një numri të caktuar të studentëve si praktikantë gjatë gjithë vitit akademik. Numri i studentëve që do të pranohen si praktikantë dhe detyrat që do të duhet t'i realizojnë gjatë praktikës, do të përcaktohen nga Ministria, teksa nga memorandum i në fjalë do të mundësohet edhe bashkëpunimi për realizimin e aktiviteteve në fushën e zhvillimit të qëndrueshëm lokal. UBT ka marrëveshje mirëkuptimi dhe bashkëpunimi me shumë institucione publike, përfshirë edhe ministri, me të cilat janë realizuar një varg aktiviteteve dhe bashkëpunimesh nga të cilat kanë përfituar studentët e UBT-së, si dhe qytetarët e Kosovës.



Konferenca në Korçë

Rektori Hajrizi panelist në konferencën shkencore të organizuar për nder të 110 vjetorit të Kongresit të Manastirit

Për nder të 110 vjetorit të Kongresit të Manastirit, i njohur si Kongresi i Alfabetit, në Korçë është organizuar konferenca shkencore nga Universiteti i Korçës "Fan S. Noli" në bashkëorganizim me UBT-në, UP-në, Qendrën për Studime Ballkanike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Lidhjen e Diasporës Shqiptare për Maqedoninë.

Panelist i kësaj konference ka qenë edhe rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi. Me këtë rast, ai e ka vlerësuar fuqinë e kongresit dhe tha se është një arritur e madhe në atë kohë.

Tutje, rektori Hajrizi theksoi se Alfabeti i Gjuhës Shqipe u bë jetik për shqiptarët, siç tha ai, sepse mundësoi botimin e gazetave, librave e publikimeve të tjera, me një përparësi të madhe, që mund të lexoheshin e të kuptoheshin nga të gjithë shqiptarët, kudo ku ishin ata.

Rektori Hajrizi tha se vendimi final i Kongresit të Manastirit


i dha shtysë të madhe Shkollës Shqipe, që tashmë kishte bërë hapat fillestarë, me vështirësi e rreze të mëdha.

"Në rrethanat e sotme, për fat të mirë, krejt të reja, krejt ndryshe dhe shumë pozitive për shqiptarët, por sidomos për shqiptarët e Kosovës, institucionet arsimore, me theks të veçantë në Kosovë, kanë njohur një zhvillim shumë të hovshëm, duke qenë profesionale dhe në nivel me institucionet më prestigjioze akademike në rajon e më gjerë. Një prej këtyre institucioneve është edhe UBT", potencoi rektori Hajrizi.

Konferenca ka zhvilluar punimet në tri sesione të ndara, me ç'rast u paraqiten dhjetëra punime nga studiues të gjuhës, kulturës dhe historisë shqiptare.

Në historinë e Shqipërisë, Kongresi i Manastirit shënon një ngjarje të rëndësishme politike, kulturore, shkencore dhe arsimore për kombin shqiptar, pasi është kongresi i alfabetit

kombëtar të shqipes, që u përpilua dhe u miratua prej tij, alfabeti që përdoret edhe sot.



Rektori Hajrizi mori pjesë në takimin e thirrur nga ambasadorja Apostolova

Me ftesën e sheshe të Zyrës së BE-së në Kosovë, Natalie Apostolova, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi mori pjesë në takimin që kjo e fundit pati me rektorët e universiteteve të Kosovës, prej të cilëve, UBT ishte i vetmi institucion privat i arsimit të lartë që mori pjesë.

Temë bosht e takimit ishte "Politika më të qarta në avancimin e sistemit të arsimit në Kosovë", teksa u diskutua mbi punën dhe të arriturat e institucioneve, për të ardhmen e arsimit në Kosovë, si dhe për prurjet dhe sfidat me të cilat po përballlet ky sektor në vendin tonë.

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi prezantoi të arriturat e UBT-së dhe sukseset e studentëve në arenën ndërkombëtare, teksa e siguroi ambasadorën Apostolova që UBT do të vazhdojë të kontribuojë edhe më tutje në përmirësimin e nivelit të arsimit në Kosovë.

"UBT është ambasadori dhe përfaqësuesi më i mirë i Kosovës në botë. Studentët tanë po marrin pjesë e po triumfojnë nëpër gara ndërkombëtare, përmes UBT-së po e afrojmë Kosovën me teknologjitë e inovacionet e fundit botërore, përmes nesh Kosova po bëhet pjesë e po përfaqësohet nëpër organizatat dhe forumet më të mëdha botërore që lidhen me sektorin e arsimit dhe me sektorë tjerë, si dhe përmes institucionit tonë tashmë janë të punësuar 98% e studentëve tanë", theksoi ai. Në anën tjetër, Apostolova premtoi që BE do të vazhdojë mbështetjen e BE-së për arsimin kosovar dhe bëri thirrje që në këtë proces të ndihmojnë edhe vetë institucionet e arsimit.

"Është e rëndësishme që të dëgjoj mendimet dhe idetë e përfaqësuesve të institucioneve, sepse edukimi është prioritet i BE-së dhe do të vazhdojë të mbetet i tillë", u shpreh ajo.

UBT ka ndihmuar në ndërkombëtarizimin e Kosovës falë pjesëmarrjes nëpër konferenca dhe organizime të tjera në botë, si dhe falë partneritetit dhe bashkëpunimit të ngushtë me rreth 300 institucione dhe organizata ndërkombëtare.

Rrefime Suksesi

Studentja nga India përfiton nga Erasmus + për të marrë përvojë në UBT

Shkalla e lartë e ndërkombëtarizimit po krijon mundësi për studentë të shumtë nga e mbarë bota që të vijnë në UBT, tërë kjo falë programeve të ndryshme të shkëmbimit, pjesë e të cilëve është institucioni.

Zahara Chhapra është studente e nivelit master nga India, e cila studimet e këtij niveli po i përfundon në Bauhaus, në Dessau të Gjermanisë, por që falë programit Erasmus+, ka zgjedhur UBT-në që të vij për të ndarë përvojën e saj me studentë, zgjedhje për të cilën Zahara thotë se nuk do të pendohet asnjëherë. “UBT, Studioja e Urbanizimit dhe puna që studentët po bëjnë, po më bën të ndihem shumë nostalgjike për ditët e kaluara gjatë studimeve bachelor në Kolegjin Rizvi të Arkitekturës, në Mumbai të Indisë.

“Studentët e UBT-së janë shumë entuziastë dhe shpeshherë paraqesin punën e tyre në anglisht, vetëm që unë të mund të kuptoj gjithashtu. Analiza që studentët po e bëjnë rreth Lipjanit dhe Deçanit, më jep njohuri të mëdha në lidhje me gjendjen e ndërtimit, rregullimin ligjor dhe kufizimet e planifikuesve në Kosovë, duke propozuar një vizion për një lagje apo një qytet. Të gjitha këto kanë bërë që përvoja e fituar këtu të jetë e mrekullueshme dhe e paharrueshme”, u shpreh ajo.

Ajo tregoi se për UBT-në ka dëgjuar nga kolegët e saj, studentë të UBT-së,

me të cilët u takua vitin e kaluar përgjatë vijimit të një semestri në Hochschule Anhalt, ku pjesë e të njëjtit program ishin edhe këta studentë të UBT-së.

“Jam e lumtur që jam këtu, por ditët e mia në UBT më kanë dhënë shumë njohuri për vështirësitë që ka një profesor, ndjenjën të cilën nuk e kam përjetuar më parë. Është padyshim e vështirë të jesh në anën tjetër të tryezës, duke ndarë me studentë bazën e të dhënave dhe njohurive që vijnë përmes praktikës, leximit dhe përvojës praktike”, theksoi Zahara.

Mbi të gjitha, ajo ka mbetur e mrekulluar nga Kosova, qytetarët e saj dhe energjia e tyre.

“Këtu vazhdimisht është duke ndodhur diçka. Një ekspozitë në Galerinë Kombëtare, një koncert në librari, një dokumentar që shfaqet në kinema. Po e vërej që arti këtu është një forcë lëvizëse e rinisë, që përbën shumicën e popullsisë”, potencoi ajo, duke shprehur që më shumë njerëz ta vizitojnë Kosovën dhe të marrin me vete kujtime të bukura që t’i ndajnë me njerëzit e vendeve prej nga vijnë.

UBT ka mbi 300 marrëveshje bashkëpunimi me universitete dhe institucione tjera ndërkombëtare, si dhe është pjesë e programeve të shumta për shkëmbim studentësh, prej ku deri tash kanë përfituar qindra studentë të UBT-së

50 për qind e stafit të kompanisë “Rrota” janë studentë të UBT-së

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri, në UBT, me programet studimore më të harmonizuara në rajon dhe me ndërlydhjen e pjesës teorike me atë praktike, vazhdon ta ruajë primatin e liderit në rajon, duke i përgatitur studentët për tregun e punës.

“Rrota” është një nga agjencitë kryesore të komunikimit digjital në Kosovë, me staf të përbërë prej 50 për qind të studentëve të Fakultetit Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT.

Në këtë kompani, studentët e UBT-së janë punësuar për të ofruar zgjidhje dhe për të shprehur kreativitetin në zhvillim të softuerëve, dizajnim të ueb-it, dizajn grafik, zhvillim të lojërave etj.

Drejtoi i financave në kompaninë “Rrota”, Ardian Velu, ka treguar se UBT ofron studime të një niveli të lartë akademik, dhe sipas tij, duke qenë kështu institucioni nxjerr kuadro profesionale në industri.

“Studentët që kanë ardhur prej UBT e kanë një bazë shumë të mirë, por edhe janë zhvilluar në kompani e janë përshtatur me metodologjinë ose veglat e punës. Aktualisht 50 për qind e zhvilluesve në Rrotë janë studentë që kanë përfunduar studimet

ose vazhdojnë të jenë studentë në UBT”, ka thënë Velu.

Burim Dervisholli është student i vitit të tretë në Fakultetin Shkencave Kompjuterike në UBT, i cili që disa vite është punësuar si programer në këtë kompani, falë njohurive të fituara gjatë studimeve.

“UBT më ka jep baza të mira në gjuhët programuese, ku në vitin e tretë për specializim kam zgjedhur Multimedia – Dizajn. Gjatë specializimit kam marrë njohuri të shumta rreth phottoshop-it, dizajnit, njohuri të cilat më kanë shërbyer të vazhdojë punën në këtë kompani”

Edhe Sherif Maliqi është student i vitit të tretë në Fakultetin Shkencave Kompjuterike, në UBT. Ai është punësuar në kompaninë “Rrota”, që gati një vit, ku sipas tij, gjatë kësaj periudhe ka qenë pjesë e projekteve të mëdha.

“Studimet që i kam ndjek në UBT që tri vite, më kanë ndihmuar shumë si nga ana teorike edhe nga praktike për të vazhduar si praktikant në kompani dhe më pas të punësohem. Pra, studimet më kanë ndihmuar që të jem në hap me zhvillimin teknologjik”, tha studenti Maliqi.



“Studentët që kanë ardhur prej UBT e kanë një bazë shumë të mirë, por edhe janë zhvilluar në kompani e janë përshtatur me metodologjinë ose veglat e punës”, ka thënë drejtoi i financave në kompaninë “Rrota”, Ardian Velu

Anesa Mustafa

Anesa Mustafa, shembulli i studentes që përfitoi nga partneriteti ndërkombëtar i UBT-së



Anesa arriti që këtë dëshirë ta shndërronë në realitet, dhe atë, me sukses të jashtëzakonshëm.

Kalimi nga UBT në Anhalt University of Applied Sciences ishte një rrugëtim që i ndryshoi jetën përgjithmonë ish-studentes së UBT-së, Anesa Mustafa.

Sikurse edhe shumë të rinj që ëndërr jetësore e kanë shkollimin jashtë vendit, Anesa arriti që këtë dëshirë ta shndërronë në realitet, dhe atë, me sukses të jashtëzakonshëm.

Ajo është studente e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, ku i përfundoi studimet e nivelit bachelor dhe i mori bazat e profesionit të arkitekturës. Megjithatë, dëshira për të përjetuar një përvojë të re dhe që do e kompletonte ndërtimin e karrierës së saj, bëri që ajo të aplikonte në universitetin e njohur gjerman, Anhalt University of Applied Sciences, prej ku do të marrë idetë dhe njohuritë mbi stilin e punës së arkitekturës nëpër vendet e përparuara të Evropës, përvojë të cilën do e nisë nga tetori i këtij viti.

Por, synimi i saj nuk është vazhdimi i një karriere në Gjermani, por kthimi dhe dhënia e kontributit për Kosovën.

“Unë personalisht vazhdimin e studimeve në Gjermani e shoh si një mundësi jashtëzakonisht të mirë për mua, për kolegët e mi, por edhe për vendin tonë në përgjithësi, sepse patjetër që synim kryesor i imi është përgatitja sa më e mirë e mundshme në aspektin profesional, në mënyrë që të gjithë këtë përgatitje profesionale ta shndërronim në resurs për vendin dhe shoqërinë tonë”, u shpreh Anesa.

Përpos studimeve të nivelit bachelor, në UBT ajo nisi studimet edhe për nivelin master, kur edhe falë bashkëpunimit të ngushtë mes UBT-së dhe Anhalt University of Applied Sciences, asaj i është mundësuar transferimi atje.

“Falë bashkëpunimit të madh që UBT ka me Universitetin Anhalt, dhe jo vetëm, ka arritur të krijojë mundësi shumë të mira dhe t’i hapë dyert e suksesit për të gjithë studentët e vet. Kjo madje është edhe një dëshmi dhe ndihmesë shumë e madhe për të gjithë studentët e rinj që të zgjedhin UBT-ne si institucionin ideal për studimet e tyre të mëtutjeshme”, vlerësoi Anesa.

Ndikim të madh në suksesin e Anesës kanë pasur edhe profesorët e saj, të cilët kanë shfaqur gatishmëri dhe i kanë dhënë asaj përkrahje në çdo moment.

“Kemi qenë të mirëpritur dhe të respektuar në Anhalt University, falë partneritetit të mirë që ka UBT me këtë universitet. Sikurse gjatë periudhës së studimeve, edhe kësaj here, profesorët tanë kanë vërtetuar edhe njëherë gatishmërinë e tyre, duke u bërë mbështetësit tanë më të mëdhenj edhe gjatë këtij procesi”, tha ajo.

Momentalisht, studimet e tyre në Gjermani, më saktësisht në Anhalt University of Applied Sciences, po i vijnë dhjetëra studentë e ish-studentë të UBT-së, dhe kjo falë jetësimit të bashkëpunimit me institucioneve, prej të cilit përfituesit më të mëdhenj janë studentët.

Blend Dema i UBT-së do të vijojë studimet në Gjermani

Studenti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Blend Dema është vetëm njëri ndër dhjetëra studentë të UBT-së, që do të vazhdojë studimet në Anhalt University of Applied Sciences, në Gjermani.

Ai është student i nivelit master, ndërkaq semestrin e tretë do ta vazhdojë në universitetin gjerman, falë bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet UBT-së dhe universitetit në fjalë.

“Procedurat për aplikim ishin mjaft të thjeshta, duke e ditur që UBT ka partneritet të ngushtë me universitetet evropiane, andaj dita-ditës me UBT-në, ne studentët po e ndjejmë veten si studentë evropianë”, tregoi Blendi.

Ai u shpreh se studimet në UBT e

kanë zhvilluar e rritur profesionalisht dhe ndjen se këtë përvojë duhet ta ndajë me të gjithë të rinjtë që janë në prag të marrjes së vendimit për studim.

“Studimet kanë qenë një shtytje e fuqishme, ku me punën që e kemi bërë gjatë këtyre viteve, UBT na e ka shpërblyer në mënyrën më të mirë. Mbështetja nga profesorët ka qenë shumë e madhe, duke qenë të hapur dhe të gatshëm për të na ndihmuar në çdo kohë”, vlerësoi ai.

Pranimi në një universitet evropian nuk është suksesi i vetëm i Blendit, pasi ai menjëherë pas përfundimit të studimeve themelore u punësua në njërin ndër kompanitë më të suksesshme në vend, “Maden Group”.

“Falë studimeve në UBT, fillimit të punës në këtë kompani dhe mundësive që m’i kanë dhënë, jam qasur në projekte të ndryshme e problematika tjera dhe jam formësuar jashtëzakonisht shumë në aspektin profesional”, tha Blendi.

Dhjetëra studentë të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, tashmë janë bërë pjesë e Anhalt University of Applied Sciences, për vijim të studimeve për një semestër ose për dy vite të plota studimi, teksa në përgjithësi, pjesë e universiteteve nga e mbarë bota janë bërë qindra studentë të UBT-së.



Dikur student i Arkitekturës, tash asistent në UBT



Albert Mustafa ishte student i nivelit bachelor dhe master në Fakultetin Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor. Falë suksesit të treguar gjatë studimeve, ai është angazhuar si asistent në lëndën “Konstruksione Arkitektonike I”, në fakultetin në të cilin mori dije përgjatë pesë viteve.

Paraprakisht, ai kishte vepruar si arkitekt i pavarur, më pas bashkëpunoi me disa kompani, si dhe nga nëntori i vitit 2016 u angazhua si profesor dhe mban kursin e Auto Cad-it.

“Studimet në UBT i bënë të veçanta qasja e institucionit dhe

mësimdhënësve, në aspektin e të qenit në hap me kohën edhe në mënyrën e ligjërimit, si dhe në ofrimin e kushteve materiale, edhe në inovacionet për të cilat është e njohur UBT. Mbi të gjitha, UBT njihet ndërkombëtarisht”, theksoi ish-studenti Mustafa.

Mustafa në punimin e diplomës të nivelit master kishte trajtuar temën “Dimensioni i përjetimit dhe perceptimit në arkitekturë”, punim të cilin më vonë e botoi në libër në shtëpinë botuese “Ditura”, në Tiranë. Ky punim është vlerësuar si i pari i këtij lloji në Kosovë dhe rajon, pasi që kjo

tematikë nuk është trajtuar më parë nga studiuesit shqiptar.

Ish-studenti Mustafa ishte certifikuar edhe si student i vitit, pas përfundimit të studimeve bachelor në UBT.

Programi Arkitekturë dhe Planifikim Urban, në nivelin master, synon të ofroj njohuri dhe t’i përgatis ekspertët e arkitekturës që të identifikojnë dhe analizojnë problemet arkitektonike, në lidhje me dizajnin dhe zhvillimin e arkitekturës në kuptim të estetikës dhe efijencës.

Ish-studenti i UBT-së vazhdon studimet master në Itali

Ish-studenti i UBT-së, Besëtar Dibra shkollimin e mëtutjeshëm dhe ngritjen e tij profesionale do ta vazhdojë në njërin ndër universitetet më të mira në botë, Universitetin Politeknik të Milanos, në Itali, në drejtimin Inxhiniri Ndërtimore.

Për pranim në këtë universitet është dashur të ndiqeshin një varg procedurash, të cilat Dibra i ka kaluar

me shumë sukses falë përgatitjes së tij profesionale, si dhe ndihmës së ofruar nga dekan i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT, prof. dr. Muhamet Ahmeti dhe prodekanit të këtij fakulteti, prof. dr. Visar Krelani. Besëtar Dibra është vetëm njëri ndër studentët dhe ish-studentët e UBT-së, që ka përfutur nga qindra mar-

rëveshjet e UBT-së me universitete prestigjioze ndërkombëtare dhe nga njohja e diplomës së UBT-së kudo në botë.



Dikur student i UBT-së, tash bashkëthemelues i dy kompanive



Fakulteti Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi i UBT-së, është fakulteti që udhëheq në vend e rajon tash e 17 vite me programet specifike që i ofron nga fusha e menaxhmentit, biznesit dhe ekonomisë.

Në këtë fakultet shumë studentë bënë zgjedhjen ideale për të vazhduar studimet universitare, ku veç tjerash, arritën që të integrohen lehtësisht në tregun e punës.

Një nga ta është edhe student i MBE-së, Edon Fishekqiu, i cili pas mbarimit të studimeve, bashkërisht me partnerë të tjerë, ka themeluar kompaninë

“Autopjesë-ks.com” dhe “Autovegla.com”, që shërbejnë si ndërmjetësues elektronikë ndërmjet konsumatorit dhe autopjesëve.

Ish-studenti Fishekqiu ka treguar se këto kompani që operojnë në mënyrë elektronike kursejnë kohën dhe mundësojnë gjetjen e pjesëve të veturave. Sipas tij, aktualisht këto uebsajta janë më të kërkuarat në tregun e Ballkanit, konkretisht në fushën e autopjesëve dhe ndërmjetësimit.

Tutje, ai ka theksuar se falë UBT-së ka arritur të ngritet profesionalisht, sidomos në aspektin e biznesbërjes, si dhe

njohuritë e fituara në këtë institucion i kanë ndihmuar shumë në bizneset e tij. “UBT dallon shumë nga institucionet tjera arsimore në Kosovë, sidomos për nga stafi akademik sepse kanë përgatitje profesionale, por dallon edhe për nga kurrikula ose planifikimi akademik”, vlerësoi Fishekqiu.

Fakulteti Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi në UBT, ishte dhe vazhdon të jetë lider akademik dhe profesional, duke iu përgjigjur nevojave themelore dhe atyre strategjike të sektorëve publikë e privatë në Kosovë dhe region.

Rrefime Suksesi

Dikur studente e SHKI-së, tash e punësuar në UBT

Fakulteti Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, është fakulteti që udhëheq në vend e rajon tash e 17 vite me specializimet që i ofron nga fusha e sistemeve softuerike, ueb programimi, databaza, rrjeta dhe telekomunikacion, etj.

Në këtë fakultet shumë studentë bënë zgjedhjen ideale për të vazhduar studimet universitare, ku veç tjerash, arritën që të integrohen lehtësisht në tregun e punës e disa u punësuan në institucionin në të cilën përfunduan nivelin bachelor ose master të studimeve.

Një nga ta është edhe studentja e SHKI-së, Diellza Berisha, e cila tash e disa vite është e punësuar në UBT.

Në fillim u angazhua si tutore, pastaj asistente në disa lëndë, teksa sot ajo mban pozitën e koordinatorës së Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri.

Duke folur për studimet në UBT, ish-studentja Berisha tha se institucioni u ofron studentëve mundësi të shumta dhe mbi gjitha i përgatit për tregun vendor e ndër-

kombëtar të punës.

“Zgjedhja për të studiuar në UBT në nivelin bachelor dhe master është zgjedhja më e mirë. Duke pasur parasysh që synimet e mia i realizova falë UBT-së, i rekomandojë që të rinjtë e Kosovës dhe jo vetëm, të vazhdojnë studimet në UBT, pasi që institucioni të ngrit profesionalisht në karrierë”, theksoi ajo.

Ditë më parë, ajo ka diplomuar në nivelin master dhe shprehet të jetë e kënaqur që tashmë ka një diplomë të UBT-së, diplomë e cila njihet ndërkombëtarisht.

“UBT ishte pjesë e ëndrrës dhe dëshirës sime të kamotshme për dituri dhe avancim profesional. Institucioni falë stafit akademik e profesional dhe bashkërisht edhe me rektorin prof.dr Edmond Hajrizi, u ofron studentëve cilësi në studime, teksa përveç punës praktike atyre u ofrohet edhe mundësia e punësimit ende pa i përfunduar studimet”, tha ajo.



Flaka Sylja e UBT-së, pjesë e Anhalt University of Applied Sciences



Studentja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Flaka Sylja tash e tutje do të vazhdojë ngritjen e saj akademike në universitetin e njohur gjerman, Anhalt University of Applied Sciences, ku tashmë kanë nisur studimet edhe dhjetëra studentë të tjerë të UBT-së.

Flaka tha se ka marrë vendim për të studiuar në UBT sepse ka besuar në ndërkombëtarizimin institucional dhe se kjo do i ndihmonte asaj që, përpos njohurive të fituara gjatë studimeve në Kosovë, të përjetonte edhe ndjenjën e të studiuarit në një vend evropian.

“Një nga përparësitë kryesore që kisha parasysh gjatë përzgjedhjes së institucionit ku doja të ndiqja studimet fillestare për arkitekturë ishte edhe mundësia për shkëmbim njohurish

me universitete ndërkombëtare. UBT e mundëson këtë, andaj u lehtësuan tërësisht procedurat si në aplikim, ashtu edhe në përzgjedhje të lëndëve për shkak të planprogramit të ngjashëm që e kanë të dy institucionet”, tregoi ajo. Ajo vlerëson se Kosova ka nevojë për arkitektë profesionistë, andaj synon që të kthehet në vendlindje për të vënë në funksion praktik të gjitha dijet e fituara në UBT dhe në Anhalt University. Pranimi në këtë universitet gjerman nuk është suksesi i vetëm i Flakës. Gjatë dy viteve të para të studimeve në UBT, ajo ka marrë pjesë nëpër punëtori të ndryshme për arkitekturë, si dhe disa nga punimet e saj kanë qenë pjesë e ekspozitave studentore të fakultetit.

Ish-studenti Alban Saliaga përfiton nga partneriteti ndërkombëtar i UBT-së

Ish-studenti i Fakultetit Inxhinieri Ndërtimore dhe Infrastrukturë, Alban Saliaga e ka shfrytëzuar mundësinë e vazhimit të studimeve jashtë vendit, konkretisht në Itali, falë rrjetit të gjerë të bashkëpunimeve ndërkombëtare që e posedon UBT. Që nga 10 shtatori, Albani edhe zyrtarisht do të fillojë ciklin e ligjëratave në Universitetin Politeknik të Milanos, sukses ky i arritur falë aftësive të tij dhe bashkëpunimit e ndihmës së ofruar nga profesorët e tij në UBT.

“Tek profesorët e mi kam gjetur mbështetje të madhe, veçanërisht tek dekani Muhamet Ahmeti dhe prodekani Visar Krelani, të cilët më ndihmuan në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim”, tregoi ai, teksa shtoi se të njëjtën frymë bashkëpunimi e ka gjetur në

UBT prejse ishte transferuar nga një universitet publik.

“Unë jam transferuar në UBT sepse më krijonte hapësirë për përmirësim dhe ofronte kushte për të arritur këtë gjë”.

Albani ishte edhe pjesë e grupit të studentëve të UBT-së, të cilët patën mundësinë e mbajtjes të praktikës njëmuore në kompaninë “Bechtel-Enka”.

Që nga themelimi e deri më sot, UBT ka arritur mbi 300 marrëveshje bashkëpunimi me institucione arsimore nga e mbarë bota dhe prej tyre kanë përfituar qindra studentë, të cilët janë bërë pjesë e programeve të shkëmbimit për një e më shumë semestra ose edhe për përfundim të plotë të studimeve jashtë Kosovës.



Rrëfime Suksesi

Herolind Ramadani i UBT-së, arkitekt në byronë “KOMPAS”


Ndër qindra studentë të UBT-së të cilët janë punësuar ende pa i përfunduar studimet, është Herolind Ramadani, i cili aktualisht po e përfundon nivelin master të studimeve në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor. Punën e vet prej arkitekti, ai po e zhvillon në byronë projektuese ndërtimore “KOMPAS”, në Gjilan, me ç’rast ka marrë pjesë në disa projekte të rëndësishme që janë realizuar në Gjilan, përfshirë këtu edhe projektimin e autoudhës Prishtinë-Gjilan.

Para punësimit, studenti Ramadani ka përfunduar punë praktike edhe në byronë projektuese inxhinierike “AE-ing”, në Gjilan. Për kontaktin

e tij me tregun e punës, thotë se i ka ndihmuar UBT dhe profesorët, të cilët i kanë ofruar ndihmë dhe informacione në çdo kohë.

“UBT më ka bërë profesionist të mirë, andaj ndjehem i obliguar të jap shumë për urbanizmin dhe për arkitekturën në vend, por pse jo edhe jashtë Kosovës”, potencoi Ramadani.

UBT ka shkollën më të madhe të Arkitekturës në Kosovë dhe rajon, prej ku çdo vit dalin qindra studentë të diplomuar dhe të përgatitur plotësisht për tregun e punës, mbi 90% prej të cilëve gjejnë vende pune si arkitektë në Kosovë dhe jashtë.



Ish-studentja e MBE-së, Edona Kullashi e punësuar në kompaninë “Elkos”

Ish-studentja e UBT-së, Edona Kullashi, e cila ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, në UBT, tashmë është e punësuar në kompaninë “Elkos” dhe po mban pozitën e analistes ku përgatit dhe analizon raporte të ndryshme.

Paraprakisht ajo gjatë studimeve falë aftësive të treguara ishte sistemuar me punë të rregullt në bankën Raiffeisen, konkretisht në departamentin e operacioneve ose në E-Banking.

Ajo ka thënë se me ndihmën, përkrahjen dhe motivimin nga profesorët e UBT-së, ka arritur t’i realizojë qëllimet e saj. Njëherësh Kullashi theksoi se UBT është vendi ku mund të studiosh dhe të punosh.

“UBT është qendër e dijes, si dhe një institucion i mundësive të mëdha. Programet akademike në UBT, përfshirë edhe fakultetin në të cilin studiova unë, zhvillohen me standarde të larta kualitative. Po ashtu, vlen të theksohet se jo vetëm institucioni por edhe diplomat që lëshohen në UBT njihen edhe në rrafshin ndërkombëtar”, ka thënë ajo.

UBT është institucion i arsimit të lartë, që u mundëson studentëve zhvillim të karrierës së tyre në fusha të ndryshme, ku janë të përpiluara në atë mënyrë sa që, ata të marrin njohuri dhe praktika të avancuara.



Shpallen projektet fituese të studentëve të UBT-së, nga punëtorja UPSHIFT-it

Ka përfunduar punimet punëtorja “UPSHIFT: Social Impact Workshop”, organizuar nga UBT dhe UNICEF Innovations Lab Kosovo, ku morën pjesë shumë studentë të UBT-së, të ndarë në 10 grupe, prej të cilëve tri grupe janë shpallur fituese. Projektet fituese janë: “N’trafik”, “E-Farming” dhe “Mental Health App”, të cilat janë zhvilluar si rezultat i bashkëpunimit të UBT-së dhe UNICEF-it. Këto projekte fituan grandin nga 2 mijë euro për projekt me qëllim të jetësimin të këtyre ideve, teksa në muajt në vijim grupet fituese do të punojnë në finalizimin e ideve. Gjatë realizimit të projekteve

grupet fituese do të përkrahen nga stafi akademik i UBT-së, njëherësh do të shfrytëzohen edhe hapësirat dhe laboratorët e institucionit për të zhvilluar punimet.

UPSHIFT është organizuar nga Qendra e Inovacionit Social “INSPIRE”, në kuadër të programit “Colibri”, teksa është një mundësi e mrekullueshme për jetësimin e projekteve inovative të studentëve të cilat kanë për qëllim të ndihmojnë në identifikimin dhe në zgjidhjen e problemeve të ndryshme, me të cilat përballen qytetarët e Kosovës në baza ditore.

Ish-studentja e Shkencave Politike, Ferdiana Hoti pjesë e qendrave evropiane të shkencës

Ferdiana Hoti ka qenë studente e dalluar e Fakultetit Shkencave Politike në UBT, e cila më pas fitoi bursë për të vazhduar studimet në Universitetin e Salzburgut në Austri ku edhe diplomoi.

Gjatë kësaj periudhe dyvjeçare në Austri, ajo ka ndjekur kurse të gjuhës Gjermane, Kroate dhe Kineze, si dhe trajnime dhe internshipe të ndryshme shkencore në Evropë ku i ndihmuar në rritjen e saj akademike.

Pas diplomimit në Austri, ajo vendosi të vazhdojë studimet e nivelit master në Universitetin e Antwerpenit në Belgjikë, ku njëherësh ajo ka ndjekur edhe një internship tjetër shkencor në këtë universitet dhe kursin e gjuhës flamane.

Aktualisht, falë njohurive dhe eksperiencave të saja shkencore ajo fitoi edhe bursë për studimet e doktoratës nga “SCK-CEN”, i cili është Instituti më i madh i Shkencës në BE.

Ish-studentja e UBT-së, Ferdiana Hoti mbrojti më sukses propozimin e temës së doktoratës, andaj asaj i

është ofruar bursë 4 vjeçare nga komisioni më i madh ndërkombëtar i Akademisë Shkencore në Evropë, në bashkëpunim me Universitetin e Antwerpenit.

Ajo është pranuar në mesin e 15 aplikantëve më të mirë prej 130 personave nga e gjithë bota sa kanë aplikuar, teksa në tetor pritet ti fillojë studimet e doktoratës. Po ashtu, ajo do të punojë edhe si asistentja e parë kosovare në Universitetin e Antwerpenit, në Belgjikë.

“Fillimi i studimeve dhe punës sime në këtë institut është arritje e dyfishtë. Së pari, do të jem në gjendje të tregoj rëndësinë e shkencave shoqërore në një institut me fokus primar në ato natyrore. Së dyti, në këtë institut me punëtorë dhe studente me afër 40 nacionalitete të ndryshme, unë do të jem studentja e pare nga Kosova”, ka treguar ajo.



Rrëfime Suksesi

Ish-studentja e UBT-së, projektuese e Qendrës për edukim joformal të të rinjve

Në Pjetërshitan të Gjakovës ka filluar ndërtimi i Qendrës për edukim joformal për të rinjtë, si dhe qendër rekreative për fëmijë “Regreenation”, projekt i cili është hartuar dhe projektuar nga ish-studentja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Jeta Bejtullahu, e cila tash e pesë vite ka themeluar studion e saj projektuese “FormaDDM”.

Në këtë projekt kapital të ndihmuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ish-studentja ka qenë arkitektja kryesore ku ka zhvilluar konceptin përmes tri komponentëve: ambienti, komuniteti i të rinjve dhe aktivitetet rekreative.

Bejtullahu ka thënë se ka projektuar një hapësirë multi-

funkionale që ofron kushte të mira për zhvillimin e aktiviteteve të të rinjve dhe edukimin e tyre të mëtejshëm.

“Projekti është hartuar duke u bazuar në bashkëveprimin e mjedisit natyror, ku përfshinë sipërfaqe të hapur për aktivitete rekreative në natyrë dhe sipërfaqe gjelbëruese, të tilla si: fushë sporti mikse, fushë voleybolli në rërë, mini-golf, shtigje për ecje dhe për vrapim, trajnim për gjuajtje me shigjeta, hapësirë për kamping, amfiteatër i hapur, mur për ngjijte, hortikulturë (bletari, shtëpi të gjelbërta, kopshtari) dhe mjedisit të ndërtuar, i cili përfshinë edhe 3 pavijone të fjetjes (akomodim)”, ka treguar Bejtullahu.

Kjo qendër do të shndërrohet në një kamp i modelit amerikan, teksa karakterizohet me hapësira të veçanta për orga-

nizimin e trajnimeve të ndryshme me qëllim të aftësisimit të rinisë në ndërmarrësi, inovacion, sport etj.

Gjatë studimeve në UBT, Jeta Bejtullahu ka qenë përfutuese e disa bursave nga programi i mobilitetit CEE-PUS në Universitetin Teknik në Ceki, në Universitetin Politeknik të Shubenikut, në Kroaci, si dhe në Universitetin Teknik të Krakovës, në Poloni.

Në vitin 2017, së bashku me Ilirjana Haxhijaj morën çmimin laureate nga “Future Architecture Platform” me projektin “Redevelopment of social housing infrastructure in Gjakova”, ku u renditën në pozitën e katërt nga dhjetë projektet më të mira.

Stina Shabani përfiton nga programi Erasmus+

Ish-studentja e dalluar e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Stina Shabani, tashmë është një nga studentët e shumë ndërkombëtarë të Anhalt University of Applied Sciences, në Dessau të Gjermanisë, me punën e të cilit është njoftuar për herë të parë falë një procesi të shkëmbimit të studentëve që programi Erasmus+ ua mundësoi studentëve të UBT-së, me ç’rast ajo dhe tre studentë të tjerë e përfunduan një semestër dimëror atje.

Ky semestër e shtyri Stinën që të aplikojë për vijim të studimeve master në Anhalt University of Applied Sciences, ku edhe i kaloi me sukses të gjitha procedurat e kërkuara, pasi UBT e ka përgatitur maksimalisht dhe i ka ofruar asaj mundësi për studime jashtë vendit.

“Eksperiencia ime e parë në këtë universitet ishte falë UBT-së. Gjatë tri viteve jam përgatitur profesionalisht në një nivel shumë të mirë, që më ndihmoi të pranohem për vazhdim të studimeve në Universitetin Teknik të Vjenës, si dhe në Anhalt University of Applied Sciences, mirëpo në fund zgjedha këtë të dytin”, tregoi Stina.

Ajo shpreson se ky universitet do të arrijë t’i plotësojë pritshmëritë e saj mbi nivelin e studimeve, nisur nga fakti se ky institucion ka një metodë unike të studimit të fushës së arkitekturës.

“Pritshmëritë për vazhdimin e studimeve në Gjermani janë të mëdha, pasi Anhalt-i si universitet i kushton shume rëndësi përfshirjes së teknologjisë në arkitekturë, andaj edhe njohja me lëndët si: Arti i Robotikës dhe Dizajni Parametrik, është domosdoshmëri dhe veçori e këtij universiteti. Këto njohur të cilat janë shumë të nevojshme për arkitektët të rinj, por fatkeqësisht nuk ofrohen në të gjitha universitetet, prandaj edhe konsideroj veten me fat”, u shpreh Stina. Ajo dëshiron të shërbejë si shembull i studentes që i është shpërblyer puna dhe munda, pasi ajo thotë se UBT i shpërblen studentët e dalluar dhe u ofron studime të mëdha për studime jashtë vendit, gjithmonë atëherë kur studentët shprehin interesim dhe punojnë me veten e tyre.



Profesori Alban Muja do të prezantojë Kosovën në Bienalen e Venedikut



Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi dhe komisionerja e Pavijonit të Kosovës në Bienalen e Venedikut, Arta Agani, njëherësh drejtoreshë e Galerisë Kombëtare të Kosovës, kanë marrë vendim që artisti e ligjëruesi në UBT, Alban Muja të prezantojë Kosovën në edicionin e 58-të të Ekspozitës Ndërkombëtare të Artit në Bienalen e Venedikut.

Në një komunikatë për media, Ministri Gashi thuhet të këtë thënë se prezantimi

i Kosovës në këtë ngjarje përmes Alban Mujës, është tejet i rëndësishëm dhe se Kosova do të ketë një prezantim të suksesshëm në edicionin e vitit të ardhshëm. Ministri po ashtu vlerëson pjesëmarrjen e Alban Mujës në ekspozita dhe festivale të ndryshme jashtë vendit.

“Artisti Alban Muja, i cili do të prezantojë Kosovën në Bienale, është emër i afirmuar edhe në skenën botërore të artit. Puna e Mujës është ekspozuar gjerësisht

në festivale të ndryshme, panairë arti, ekspozita grupore dhe solo”, citohet të këtë thënë ministri Gashi.

Ndërkohë, profesori në UBT, Alban Muja, veç tjerash ka theksuar se është i nderuar që do ta përfaqësojë Kosovën në edicionin e 58-të të Bienales.

Ekspozita do të mbahet në vitin 2019, konkretisht do të fillojë punimet më 11 maj deri më 24 nëntor.

Projekti i profesorit Tafa dhe studentëve të UBT-së, prezantohet në konferencë në Mal të Zi

Profesori në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, prof. dr Zhilbert Tafa ka marrë pjesë në konferencën me renome ndërkombëtare në lëmin e shkencave kompjuterike dhe elektroteknikës, “IEEE Mediterranean Conference on Embedded Computing”, që mbahet çdo vit në Mal të Zi.

Kjo konferencë është organizuar nga Fakulteti Elektroteknik i Universitetit të Malit të Zi dhe nga Montenegrin Association for New Technologies, teksa në të, profesorit Tafa ka prezantuar punimin me titull: “The Design of a ZigBee – Based Greenhouse Monitoring System”, punim të cilin e ka zhvilluar së bashku me studentët e UBT-së, Fatlum Ramdani dhe Blerona Cakolli.

Ky punim ka të bëjë me zhvillimin e rrjeteve sensorike pa tela për monitorimin kontinual të parametrevë të ambientit. Hulumtimi është pjesë e projekteve që janë duke u zhvilluar në laboratorin për Internet of Things, në UBT, të udhëhequr nga prof.dr Zhilbert Tafa.

Vitin e kaluar, në këtë konferencë, punimi i profesorit Tafa ishte vlerësuar si më i cituari në punime të ndryshme shkencore dhe libra, si pjesë e literaturës në lëmin e shkencave kompjuterike.

Po ashtu, në Institutin “MECONet”, në mesin e shumë emrave, përfshirë edhe fituesve të çmimit Nobel, figuron edhe emri i profesorit Tafa, si anëtar dhe hulumtues i çështjeve teknologjike.



Rrëfime Suksesi

Ish-studentja Gresa Sheqiri, përfituese e bursës së programit “PoSIG”

Bashkëpunimi ndërmjet universiteteve evropiane nëpërmjet programit “PoSIG”, tashmë po i jep rezultatet e para, nga të cilat po përfitojnë drejtpërdrejt studentët dhe ish-studentët e UBT-së.

Studentja e posadiplomuar në UBT, në Fakultetin e Shkencave Politike, Gresa Sheqiri, ka arritur që përmes këtij programi të fitojë bursë për vijim të studimeve të nivelit master në Universitetin e Salzburgut, në Austri.

Gresa tha se është tejte e lumtur që e ka fituar këtë bursë, që do t'i ofrojë asaj një mundësi të mrekullueshme për ngritje akademike.

“Gjatë studimeve të mia në PoSIG do të fitoj njohuri të mjaftueshme për t'u përgatitur për sfidat gjatë karrierës sime të ardhshme. Kjo do të më ndihmojë në zgjerimin e njohurive të mia për çështje të ndryshme, si dhe për të mësuar proceset politike dhe sociale në Bashkimin Evropian dhe më gjerë”, theksoi ajo.

Ndërkohë, përgjatë gjithë procesit dhe për kryerjen me sukses të procedurave të aplikimit

tregon se ka gjetur mbështetje dhe ka marrë udhëzime nga profesori në UBT, Artan Murati. Përmes programit PoSIG, viti i parë përfundohet në njërin nga universitetet e Bashkimit Evropian, ku ofrohet një mësimdhënie e nivelit të lartë teorik dhe metodologjik, ndërsa viti i dytë përfundohet në njërin nga universitetet e Ballkanit Perëndimor, që u mundëson studentëve të bëhen të specializuar në çështjet që lidhen me integrimin e vendeve fqinje të BE-së, teksa në përfundim të këtij masteri përfshihet edhe praktika njëmuajore në institucionet e BE-së.

Programi PoSIG është master i përbashkët në Shkenca Politike, Integrim dhe Qeverisje, që po jetësohet nga partnerët e Bashkimit Evropian dhe të Ballkanit Perëndimor.

Me këtë rast, studentëve u ofrohet mundësi unike studimi në institucionet më prestigjioze evropiane të arsimit të lartë, siç janë: Universiteti i Salzburgut në Austri, Universiteti i Pavia në Itali, Universiteti i Lubjanës në Slloveni etj.

Jeton Zogaj, definicioni i studentit të suksesshëm në nivelin master

Jeton Zogaj është student i nivelit master në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës në UBT, teksa njëkohësisht është edhe i punësuar në kompaninë ndërtimore, “Krapicom”, ku mban pozitën e kryeinxhinierit dhe të menaxherit të projekteve.

Përveç studimeve në UBT, ai po ia del që me shumë sukses t'i kryej edhe të gjitha përgjegjësitë me të cilat është i ngarkuar në vendin e tij të punës.

Jetoni thotë se bashkërendimi i punës dhe studimeve nuk është proces i lehtë, por sikurse ai, sukses po arrijnë edhe kolegët e tij të studimeve.

“Unë dhe pothuajse të gjithë kolegët e gjeneratës sime të studimeve master në UBT, jemi të punësuar dhe vijmë nga një përvojë e mirë praktike disavjeçare”, tregoi ai.

Jetoni i takon gjeneratës së parë të studentëve në specializimin “Menaxhimin e Ndërtimit dhe Teknologji”, andaj edhe vlerëson se gjatë studimeve në UBT është pasuruar me njohuri të reja për këtë fushë.

“Një student i nivelit master pranë UBT-së është një kuadër i kompletuar për marrjen e detyrave dhe përgjegjësi të fushës që i takon dhe është një kuadër i përgatitur mirë për nevojat e tregut të punës. Për këtë ndikim të madh kanë profesorët dhe pjesa tjetër e stafit të UBT-së, të cilët na kanë përkrahur dhe na kanë ndihmuar në të gjitha aspektet dhe gjatë gjithë kohës”, tha ai.

Para fillimit të studimeve master, Jetoni nuk ka menduar se do të vazhdonte studimet e mëtejshme, por me marrjen e informacioneve të reja në fushën për të cilën është duke specializuar aktualisht, është i interesuar edhe për vazhdim të studimeve të doktoraturës, duke qenë se Kosovës i mungojnë dukshëm ekspertët e kësaj fushe.

Vlen të theksohet që afati për regjistrim të studimeve në nivelin master në UBT, përfshirë edhe në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës, po vazhdon të qëndrojë i hapur edhe për dy ditë.

Rreth 300 studentë të UBT-së, pjesë e universiteteve me të njohura në botë

UBT vazhdon të mbetet lider i ndërkombëtarizimit në Kosovë, institucion i cili ofron studime të përbashkëta, bursa dhe projekte si ERASMUS + dhe CEPUS.

Falë marrëveshjeve të bashkëpunimit që UBT ka me mbi 300 universitete të ndryshme të Evropës e botës, qindra studentëve u mundësohet të bëhen pjesë e universiteteve më prestigjioze në botë.

Në mesin e shumë studentëve që fituan bursë për t'i ndjekur studimet për një semestër të vitit akademik janë edhe Vesa Morina e Shqipe Sejdiu.

Studentet në fjalë këtyre ditëve janë kthyer nga Universiteti i Portugalisë, “NOVA de Lisboa”, ku kanë ndjekur studimet për një semestër të vitit akademik në këtë universitet.


Studentja Vesa Morina është shprehur e lumtur dhe e privilegjuar që ka përjetuar një përvojë të re në studime jashtë

vendit dhe tha se kjo mundësi ka qenë ndër përvojat më të mira që ka përjetuar deri më tani.

“Kam mësuar shumë lidhur me profesionin, gjithashtu kam takuar shumë studentë të kombësive të ndryshme”, theksoi ajo.

Teksa, studentja Sejdiu, duke e ndarë përvojën e saj, shtoi se UBT është vend i mundësive për studentët e rinj që dëshirojnë të ndërtojnë një karrierë të suksesshme.

Aktualisht, UBT ka rreth 300 studentë që janë duke vazhduar studimet nëpër universitetet më të njohura evropiane. Të gjithë studentët të cilët shprehin dëshirë të bëhen pjesë e UBT-së në të gjitha nivelet e studimeve, kanë mundësinë që automatikisht t'i vazhdojnë studimet jashtë vendit, në universitetet më prestigjioze në Evropë dhe nëpër vendet tjera të botës.



Student, praktikant e më pas i punësuar në UBT

Erjon Ameti është një nga shumë studentë të UBT-së, të cilët falë suksesit të treguar gjatë studimeve janë angazhuar dhe punësuar në institucionin në të cilin morën dije për gjatë disa viteve.

Ameti ishte student i Fakultetit Menaxhim i Mekatronikës në nivelin bachelor, i cili në po të njëjtin drejtim ka vazhduar edhe nivelin master.

Gjatë studimeve themelore ai ishte tutor në disa lëndë, e më pas u angazhua si përgjegjës për laboratorin e mekatronikës në Kampusin Inovativ të UBT-së, në Lipjan.

“Në laboratorin në fjalë bashkërisht me studentët bëjmë realizimin e projekteve praktike duke përfshirë gjitha disiplinat e mekatronikës, pra mekanikën, elektronikën, kompjuterikën dhe pjesën e kontrollit. Projektet të cilat realizohen në këtë laborator, janë pjesëmarrëse në shumë aktivitete dhe prezantime të ndryshme shkencore”, tregoi

Ameti.

Duke folur për mundësitë e ofruara nga institucioni, Ameti theksoi se në UBT është i angazhuar stafi më profesional vendor e ndërkombëtar andaj, sipas tij, institucioni mbetet të jetë lider në fushën e inxhinierisë dhe jo vetëm.

“Kushtet që më janë ofruar gjatë studimeve dhe stafi akademik mbështetës konsideroj që e bëjnë UBT-në shumë të veçantë. Stafi akademik me potenciale të reja të zhvillimit në fusha të ndryshme shkencore, mbetet një arsyeje tjetër që ky institucion është dhe do të mbetet lider në gjitha programet e studimit”, tha Ameti.

UBT ofron programin Menaxhim i Mekatronikës në nivelin master, me qëllim të përmisimit të sistemeve të informacionit dhe sistemeve komunikuese, globalizimit apo ndryshimit në industri. Ky program ofrohet me specializime unike



Studentët e arkitekturës në UBT garues në konkursin për 20 mijë dollarë në Mbretërinë e Kamboxhis

Studentët e Fakultetit Arkitekturës dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Benard Shala, Ulkis Bajqinovci, Alina Ahmeti, Besajan Bytyqi dhe Riola Hamzaj, kanë hartuar një projekt madhështor për banorët e Kamboxhisë, projekt më të cilin po konkurrojnë në konkursin "Affordable Housing Challenge 2018", organizuar nga Programi Zhvillimor i Bashkimit Evropian në bashkëpunim me Building Trust International.

Ata janë në garë për çmimin prej 20 mijë dollarësh në Cambodja, teksa projekti i tyre përbëjnë një hapësirë prej 70 mijë metra katrorë për rreth 4 mijë njësi banimi të shoqëruara nga hapësirat e veçanta si gjelbërimi, dyqanet etj. Duke folur për konceptin e masterplanit, studenti i UBT-së Benard Shala ka thënë se ky

projekt është mjaftë interesant me një kosto mjaft të arsyeshme dhe bëri të ditur se me anë të këtij projekti po përfaqësohet edhe Kosova si shtet.

"Në këtë koncept banesor kemi shfrytëzuar edhe rrjedhën e lumit dhe është konsideruar si avantazh sepse me këtë trajektore të shtrirjes së lumit, si dhe morën formën e komplekseve banesore që i japin rrjedhshmëri dhe ndërlidhje më lokacionin", ka shpjeguar Shala.

"Synimi i grupit është që fillimisht të përfaqësojmë UBT-në e më pas edhe Kosovën si shtet si dhe të japim mesazhin që edhe studentët kosovarë janë të aftë të punojnë projekte e të garojnë në konkurse të tilla ndërkombëtare", theksoi ai.



Studentët e arkitekturës në UBT, prezantojnë projekte për hapësira urbane të Deçanit e Lipjanit



Studentët e vitit të tretë, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, kanë prezantuar projektet e ndërlidhura me hapësirat urbane të qytetit të Deçanit dhe Lipjanit, punime këto të cilat kanë qenë detyrë semestrale.

Projektet e studentëve janë punuar në kuadër të lëndës "Planifikimi Urban", ligjëruar nga profesori Binak Beqaj, sipas të cilit, këto punime janë cilësore dhe të strukturuar mirë sepse janë punuar në bazë të analizës dhe vlerësimit të gjendjes në terren, ku studentët kanë shqyrtuar opsionet planifikuese dhe rregulluese të hapësirave komunale.

Punimet më të mira të studentëve do të identifikohen, ku në prani të kryetarit të komunës dhe zyrtarëve tjerë komunal, do të prezantohen në Deçan.

Këto projekte veç tjerash do të shërbejnë edhe si koncepte bazë ku mund të tërheqin shumë investime të reja në komunë.

Ditë më parë, përfaqësuesit e UBT-së dhe të komunës së Deçanit, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim të krijimit të mundësive për përkrahje zhvillimore të të dyja institucioneve.

Marrëveshja është iniciuar nga prof. dr Binak Beqaj dhe parasheh ndërtimin e kapaciteteve institucionale, kryerjen e hulumtimeve të përbashkëta, zhvillimin e pilot projekteve, trajnime, organizimin e takimeve afariste dhe vizitave afaristëve kosovarë jashtë vendit, etj.

Studentët e Farmacisë në UBT, përfitojnë bursë nga programi CEEPUS

Programi i mobilitetit CEEPUS (program evropian për shkëmbime në studime universitare) u ka mundësuar studentëve të dalluar të Fakultetit të Farmacisë në UBT, Skënder Radoniqi dhe Qëndresa Spahiu, të përfitojnë bursë për qëndrim një muaj në Austri, me qëllim të përfundimit të hulumtimit shkencor dhe grumbullimin e rezultateve për temat e tyre të diplomës.

Ata do të qëndrojnë në Universitetin "Karl-Franzens", në Graz të Austrisë, konkretisht në Institutin e Kimisë Analitike, që gjendet në këtë institucion.

Studentët do të kryejnë hulumtimet në këtë shtet nën mentorimin e ligjërueses dhe koordinatorës së Fakultetit të Farmacisë në UBT, Dr. Eda Mehmeti.

UBT është i vetmi institucion privat i arsimit të lartë në Kosovë, që është anëtar me të drejta të plota në programin CEEPUS.

Ky program u mundëson studentëve të përfitojnë përvojë ndërkombëtare, teksa në kuadër të Programit CEEPUS, UBT është partnere në disa rrjete bashkëpunimi me universitete të rajonit dhe të BE-së, përmes të cilave mundësohet mobiliteti dhe shkëmbimi i studentëve e stafit akademik.



Ekspozita e parë ndërkombëtare në Kosovë

UBT sjell në Kosovë ekspozitën e parë ndërkombëtare të arkitekturës



Muret e Muzeut Kombëtar të Kosovës u zbuluan e pasuruan me ekspozitën që shfaq qindra punime të realizuara nga studentët e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, si dhe nga dhe shkolla të arkitekturës në Evropë, që u dhuruan qindra të pranishmëve punime dhe projekte arkitektonike nga më të ndryshmet.

Kjo shënon edhe ekspozitën e parë ndërkombëtare të realizuar në Kosovë, ndërkaq e njëjta do të qëndrojë e hapur tërë javën e ardhshme.

Drejtori për Çështje Akademike në UBT, Valmir Hoxha vlerësoi se një ekspozitë e tillë sjell frymë të re dhe përbën vlerë të shtuar për Kosovën.

“Në kërkim të projekteve të veçanta dhe inspirimit për ta bërë Kosovën një vend të ndërtesave të bukura, jam i bindur që kjo ekspozitë do të sjellë diçka të paparë më parë në vend, dhe si shumë herë të tjera, UBT po ndikon që Kosova të hyjë në hartën e vendeve të para që bëjnë bashkë punime që kanë dalë nga shkollat më të njohura të arkitekturës në Evropë.

Dekani i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, prof dr Lulzim Beqiri tha se UBT përmes kësaj ekspozite synon ta pozicionojë dhe Kosovën në një fazë të njohjes së vlerave dhe integritit në shoqëritë e zhvilluara dhe me përvojë akademike.

“UBT tradicionalisht organizon ekspozitën e arkitekturës që nga themelimi i saj, por që kjo është hera e parë që organizohet një ekspozitë ndërkombëtare e këtij formati në Kosovë, apo edhe më gjerë, e që jemi të lumtur që një e tillë po organizohet nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT”, theksoi ai.

Drejtori i Muzeut të Kosovës, Skender Boshtrakaj në fjalimin e tij potencoi se Kosova është vend që u ofron të rinjve shumë mundësi për të ushtruar profesionin e tyre dhe ka nevojë për mendje që shikojnë më thellë e më gjerë, mendje këto që me kompetencë të plotë, sipas tij, formohen në UBT.

“Ky vend ju ofron shumë mundësi për ta ushtruar zanatin e juaj, ka nevojë për një mendje që shkon përtej shtëpisë,

përtej oborrit, që shkon përtej një lagjeje, që edhe qytetin e sheh në një kontekst më të gjerë dhe unë jam i bindur që UBT e ofron këtë sepse është një çerdhe e dijes dhe e kompetencës”, u shpreh Skender Boshtrakaj.

Fakultetet pjesëmarrëse në këtë ekspozitë të organizuar nga UBT, ishin: Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT (Kosovë), Fakulteti i Arkitekturës në Universitetin e Podgoricës (Mali i Zi), Fakulteti i Arkitekturës nga Universiteti Politeknik i Tiranës (Shqipëri), Universiteti Niğde Ömer Halisdemir (Turqi), Fakulteti i Arkitekturës në Universitetin e Pecs (Hungari), Shkencat e Aplikuara Bern (Zvicër), Fakulteti i Arkitekturës në Universitetin Teknologjik në Wrocllav (Poloni), Fakulteti i Arkitekturës në Universitetin Shtetëror të Tetovës (Maqedoni), Universiteti Teknik i Vjenës (Austri), Fakulteti i Arkitekturës dhe Mjedisit Ndërtimor TU Delft (Holandë), Fakulteti i Arkitekturës në Universitetin e Zagrebit dhe Anhalt University of Applied Science, BAUHAUS (Gjermani).

BIRN mban trajnim për gazetari hulumtuese për studentët e UBT-së

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) mbajti trajnim për studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim, që u fokusua tek tema “Përmirësimi i standardeve të gazetarisë hulumtuese përmes përvojave të përbashkëta”.

Trajnimi filloi me ligjëratën e mbajtur nga redaktorja në Kallxo.com, Laura Limani, e cila, në formë rikuqimi për studentët, trajtoi aspektin teorik dhe bazën e zhvillimit të profesionit të gazetarisë. Ndërkaq, në pjesën e dytë ajo trajtoi standardet më të mira të etikës në gazetari, çështjen e respektimit të tyre dhe problemet e dilemat etike me të cilat po përballen gazetarët kosovarë momentalisht.

Zyrtari ligjor i BIRN-it, Labinot Leposhtica ka sqaruar çështjen e edukimit për pasojat ligjore që mund të vijnë nga raportimi i pasaktë, shkeljet e privatësisë dhe shpërndarja e të dhënave personale. Po ashtu, ai trajtoi edhe mënyrën e drejtë të raportimit nga gjykatat, raportimi në situata krizash, raportimin për terrorizëm, ekstremizëm të dhunshëm, abuzim të fëmijëve, katastrofa natyrore dhe raportim për incidente kriminale.

Redaktori Visar Prebreza para studentëve shtjelloi përdorimin e mediave sociale për të hulumtuar dhe mundësitë e pikëtimit të lajmeve të rreme në rrjete sociale, hulumtimin e thellë në dokumente publike dhe edukimin për rrugët ligjore për qasje në dokumente publike, si dhe përdorimin e sinjalizuesve e platformave për raportim të korrupsionit dhe informacioneve nga qytetarët, për të hulumtuar raste të mëdha të korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Prebreza i njoftoi studentët edhe me lansimin e produktit më të ri të BIRN-it, Krypometrin, i cili po shërben si matës i mbajtjes së premtimeve të dhëna nga politikanët dhe persona të tjerë, në dobi të përmirësimit të jetës së qytetarëve, premtime këto që në Krypometër dalin si të realizuara ose jo.

Në fund të trajnimit, për studentët pjesëmarrës u certifikuan dhe të njëjtit fituan të drejtën për të aplikuar për bursën e realizimit të një hulumtimi rreth një teme me rëndësi për vendin dhe rajonin. Bursa në fjalë do të sigurojë mbështetje financiare dhe profesionale për studentët fitues.



Qendra e Transferimit të Teknologjisë

Në UBT diskutohet mbi rëndësinë e mbrojtjes së pronës intelektuale

Vlera e çdo produkti dhe shpikjeje shumëfishohet në momentin që i njëjti patentohet dhe kur mbrohen të drejtat e autorit me ligjet në fuqi të Kosovës.

Kjo çështje u adresua dhe potencua me rastin e diskutimit për pronësinë intelektuale dhe transferimin e teknologjisë në kuadër të Javës Globale të Ndërmarrësisë, për të cilën qëndrimet e tyre i paraqitën ekspertë të kësaj fushe, të cilët promovojnë në mënyrë të vazhdueshme rëndësinë e patentimit të shpikjeve.

Për të vetëdijësuar shoqërinë mbi këto të drejta, UBT ka themeluar Qendrën e Transferimit të Teknologjisë, udhëheqësja e të cilës, Drenica Lauka, tha se e drejta pronësore intelektuale është baza e një suksesi të garantuar të një produkti, andaj edhe UBT i ka dhënë rëndësi formimit të një qendre të tillë.

“Qendra për Transferimin e Teknologjisë është krijuar për të ndihmuar stafin dhe studentët krijues dhe inovatorë, pa marrë parasysh etapën e zhvillimit të idesë së tyre. Secili që ka ide duhet t’i drejtohet qendrës para se ta bëjë publike, në mënyrë që të mbrohet nga përvetësimi i idesë nga një palë e tretë”, vlerësoi Lauka.

Për të treguar mbi rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë intelektuale, i pranishëm ishte edhe ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi, i cili potencoi se Kosova, Shqipëria dhe shtetet tjera të rajonit vetëm se e kanë hapur një temë të tillë, dhe sipas tij, dy shtetet tona kanë problem më të theksuar me respektim të të drejtave të autorit, ndonëse ka inovatorë të shumtë, por që nuk kanë njohuri mbi të drejtat e tyre.

“Në Kosovë dhe Shqipëri ka talente të shumta, por janë të paudhëzuar dhe të padrejtuar në aspekte zhvillimore. Në këtë aspekt, UBT është promotor i nxitjes së ideve të reja, që pastaj i japin nxitje rritjes ekonomike të vendit”, theksoi Minxhozi.

Drejtori i Zyrës për të Drejta të Autorit dhe të Drejta të Përafërta, Valon Kashtanjeva, përmes disa shembujve të kompanive më të mëdha botërore, e tregoi rëndësinë e pronësisë intelektuale.

“Këto kompani janë të fuqishme dhe me kapital të pasur, jo pse kanë hapësira territoriale e objekte të mëdha, porse të njëjtat kanë patentuar dhe mbrojtur të drejtën e autorit për produktet e tyre”, sqaroi ai. Udhëheqësja e Sektorit për Pronësi Intelektuale në Doganat e Kosovës, Sadije Topojani foli për rolin e Doganës së Kosovës në mbrojtjen e pronësisë intelektuale, me ç’rast përmes shembujve, fotografive të aktiviteteve dhe statistikave të nxjerra nga raportet, tregoi mbi rolin aktiv dhe kyç të Doganës së Kosovës në luftimin e piraterisë dhe mbrojtjes së autorëve legjitimë të produkteve inovative.

“Shkelja e të drejtave të autorit nuk e dëmton vetëm shpikësin e produktit, por e dëmton edhe ekonominë e vendit, tregun e konkurrencës së ndershme dhe shëndetin e njerëzve”, shpjegoi Topojani.

Ajo tregoi se vetëm nga janari i këtij viti, Dogana e Kosovës ka ndaluar mallra pirate në vlerë prej dy milionë eurosh, të cilat kryesisht kanë qenë aksesorë për gjininë femërore, telefona dhe aksesorët për telefona, kozmetikë, etj.

Ky aktivitet u përmbyll me një diskutim të hapur me publikun, me ç’rast panelistët u përgjigjën në pyetjet mbi patentimin e ideve inovative, procedurat dhe kohëzgjatjen e procesit të patentimit, përfitimin financiar të krijuesit nga mbrojtja e idesë së tij, si dhe strategjitë e reja të qeverisë për pronësinë intelektuale.



Delegacioni nga Universiteti Linnaeus vizitoi UBT-në

Një delegacion i Universitetit Linnaeus, nga Suedia, i përbërë nga profesorë të fushave të ndryshme, si dhe staf administrativ, po qëndrojnë në Kosovë, konkretisht në UBT, të cilët po realizojnë vizitë në kuadër të planifikimeve të projekteve Erasmus+ KA1 dhe KA2.

Fillimisht, ata janë takuar me rektorin e UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, ku kanë diskutuar për zgjerimin e bashkëpunimi ndër-institucional, bashkëpunim i cili ka filluar qysh para katër viteve në sferën e hulumtimeve dhe edukimit.

Përpos bashkëbisedimit, ata diskutuan për gjenerimin e projekteve përfshirë në shkëmbim të stafit, të studentëve dhe krijimin e qendrave hulumtuese.

Tutje, ata vizituan edhe laboratorët që gjenden në objektet e UBT-së, si dhe pajisjet e sofistikuar moderne që i shfrytëzojnë studentët e të gjitha fushave, për kryerjen e punës praktike. Po ashtu, ata janë takuar dhe kanë bashkëbiseduar me zyrtarë e profesorë të UBT-së, lidhur me projektet inovative të cilat implementohen nga institucioni dhe rezultatet e arritura.



Në UBT diskutohet për rolin dhe funksionin e Dhomave të Specializuara të Kosovës

Gjykata Speciale nuk ka kryer misionin e saj dhe, për më tepër, i njëjti nuk është sqaruar asnjëherë. Kosova dhe Serbia nuk kanë nevojë vetëm për institucione ndëshkimi, por edhe për komisione pajtimi, që do të shërbenin për zgjidhjen e konflikteve që i kanë lënë prapa në integrim të dy shtetet.

Kjo është thënë në konferencën “Dhomat e Specializuara të Kosovës: Një ndryshues i lojës politike apo një gjykatë tjetër ‘drejt shuarjes’”, që u organizua nga Instituti për Integritet Evropian, Qendra Grotius dhe UBT.

Për të diskutuar mbi rolin e Gjykatës Speciale, mënyrën e formimit, natyrën e vendimeve dhe të ardhmen e dy shteteve drejt integritetit evropian, mendimin e tyre

në cilësinë e njohësve të çështjes, e kanë dhënë lideri i Vetëvendosjes, Albin Kurti, udhëheqësi i panelit, Medlir Mema, lexuesi në Marrëdhënie Ndërkombëtare, Aidan Hehir, kërkuesja shkencore në Institutin e Kriminologjisë në Leuven, Furtuna Sheremeti, hulumtuesi i asociuar, Mathias Holvoet dhe asistenti në RIT Kosovo, Robert Muharremi.

Sipas tyre, për të arritur këtë duhet kaluar nëpër një tranzicion të suksesshëm, duhet pasur mekanizëm që mbështetet nga njerëzit dhe qeveria, ndërkaq gjykatat duhet të jetë transparente, llogaridhënëse gjatë këtij procesi. Ky është forumi i tretë i organizuar nga Instituti për Integritet Evropian, Qendra Grotius dhe UBT.



Forumi me temë: “Mbrojtja, siguria dhe shëndeti në punë në sektorin e ndërtimit në Kosovë”

Mungesë e inspektorëve dhe gjendje jo e mirë në sigurinë e punëtorëve të ndërtimit



Në prani të përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, ekspertëve, profesorëve dhe studentëve, në UBT, është mbajtur forumi me temë: “Mbrojtja, siguria dhe shëndeti në punë në sektorin e ndërtimit në Kosovë”, organizuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Ndërtimore dhe Infrastrukturës,

në UBT.

Forumi është organizuar si rezultat i nivelit të ulët të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë në sektorin e ndërtimit, ku si pasojë, vetëm gjatë vitit 2018 kanë humbur jetën 6 punëtorë dhe 33 të tjerë janë lënduar në vendin e punës.

Zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës, Rexhep Kadriu, tha se është e vështirë monitorimi i gjendjes së sigurisë së punëtorëve të ndërtimit në Kosovë, pasi sipas tij, ka mungesë të inspektorëve në gjithë territorin e vendit.

Kadriu tha se në aspektin legjislativ, punëtorët në Kosovë mbrohen me Ligjin për Siguri në Punë, për Mbrojtjen e Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientin e Punës, andaj, sipas tij, punëdhënësi është i detyruar t'i sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë, me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës dhe e shëndetit.

“Duhet të punohet shumë, nëse harxhohen milionat për fushata elektorale është më mirë që të harxhohen në sensibilizimin e punëtorëve në punë, sepse kemi vdekje dhe lëndime dhe punëtorët mund të jenë familjarë tanë dhe t'i ruajmë njerëzit se janë njerëzit tanë”, ka thënë Kadriu.

Agim Mullaku, përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Përgjegjës për Punë dhe Siguri, bëri të ditur se në sektori i ndërtimit identifikohet me numrin më të madh të aksidenteve të cilat ndodhin nga rënia e lartësisë.

Sipas tij, kompanitë duhet të investojnë në sigurinë në punë dhe të marrin masa për parandalimin e masave për rreziqet në punë. “Punëtorët paraprakisht duhet të jenë të njohur me të gjitha burimet e mundshme potenciale që mund të rrezikojmë shëndetin në

vendin e punës e këtu mund të jenë ngarkeza, mbajtëset, hapësira e pambuluar, koncentrimi etj”, tha Mullaku.

Dekani i Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Infrastrukturës, në UBT, Muhamet Ahmeti tregoi se institucioni po punon që të përgatisë kuadro profesionale dhe të gatshme për punë.

Ai tha se në kuadër të plan programit të fakultetit zhvillohen lëndët për siguri dhe shëndet në punë, kjo me qëllim të evitimit të problemeve dhe rreziqeve në punë.

“Si fakultet së shpejti do të krijojmë një doracak ku atë do t'ua japim dhe do të jetë në dispozicion për çdo punëtor dhe për kompanitë ku ne të tregohen të gjitha pikat kyçe më të këqija ku e tregojnë më së miri rrezikun në punë”, beri të ditur Ahmeti.

Ndërsa, Safet Ymeri nga Qendra e Trajnimeve të KEK-ut, tha se në KEK janë zvogëluar dukshëm aksidentet dhe vdekjet në vendin e punës.

“Tani në kohën e fundit në 5 vitet e fundit nuk kemi pasur vdekje aksidentale dhe lëndimet e punëtorëve janë zvogëluar dukshëm”, tha Ymeri.

Në kuadër të këtij forumi janë prezantuar edhe hulumtimet: “Vlerësimi i mbrojtjes, sigurisë dhe shëndeti në punë në sektorin e ndërtimit”, prezantuar nga prof. Hazir Çadraku, dhe “Menaxhimi i shëndetit dhe sigurisë në Industrinë e Ndërtimit”, prezantuar nga prof. Driton Kryeziu.

Ligjërata tematike

Leibovich Avital mban ligjërata tematike për studentët e UBT-së

Drejtoresha e American Jewish Committee në Jerusalem Leibovich Avital, ka qëndruar për herë të parë në Kosovë, me ç'rast zgjodhi UBT-në për të dhënë një ligjërata tematike për studentët të institucionit.

Tema që ajo e trajtoi, “Sfidat strategjike të Izraelit”, ngjalli interes të madh tek studentët, të cilët u informuan jo vetëm për sfidat e Izraelit, por edhe të shteteve që e kufizojnë, duke e vënë në fokus përballjen e tyre me terrorizmin.

Rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi tha se është shumë e rëndësishme që studentët të marrin informacione mbi tematike të tilla, veçanë-

risht nga njerëz profesionistë.

“Bota po përballet me probleme të shumta dhe ne vazhdimisht po servohe mi me informacione nga më të ndryshmet dhe më kontradiktoret, andaj është jetike që studentët tanë të marrin informacione nga njerëz kompetentë”, vlerësoi Hajrizi. American Jewish Committee, Avital Leibovich tregoi për studentët se jo vetëm Izraeli, por mbarë vendet në botë po përballet me sfida, të cilat në vija të trasha janë të ngjashme për të gjitha shtetet, por sipas saj, është e rëndësishme që në situata krize, vendet të gati për të ofruar ndihmë të çfarëdo lloji.

“Për vite më radhë, prejse ka filluar lufta në Siri, Iz-

raeli ka mbajtur të hapur kufijtë e vet për refugjatët sirianë, të cilëve u ka ofruar ushqim, strehim dhe ndihmë mjekësore. E tërë kjo edhe përkundër faktit që ne nuk kemi marrëdhënie të mira mes vete si shtete, por gjithmonë jetët e njerëzve vijnë në radhë të parë, tregoi ajo. Në fund të ligjërates, dhjetëra studentë drejtuan pyetje për Leibovich Avital, që kishin të bënin me sigurinë shtetërore të Izraelit, sigurinë në botë, nivelin e lirisë së mediave në Izrael, lirinë e shprehjes në vendin e saj, etj.



Punëtorja

Profesorët nga Ohio Northern University nisin punëtorinë mbi pedagogjinë ligjore

Profesorët nga Ohio Northern University, Howard Fenton dhe Kevin Hill, kanë nisur punëtorinë treditore për stafin dhe studentët e UBT-së, në lidhje me çështjen e pedagogjisë ligjore.

Një punëtori e tillë po mbahet për herë të parë në një institucion të arsimit të lartë në Kosovë. Dita e parë e punëtorisë nisi me ligjëratën e profesorit Kevin Hill, i cili trajtoi temën: “Teknikat dhe sfidat në të mësuarit dhe të nxënësve interaktiv”, ligjërimi për të cilën u parapri nga ndjekja e disa videove ilustruese mbi prezantimin sokratik dhe qasjen ndaj problemeve.

Pas ndjekjes së këtyre videove, profesori Hill mbajti një ushtrim interaktiv mësuesor mbi problemin e shfaqur me rastin e kujdestarisë për fëmijët ndërkombëtarë, me ç’rast edhe kërkoi në mënyrë të vazhdueshme mendimin e pjesëmarrësve mbi sfidat e Kosovës për natyrën e problemeve të tilla dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje në bazë të ligjeve ekzistuese të vendit tonë.

Profesori Kevin Hill tregoi se në universitetin

e tyre, studentët nuk mësojnë vetëm pjesën teorike të materialeve të dhëna, por edhe mësohen që të njëjtin material ta shfrytëzojnë edhe në praktikë dhe që përmes tyre të bëjnë zgjidhjen e problemeve ligjore për të cilat flitet në materiale.

“Është detyrë e profesorit që të përcaktojë se cila është teknika e duhur që duhet të përdoret për klasën, lëndën dhe temën e caktuar, si dhe që përshtatet me personalitetin e profesorit”, tha ai.

Në pjesën tjetër të ditës së parë të punëtorisë, profesorët Hill dhe Fenton ligjëruan mbi teknikat dhe objektivat e të mësuarit interaktiv. Konkretisht, ata trajtuan çështjen e të zhvilluarit të aftësive të të menduarit kritik përmes qasjeve të ndryshme të të mësuarit, dialogut sokratik, prezantimit, teknologjisë së përdorur dhe përcaktimit të teknikave të shfrytëzuara. Ndërkaq, në fund u trajtuan edhe mënyrat e duhura të motivimit të studentëve.

Punëtorja do të zhvillojë punimet edhe gjatë ditës së nesërme, teksa të njëjtës do i bashkëngjiten edhe studentët.



UBT dhe Universiteti i Tartu-së bashkëpunojnë në projektin “DIMTV”

Zhvillimi dhe Implementimi i Multimedias dhe Televizionit Digjital (DIMTV) është një nga projektet madhore të Bashkimit Evropian, konkretisht programit Erasmus, pjesë e të cilit është edhe UBT-ja si partner dhe lider në fushën e teknologjisë dhe inovacionit.

Në kuadër të këtij projekti që financohet dhe mbështetet nga Erasmus+, një delegacion nga UBT-ja, i përbërë nga profesori Blerton Abazi dhe Besnik Qehaja, kanë realizuar vizitë pune në Estoni, konkretisht në Universitetin dhe Institutin e Tartu-së.

Ata kanë ndjekur trajnime në fushën e përpunimit të imazhit dhe aplikimit të vizionit kompjuterik, teksa janë njoftuar edhe me shumë projekte praktike të këtyre fushave që studentët dhe profesorët në Estoni i realizojnë së bashku.

Me këtë rast, profesorët Abazi e Qehaja treguan për përkushtimin dhe gatishmërinë që projektet e kësaj natyre të gjejnë zbatim edhe në UBT, pasi që nën ombrellën e institucionit është themeluar UBT TV, i licencuar nga KPM-ja, i cili do të transmetojë çështje të shkencës, inovacionit, tema që lidhen me studimet e studentëve, me aktivitete që zhvillohen brenda UBT-së, si dhe do të paraqiten video rrëfime suksese të studentëve. DIMTV është projekt që ka të bëjë me zhvillimin e programeve dhe moduleve të reja në fushën e multimedias dhe televizionit digjital, teksa falë këtij projekti UBT do të pajiset me një laborator të dedikuar fushës së multimedias, i cili do të themelohet gjatë vitit akademik 2018-2019.



Qendra MVPT informon dhe sensibilizon studentët e UBT-së për dukurinë e trafikimit me qenie njerëzore

Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore, “Mbroj Viktimat, Parandalo Trafikimin”, ka realizuar sesionin e parë informues me studentët e UBT-së.

Ky aktivitet është mbajtur në kuadër të projektit “Lëvizja Përpara”, përkrahur financiarisht nga zyra e BE-së në Kosovë.

Përmes këtij sesioni studentët patën mundësi të sensibilizohen dhe të debatojnë rreth dukurisë së trafikimit me qenie njerëzore, teksa udhëheqësit e organizatës i informuan edhe për qendrat dhe strehimoret të cilat veprojnë dhe u dalin në ndihmë viktimave të trafikimit në Kosovë. Të njëjtës, po

ashtu, sqaruan edhe nivelet e rrezikshmërisë me të cilat përballen viktimat, në raport me trafikuesit e tyre.

Panelistë në këtë sesion ishin zv.drejtoresha e MVPT-së, Teuta Abrashi, koordinatoreja e Qendrës Rehabilituese në këtë organizatë, Lulëjete Prekazi, menaxherja e projektit, Gresa Kelmendi dhe përfaqësuesi nga Drejtoria për Hetimin e Trafikimit me qenie njerëzore nga Policia e Kosovës, Naim Raci.

Zv. drejtoresha e MVPT-së, Teuta Abrashi tregoi se në Kosovë veprojnë tri strehimore, në të cilat strehohen viktimat që kanë qenë të trafikuar, ose që janë në rrezik për t’u përballur me një dukuri të tillë.

“Pasi të përballen me një dukuri të tillë, ne mundohemi që t’i risistemojmë viktimat përmes programeve ditore dhe rezidenciale, që kanë për qëllim mbështetjen dhe ofrimin e procedurave për riintegrim”, tha ajo.

Informata shtesë mbi këtë dukuri, përhapja e së cilës rrezikon stabilitetin e një shoqërie të shëndetshme, dhanë edhe panelistët e tjerë që morën pjesë në këtë sesion informues.

Ky aktivitet i mbajtur nga organizata “MVPT” është organizuar në muajin tetor, që ndërkombëtarisht njihet si muaji për luftim të dukurisë së trafikimit të qenieve njerëzore.

Studenti i UBT-së, Dorian Abdullahu lanson lojë për “App Store”

Studenti i Fakultetit Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Dorian Abdullahu, ka lansuar lojën “Can’t tap this”, lojë kjo e cila funksionon në mënyrë shumë të veçantë.

Abdullahu ka treguar se loja fillon me 15 sekonda dhe brenda kësaj kohe duhet të klikuar topin e bardhë. Ai tha se në këtë lojë lëvizja duhet të bëhet nonstop nëpër ekran dhe çdo pesë klikime të realizuara shtohen sekondat nga vetë loja.

Studenti Abdullahu ka thënë se nga mësimet e vazhdueshme dhe njohuritë e fituara në UBT ka arritur që të lansojë lojë për sistemin iOS.

Ky aplikacion nuk është i vetmi që studenti ka lansuar, pasi ai ka realizuar edhe disa projekte e aplikacione të tjera.

“Për të lansuar këtë lojë më është dashur një muaj kohë, teksa si projekt është pëlqyer

shumë sepse në ditën e publikimit ka hyrë në top 10 lojërat më të shkarkuara në App Store. Ky projekt sigurisht është realizuar falë njohurive dhe mundësive që i kam përfituar nga UBT-ja”, ka thënë ai.

Tutje, Abdullahu bëri të ditur se shumë shpejt loja do të mund të shkarkohet nga përdoruesit në sistemin Android.

Fakulteti Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri, si dhe Fakulteti Sistemet e Informacionit, janë programe nga të cilat diplomohen studentë të suksesshëm në fushën e teknologjisë dhe inovacionit. Ata ende pa i përfunduar studimet themelore arrijnë të bëhen pjesë e tregut vendor e ndërkombëtar të punës.

Konferenca për siguri kibernetike dhe privatësi

Siguria kibernetike dhe privatësia sfidë për Kosovën, rekomandohet që institucionet të veprojnë bashkërisht



Në kuadër të Muajit Ndërkombëtar të Sigurisë Kibernetike, ka zhvilluar sot punimet konferenca për siguri kibernetike dhe privatësi “Sfidat në hapësirën kibernetike”, në bashkëorganizim me Cyber Security and Privacy dhe UBT-së.

Në këtë konferencë mori pjesë ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, ku veç tjerash, tha se do ta fusin në zhargon të përditshëm termin e ekonomisë digjitale.

Ministri Beqaj theksoi rëndësinë e kësaj teme në ndryshimet globale e ekonomike, derisa vlerësoi se siguria kibernetike është e rëndësishme për institucionet, komunitetin dhe sektorin privat për të garantuar një zhvillim të shëndoshë.

“Kjo teknologji nuk paraqitet si harduer apo softuer, inovacionet po rrisin produktivitetin në përditshmëri dhe lidhen me krijimin e vendeve të punës dhe qëndrimin e të rinjve në vendin tonë. Janë duke humbur vendet e punës në sektor, po zhduken disa sektor, po lindin sektor të rinj që bëjnë aftësi të reja dhe japin hapësira të reja. Ekonomia po rritet shpejt, vendet e punës në teknologji po rriten dhe gatishmëria institucionale ende nuk është në nivelin që ne jemi duke e prituri”, është shprehur Beqaj.

Duke folur për digjitalizimin dhe sigurinë kibernetike, rektori i UBT-së, prof. dr Edmond Hajrizi ka thënë se institucioni që ai drejton është model në këtë aspekt, ngaqë është institucioni i parë arsimor që ka laboratorët e sigurisë dhe ka të krijuar CERT-in,

që është i akredituar dhe anëtarësuar në organizatat më të mëdha, siç është organizata FIRST.

Rektori Hajrizi theksoi se kjo është një qasje pozitive sepse përmes aktiviteteve të tilla vendi jonë është në hap me trendët falë potencialit që ekziston. Tutje, Hajrizi tha se, UBT është institucioni më i madh në vend e rajon për përgatitjen e profesionistëve të fushës së sigurisë dhe privatësisë.

“UBT ka të formuar divizionin UBT CERT dhe ekipin e ekspertëve të sigurisë kibernetike, që do të jenë të gatshëm në përbashkëti, trajtim, analizë dhe dhënie të rekomandimeve për incidentet, rastet e sigurisë kibernetike për sektorin akademik, privat dhe publik. UBT gjithnjë është angazhuar që të nxjerrë kuadro profesionale, por theksohet nevoja e angazhimit të institucioneve shtetërore në hartimin e politikave të përbashkëta në këtë aspekt”, theksoi rektori Hajrizi.

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Emin Mehmeti tregoi se shqetësues është fakti që viteve të fundit është shtuar rreziku i hakimit të të dhënave, derisa bëri të ditur se BQK-ja është e angazhuar maksimalisht në ruajtjen e të dhënave të qytetarëve.

“Siguria kibernetike është objektivi kryesor i sistemit financiar të Bankës Qendrore të Kosovës. Ne e kemi marrë seriozisht sigurinë kibernetike dhe kemi investuar që sistemi jonë dhe informatat që ruhen aty të jenë sa më të sigurta. Po ashtu, në jemi duke investuar dhe do të blihen pajisje që ruhen këto të dhëna”, deklaroi ai.

Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, tha se këto procese janë sfidë që duhet të tejkalohen dhe se për këtë qëllim sipas tij, institucionet duhet të veprojnë bashkërisht. Sokol Vladi, drejtor i Microsoft në Shqipëri, bëri të ditur se privatësia dhe siguria kibernetike është shndërruar në sfidë globale, andaj rekomandoi bashkëpunim në mënyrë që ato të parandalohen.

Kujtim Gashi, nga Agjencia e Shqipërisë së Informacionit (ASHI), brenda Ministrisë së Administratës Publike, tha se institucionet arsimore janë ato të cilat mund të ndihmojnë më së shumti në këtë aspekt, derisa theksoi se Kosova si shtet në konsolidim e sipër ka vënë në prioritet teknologjinë informative.

Teuta Zymberi nga FIT, ka rekomanduar që të ndalohet qasja në internet e fëmijëve dhe tha se detyrë e çdo prindi është që ta kontrollojë se cilat adresa në internet i viziton fëmija i tij.

Hana Qerimi, nga Shkolla Digjitale, veç tjerash, tha se duhet të këshillohen fëmijët në aspektin e sigurisë kibernetike, kjo si rezultat i revolucionit digjital që ka prekur çdo sferë të jetës në botën moderne.

Në fund profesori i UP-së, Blerim Rexha ka paraqitur dhe demonstruar sfidat në hapësirën kibernetike në aspektin e edukimit.

Konferenca “Sfidat në hapësirën kibernetike”, u organizua në partneritet me UBT-në, me qëllim që të ngritet në diskutim çështja e rëndësinë së sigurisë dhe privatësisë.



Studenti i UBT-së lehtëson pajisjen me patentë shofer

Të interesuarit për pajisje me patentë shofer, tash e tutje do ta kenë shumë më lehtë të mësojnë në këtë fushë, për faktin se një student i Fakultetit të Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, ka arritur që në mënyrë elektronike t'i grumbullojë të gjitha llojet e të dhënave në një aplikacion të vetëm.

Studenti Alban Sahiti, njëherësh bashkëthemelues i kompanisë “TENTON” për zhvillim dhe programim të softuerëve, aplikacioneve mobile dhe ueb faqeve të ndryshme, për kompani dhe institucione brenda e jashtë Kosovës, ka zhvilluar një aplikacion për t'u ofruar ndihmë shoferëve të rinj, në të cilin përfshihen teste elektronike, literaturë e nevojshme, ilustrime me video për mënyrën e sjelljes në komunikacion, dokumentet e nevojshme për regjistrimin e lejes, si dhe gjetjen e autoshkollave nëpër të gjitha qytetet e Kosovës.

Duke treguar për synimet e tij, Sahiti theksoi se aplikacioni “Autoshkolla” është dizajnuar me qëllim që të lehtësojë procedurat dhe metodën e të mësuarit nga shfrytëzuesit.

“Qëllimi i aplikacionit është që përmes një dizajni atraktiv dhe lehtësisht të pranueshëm, shoferët e rinj të përgatiten për pjesën teorike të marrjes së patentë shoferit. Të njëjtin po mundohem ta zhvilloj edhe për Shqipëri dhe për vendet e tjera të rajonit”, the ai, teksa tregoi që ky aplikacion mund të shkarkohet dhe të shfrytëzohet nga të gjithë njerëzit që përdorin llojet e telefonave të mençur, Android dhe iOS.

Në UBT ndodhet shkolla më e madhe për shkencë kompjuterike, ku studiohet në bazë të metodave më të sofistikuar dhe udhëhiqet nga një staf akademik i kualifikuar dhe profesionalisht i përgatitur.

Linqet për shkarkim të aplikacionit: për Android dhe iOS:

<https://itunes.apple.com/app/id1193245391>

<https://play.google.com/store/apps/details...>

Studentët e UBT-së, falë Programit “Erasmus +” vazhdojnë studimet në universitetet evropiane

Studentja Syzana vazhdon studimet në Universitetin Nova de Lisboa

Studentja e vitit të tretë në Fakultetin e Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, Syzana Kajtajaz, është përfutuese e bursës që ndahet nga Programi Erasmus+ International Credit, për studentët kosovarë. Kajtazi është duke vazhduar studimet në Universitetin Nova de Lisboa, të Portugalisë.

Studentja Kajtajaz tha se përzgjedhja e saj në mesin e shumë studentëve të tjerë që kishin aplikuar, është rezultat i punës dhe përkushtimit të përbashkët të saj dhe profesorëve të UBT-së.

“Suksesi im është fryt i punës dhe përkushtimit tim, si dhe angazhimit të vazhdueshëm të profesorëve, për të ndërtuar studentë dhe profesionistë në aspektin akademik”, theksoi ajo dhe shtoi se UBT i përkrahë studentët e përkushtuar, që kanë potencial, përmes bursave.

“Pastaj përfitojnë mundësinë për studime jashtë vendit, për praktika dhe vende të reja të punës etj”, theksoi ajo.

Duke treguar për përvojën e marrë gjatë muajve sa po studion në Universitetin NOVA, kjo studente vlerësoi se ka arritur të përmirësohet në aspektin profesional dhe në atë

komunikues.

“Studimi në këtë universitet më ka bërë ta shoh veten se sa jam e aftë dhe se në cilat pika duhet të përmirësohem në aspektin akademik, ndërkaq falë kësaj përvoje, jam bërë më e hapur në komunikim me të tjerët”.

Muajt në vijim, Kajtajaz planifikon të kthehet në UBT, për të përfunduar studimet e nivelit bachelor, si dhe për të vazhduar me tutorim në lëndën e matematikës, punë të cilën e kishte bërë para se të shkonte në Portugali.

UBT mbajti ceremoninë e diplomimit për vitin akademik 2017/2018



Në një ceremoni madhështore të organizuar në sallën “1 Tetori”, në Prishtinë, mbi 700 studentë të nivelit bachelor e master kanë marrë pjesë në ceremoninë e graduimit për vitin akademik

Gjatë kësaj ceremonie madhështore, dhjetëra profesorë të UBT-së dhe mijëra prindër kishin ardhur për t'i kurorëzuar sukseset e fëmijëve të tyre, derisa të pranishëm kishte edhe mysafirë të shumtë nga Kosova e ndërkombëtarë.

Me këtë rast, rektori i UBT-së, prof.dr Edmond Hajrizi, me theks të veçantë i ka falënderuar studentët që kanë zgjedhur UBT-në për përfundimin e studimeve të nivelit universitar, teksa i uroi ata për suksesin e përbashkët të arritur.

“Ju zgjodhët drejtimet unike që ofron ky institucion, vlerat kulminante të programeve akademike, prestigjin ndërkombëtar të tij, rrugën e trasuar suksesshëm në të gjitha fushat nga drejtuesit, profesorët vendorë e ndërkombëtarë, studentët tanë”, theksoi rektori Hajrizi.

Tutje, ai tha se studentët e diplomuar tashmë janë ambasadorë dhe përfaqësuesit më të mirë të UBT-së dhe shtetit të Kosovës.

“Sot, ne jemi të lumtur që, në përmbyllje të studimeve tuaja, të themi me plotë të dretë që ju jeni profesionistët e së ardhmes. Të gatshëm për të dalë të tregun e punës, për

t'u bërë kolegë më shumë ish-studentët tanë, me të cilët kemi të drejtë të krenohemi dhe krenohemi gjithnjë. Ju them pa frikë se do ta keni vështirë të shkoni në ndonjë institucion, fakultet, ndërmarrje, kompani e të mos gjeni aty ish-studentë të UBT-së. Ndaj jam i sigurt që, kudo që shkoni do ta përfaqësoni në mënyrën më të denjë UBT-në”, ka thënë Hajrizi.

“Brenda këtyre tre viteve të studimeve ju u bëtë pjesë e familjes së madhe të UBT-së. Institucionit që mbushi 17 vite pune akademike, duke qenë: Sinonim i cilësisë, novatorizmit, ndërkombëtarizimit, hulumtimit dhe sinonim i suksesit”, shtoi rektori Hajrizi, duke iu drejtuar studentëve.

Felix Breitenesker, profesor nga Universiteti për Teknologji i Vjenës, si dhe profesori i Universitetit “Patras” nga Greqia, kanë uruar gjeneratën për sukseset dhe thanë se ndjehen të emocionuar dhe të mrekulluar nga ajo që ka panë gjatë kësaj ceremoninë.

Ata thanë se studentët të cilët po gradohen sot fillon një kapitull i ri, teksa porositën studentët që ta sfidojnë dhe ta gjejnë vetën edhe në tregun e punës.

Në vijim studentët kanë dhënë betimin akademik dhe janë pajisur me certifikata, kurse në fund të ceremonisë, studentët kanë hedhur kapelat studentore, e cila është një traditë në këso ngjarjesh,

Studenti i UBT-së, Emin Emini ligjërues në aktivitetin “Girls Coding Kosova”

Studenti i Fakultetit Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Emin Emini me ftesë të organizatorëve ka marrë pjesë si folës në aktivitetin “Girls Coding Kosova”, organizuar nga Organizata për Fuqizimin e Grave në Teknologji dhe Inovatorët e Arsimit të Kosovës (EIK), aktiviteti i cili është mbajtur në Mitrovicë.

Ai ka trajtuar temën “Formula e Suksesit”, ku tha se ndjekja e arsimit të lartë në fushën e teknologjisë dhe disiplinave të lidhura me të do të rriste potencialin që gratë të ishin të suksesshme në industrinë e IT-së.

Studenti Emini ka thënë se janë të shumta rastet kur gratë heqin dorë nga karriera e tyre sepse nuk i ofrohet inkurajim

ose mbështetja e duhur dhe shpesh atyre u imponohet që të ndjekin studimet për një profesion më të lehtë, siç thuhet, që i përshtat një gruajë. Por, ai konsideron që për të pasur sukses fillimisht duhet të zgjedhësh profesionin e ëndrrave, të besosh, ta duash dhe të punosh në atë drejtim.

“Për të parë se sa e civilizuar është një kulturë, atëherë duhet të shikohet se si ata i trajtojnë gratë e tyre”, theksoi Emini.

“Girls Coding Kosova” është mision që synon të inkurajojë gratë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë akademik dhe profesional në fushat teknike. GCK po punon vazhdimisht në inkurajimin e grave që të kodojnë, të nisin kompanitë ose të punojnë si zhvillues.



Studenti i UBT-së, Flon Sylejmani i punësuar në Bankën TEB

Studenti i Fakultetit Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Flon Sylejmani, i cili është në përfundim të studimeve të nivelit bachelor, është punësuar në Bankën “TEB”, në Prishtinë.

Për rreth një vit, ai është duke punuar në departamentin e IT-së në këtë bankë, konkretisht merret me pjesën e zhvillimeve të softuerëve/aplikacioneve, përfshirë marrjen e

kërkesave, analizimin, zhvillimin, si dhe vendosjen në përdorim të softuerëve.

Veç tjerash, ai merret edhe me produktet për shërbime bankare online E-banking dhe Mobile Banking.

Studenti Sylejmani ka theksuar se UBT është institucioni që ka ndikuar për një fillim të mbarë të karrierës së tij.

“E veçantë e studimeve në UBT është se i përgatit studentët

për tregun e punës. Organizimi dhe metodat e ofruara për studime në UBT janë të përditësuara me nevojat aktuale që kërkohen në fushën e teknologjisë”, vlerësoi ai.

Duke folur mbi rrjedhën e punës, Sylejmani tha se është i lumtur që arriti të bëhet pjesë e tregut të punës ende pa i përfunduar studimet themelore.

Studenti i UBT-së, Ermal Bujupaj është punësuar në kompaninë “OpenResearch”, me seli në Vjenë



Studenti i Fakultetit Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Ermal Bujupaj, i cili është në përfundim të studimeve të nivelit bachelor, është punësuar në kompaninë “OpenResearch”, me seli në Vjenë.

Në këtë kompani ai mbanë pozitën e IOS Developer dhe zhvillon aplikacione për këtë platformë, teksa gjitha projektet e kompanisë janë të destinuara për tregun ndërkombëtar.

Paraprakisht Bujupaj kishte punuar edhe projekte për kompani amerikane dhe këtë sukses ai ia atribuoi UBT-së, pasi sipas tij, institucioni i ka ndihmuar shumë në aftësim profesional.

Ai tha se përkrahja dhe motivi nga profesorët, bëri që t'i arrijë qëllimet e tij.

“Ndërlidhja e teorisë dhe praktikës gjatë studi-

meve ka qenë mjaft e rëndësishme dhe me përparësi, pasi që ka qenë me lehtë të kyçem në tregun e punës”, theksoi ai.

Ndërkaq, Bujupaj duke i adresuar të gjithë të rinjtë që të studiojnë në UBT, vlerësoi se institucioni në të cilin ai studioi dhe vendi në të cilin aktualisht është duke punuar, kanë ndikuar për një fillim të mbarë për karrierën e tij. “UBT ka programe unike dhe në hap me universitetet ndërkombëtare, si dhe falë partneriteteve të shumta ne kemi mundësinë që të vazhdojmë studimet edhe jashtë vendit. Konsideroj që aktualisht UBT është institucioni më profesional i arsimit të lartë në Kosovë”, potencoi Bujupaj.

Rrëfime suksesi

Studenti i UBT-së zhvillon aplikacion për informim mbi linjat e autobusëve në Kosovë

Studenti i Fakultetit të Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë, Urim Haxhiu ka krijuar një aplikacion të quajtur “Autobusët Kosovë”, që do të shërbejë për informimin e qytetarëve për kohën e udhëtimit të linjave të autobusëve në gjithë Kosovën.

Momentalisht, aplikacioni ndodhet në Google Play Store dhe është funksional për tërë territorin e Kosovës, ndërkaq ideja për krijimin e tij ka ardhur duke e parë nevojën e madhe të qytetarëve për t’u informuar saktë dhe në kohë mbi të gjitha linjat e autobusëve.

“Ideja për këtë aplikacion lindi për shkak të kërkesave të mëdha sepse qytetarët shpesh nuk janë të informuar rreth


orareve të udhëtimeve. Për krijimin e këtij aplikacioni kam pasur mbështetje edhe nga profesorët e UBT-së”, tregoi Urimi.

Ai shpreston se në të ardhmen të ketë bashkëpunim me të gjitha kompanitë e linjave të autobusëve, në mënyrë që udhëtarët e tyre të jenë më të informuar për kohën e udhëtimeve.

Ky aplikacion është një ndër të shumtë që Urimi ka zhvilluar përgjatë tri viteve të studimit në UBT, mirëpo ky aplikacion është njeri ndër më të suksesshmit deri tani dhe është pritur shumë mirë nga të gjithë përdoruesit.



Studenti i UBT-së, Ndrec Zefaj i punësuar në Agjencionin për Financim në Kosovë



Ndrec Zefaj po vijon suksesshëm studimet e nivelit master në Fakultetin Politika Publike dhe Menaxhment në UBT. Aktualisht ai është i punësuar në Agjencionin për Financim në Kosovë, dega në Klinë, si dhe mban pozitën e analistit kreditor.

Studenti Zefaj theksoi se kishte vendosur të vazhdonte studimet master në UBT, pasi sipas tij, institucioni ka prioritet studentët dhe ka staf akademik profesional.

Tutje, ai vlerësoi se UBT ka qenë dhe mbetet lider i arsimit të lartë në Kosovë dhe rajon, andaj për këtë arsye tha se ia ka besuar karrierën dhe të ardhmen këtij institucioni.

“UBT ofron cilësi në aspektin akademik, cilësi që nuk

mund ta gesh në institucionet tjera arsimore në vendin tonë. Profesorët tanë vijnë nga universitetet prestigjioze dhe dijet e njohuritë e tyre i transmetojnë te ne”, tha Zefaj.

Zefaj theksoi se institucioni po e ndihmon të bëhet profesionist në profesionin që ai ka zgjedhur.

“Profesionistët e politikave publike janë profesion deficitar në Kosovë. UBT na ka ofruar një mundësi të tillë, të cilën mundësi ne si studentë e shohim si shumë të vlefshme dhe e cila po na ndihmon të kyçemi me lehtë në tregun e punës”, tha ai. Studenti Zefaj tha se ka ndjekur edhe një numër të madh të trajnimeve me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit profesional.


Studenti i UBT-së, Rilind Beqaj i punësuar në kompaninë e Ujësjesit Regional “Prishtina”

Rilind Beqaj ka vijuar suksesshëm studimet e nivelit bachelor në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, e më vonë edhe studimet master në Fakultetin Politika Publike dhe Menaxhment në UBT.

Tash e një vit ai është bërë pjesë e kompanisë së Ujësjesit Regjional “Prishtina” dhe punon në departamentin e kontabilitetit dhe financave.

Veç studimeve, studentu Beqaj vijoi edhe shumë trajnime profesionale në fushën e ekonomisë dhe teknologjisë, në UBT, teksa aktualisht po vijon mësimet në vitin e dytë edhe në Shoqatën e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës “SCAAK”.

Duke treguar mbi rëndësinë e përfundimit të studimeve, studentu Beqaj ka theksuar se UBT është dëshmuar më së miri përmes suksesit të studentëve të vet, të cilët gjeneratë pas gjeneratë po punësohen nëpër kompani publike dhe private. “UBT për dallim nga institucionet tjera, gjithnjë ka nivel të lartë të cilësisë akademike, përvoja gjithëpërfshirëse ndërkombëtare dhe ka ndërlidhje e mirë të pjesës akademike me praktikën nga industria. Studimet në UBT janë të krahasueshme me studimet e nivelit ndërkombëtar”, vlerësoi Beqaj.



Studenti i UBT-së, Kujtim Kurmehaj është punësuar si arkitekt në byronë projektuese “A2 – Engineering”

Studenti i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Kujtim Kurmehaj është punësuar në byronë projektuese “A2 – Engineering”, me seli në Prishtinë, në të cilën ai është i angazhuar si arkitekt i ri, duke u inkuadruar në projektimin dhe ideimin e projekteve të shumta ndërtime.

Para punësimit në “A2 – Engineering”, studentu Kurmehaj ka marrë përvojë edhe gjatë kohës sa ka punuar në kompaninë ndërtimore “InfraPlus”, si dhe ka realizuar një mori projektesh individuale.

Ai tha se ka arritur të integrohet në tregun e punës falë njohurive të marra në UBT, andaj vlerëso

se institucioni ka merita të mëdha për sukseset e tij në këtë profesion. “Programi i Arkitekturës në UBT, ka qenë i përbërë nga një staf shumë profesional në punën e tyre, ku prej tyre kam mësuar për projektim, bazat e dizajnit arkitektonik etj., dhe jam përgatitur për punë, si dhe për avancim në karrierë”, është shprehur Kurmehaj.

Tutje, Kurmehaj theksoi se Fakulteti i Arkitekturës në UBT, është njëri ndër më të mëdhenjtë në Kosovë e rajon, nga i cili studentët dalin të përgatitur dhe me njohuri të mjaftueshme për të siguruar vende pune menjëherë pas përfundimit të studimeve bazike, madje në të shumtën e rasteve,

edhe më herët.

“UBT ka programe unike dhe në hap me universitetet ndërkombëtare, si dhe falë partneriteteve të shumta ne kemi mundësinë që të vazhdojmë studimet edhe jashtë vendit. Konsideroj që aktualisht UBT është institucioni më profesional i arsimit të lartë në Kosovë”, potencoi ai.

Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT është program që ofron njohuri dhe përgatitë ekspertë në fushën e arkitekturës. Përbëhet nga stafi akademik prej ekspertëve vendorë e ndërkombëtare, të cilën kanë reputacion të vlerësuar në fushën e mësimdhënies dhe të humltimeve.



Rrëfime sukcesi

Studenti Mustafë Buzhala, inxhinier në Bechtel & Enka

Mustafë Buzhala është student i nivelit master në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, i cili tashmë ka filluar që profesionin e tij ta ushtrojë në mënyrën më profesionale të mundshme.

Ai tashmë është angazhuar si inxhinier në kompaninë e njohur, Bechtel & Enka, në departamentin e strukturës në Autostradën Prishtinë-Han Elez, ku ka përgjegjësi të bëjë kontrollimin e pozicioneve.

Ai tregoi se kjo autostradë është ndër projektet më të mëdha që ka zhvilluar shteti ynë, andaj edhe ndjehet me fat që në një projekt të tillë ka pasur mundësi t'i ndjekë nga afër të gjitha punimet që janë bërë.

“Puna të cilën ne e bëjmë është shumë e rëndësishme për faktin se vetë rëndësia e projektit është shumë e madhe. Kjo rrugë do të bëjë lidhjen mes shtetit të Kosovës dhe Maqedonisë, ku përveç lehtësirave për qarkullim të qytetarëve të të dy shteteve, do të ketë ndikim edhe në zhvillimin e ekonomisë së tregut të lirë”, sqaroi Mustafa.


Ai sqaroi se angazhimi në Bechtel & Enka e ka bërë më të përgatitur profesionalisht, andaj nd-

jehet i lumtur që këtë angazhim ia mundësuan profesorët dhe kolegët në UBT.

“Është eksperiencë e mirë të përballësh me probleme nga më të ndryshmet nga fusha inxhinierike, kjo sepse mëson se si t'i qasësh atyre dhe se si të japësh zgjidhjen më të mirë të mundshme”, theksoi Mustafa.

Sipas tij, pa njohuritë akademike të fituar gjatë studimeve në UBT, vështirë se do të kishte këtë diapazon kaq të gjerë të informacioneve mbi profesionin e tij, dhe falë kësaj, ai konsideron se është i gatshëm për të nisur edhe studimet e doktoraturës.

Programi master në Inxhinieri të Ndërtimit dhe Infrastrukturës është më i madhi i kësaj fushe studimi në Kosovë dhe rajon, teksa pothuajse 100% e studentëve të këtij niveli janë të punësuar në tregun vendor dhe ndërkombëtar të punës, shumë prej të cilëve edhe kanë kryer punë praktike një mujore në kompaninë Bechtel & Enka.



Studentët, të dalluar në shumë fusha

Studenti i UBT-së, pjesëmarrës në OC Polimi Summer School, në Itali

Studenti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, në UBT, Benart Shala, ka marrë pjesë në OC Polimi Summer School, në Piacenza të Italisë, ku morën pjesë 120 studentë nga 25 shtete.

Përgjatë kësaj shkolle verore që zgjati 17 ditë, studentët u ndanë në tri grupe punuese, me ç'rast

tema e këtij viti ishte rivitalizimi i tri kazermave ushtarake në Piacenza, që bënë pjesë në kategorinë e Dizajnit Urban. Për zgjidhjen e ofruar, grupi i studentit Shala e mori titullin e grupit të dalluar dhe u shpërblye me 2000 euro.

Shkolla ishte e ndarë në tri pragje dhe në pragun e parë me fakultet vizituan Bienalen në Venecia, ku aty prezantuan secili grup, teksa studenti ynë ishte një ndër përfaqësuesit dhe prezantuesit e grupit të tij.

Përpos kësaj, gjatë shkollës u ofruan edhe ligjërata nga arkitektë të njohur botërorë, të cilët ndanë me studentët pjesëmarrës përvojat e tyre unike në fushën e arkitekturës.



Studentja Diellza Muzlijaj përfiton nga partneriteti i UBT-së me bankën ProCredit

Puna praktike për të cilën mori informata nga UBT, u shndërrua në njëerën ndër përvojat më të mira jetësore e profesionale për studenten e Fakultetit Juridik, Diellza Muzlijaj.

Ajo tashmë e ka përfunduar praktikën tremujore në ProCredit Bank, dega në Pejë, që i ka shërbyer për njohjen e profesionit të saj në një dimension tjetër, krahas njohjes edhe të një sektori bankar, siç është E-banking.

Për tërë këto njohuri të fituara, Diellza i është falënderuese UBT-së për partneritetin që ka me kompani e ndërmarrje të ndryshme, si dhe për faktin që i vë studentët në dijeni me kërkesat e tregut të punës.

“UBT ka pasur një rol shumë të madh në këtë pjesë dhe e falënderoj për mundësinë që na ka ofruar, pasi që kjo mundësi për praktikë erdhi si rezultat i bashkëpunimit të UBT-së me bankën ProCredit. Po ashtu, aftësitë e mia të treguara gjatë kësaj periudhe janë edhe si rezultat i njohurive që unë i kam fituar gjatë këtyre tri viteve studimi në UBT, e kjo më së miri u vërejt në qasjen dhe adaptimin tim të lehtë në procesin e punës”, vlerësoi ajo.

Porse, kjo përvojë i dha asaj edhe mësim për shumë gjëra për të cilat nuk ka pasur njohuri dhe të cilat tashmë i ka përvetësuar jashtëzakonisht mirë.

“Praktika në ProCredit Bank është njëra ndër përvojat më të mira që kam pasur dhe e cila më ka ndihmuar që të rritem profesionalisht. Kam mësuar se sa e rëndësishme është sjellja ndaj klientëve dhe ndaj stafit ku punojmë. Puna me një staf më të madh më ka bërë të fitoj njohuri nga fusha të ndryshme, të cilat do të më shërbejnë në të ardhmen”, u shpreh Diellza. Duke qenë studente në vitin e fundit të studimeve, tashmë fokusi i saj është vendosur në kryerjen e praktikave nëpër institucione të ndryshme.

Tashmë ajo menjëherë do të fillojë praktikën në Gjykatën Themelore në Pejë.



Rrëfime sukcesi

Studentja Drenusha Imeri fillon praktikën në “Ceni Company”



Studentja e Fakultetit Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor në UBT, Drenusha Imeri, tash e disa muaj ka filluar praktikën në kompaninë më të madhe ndërtimore në rajonin e Gjilanit, “Ceni Company”.

Kjo kompani i ka dhënë mundësi asaj të jetë pjesë e disa projekteve të rëndësishme që janë realizuar në Gjilan, përfshirë edhe objekte afariste-banesore dhe jo vetëm.

Studentja Imeri tha se UBT dhe profesorët, janë ata të cilët i kanë ofruar ndihmë profesionale që ajo të arrijnë tregun e punës.

“UBT është institucion që të bën profesionist të mirë,

pasi që institucioni ofron bashkëpunim në relacionin studentë-profesorë, ofron teknologjinë e fundit për studime dhe ka staf të kualifikuar. Gjitha këto mundësonjë që studentët e UBT-së të dalin gjithmonë të përgatitur profesionalisht”, vlerësoi Imeri.

Duke folur për të ardhmen, ajo tha se planifikon t’i vazhdojë studimet e nivelit master, me qëllim të aritjes së shkallës më të lartë të profesionalizmit.

Studentët e të gjitha fakulteteve në UBT, para dhe menjëherë pas përfundimit të studimeve themelore, lehtësisht qasen në tregun e punës vendor dhe ndërkombëtar, në institucione publike dhe private.

Studenti Nderim Bytyçi krijon versionin telefonik për portalin Unik

Studenti i vitit të dytë në Fakultetin e Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë, Nderim Bytyçi, ka krijuar versionin për telefon të portalit Unik, që synon të instalojë mendimin pozitiv në mendjen e shqiptarëve. Bytyçi ka krijuar aplikacionin për sistemin Android, me qëllim që i njëjti portal të bëhet i qasshëm edhe për përdoruesit e telefonave, duke qenë se teknologjia dhe mediat janë bërë pjesë e pandashme e përditshmërisë sonë.

Për njohuritë e marra në zhvillime të ueb-it, ai thotë se rol kryesor kanë luajtur studimet në UBT, ku edhe kanë fituar bazën e njohurive mbi mënyrën se si zhvil-

lohen aplikacionet.

“Zhvillimin e aplikacioneve nuk e konsideroj të jetë punë e vështirë pasi që mësimet e vazhdueshme të fituara në UBT e kanë thjeshtuar jashtëzakonisht shumë këtë proces”, tha studentin Bytyçi.

Në UBT gjendet shkolla më e madhe e shkencave kompjuterike në rajon, prej ku çdo vit dalin qindra studentë që me sukses të plotë arrijnë të integrohen në tregun e punës.



Studentja e UBT-së, Donjeta Duraj arkitekte në byronë “Motive”

Studentja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Donjeta Duraj, tash e dy vite është punësuar në byronë projektuese “Motive” në Gjilan, byro e cila është e njohur në vend për projekte dhe dizajne unike.

Studentja Duraj si arkitekte projektin objekte të ndryshme, si dhe bën dizajnimin e enterierit e eksterierit. Ajo tha se sukseset e arritura ia atribuon UBT-së dhe profesorëve të përgatitur në aspektin profesional.

“UBT është institucion i mundësive. Vlen të ceket se nga institucioni organizohen vizita studimore ku vizitojmë shumë shtete të botës për të parë arkitekturën ndërkombëtare, pastaj falë UBT-së unë kam konkurruar në Kompeticionin “Frozen Music” dhe kam qenë fituese e një çmimi”, tha Duraj.

“Partneriteti me shumë universitete në botë, si dhe njohja e diplomës ndërkombëtare është bënë UBT-në që të jetë institucioni më i mirë në rajon”, theksoi studentja Duraj.

Ajo pas përfundimit të studimeve të nivelit bachelor ka filluar edhe studimet master në UBT, ku po vazhdon ngritjen profesionale e akademike në fushën e arkitekturës.



UBT e ka shndërruar Leara Stavilecin në arkitekte profesionale, tash do të vazhdojë studimet në Universitetin e Anhalt-it

Ka përfunduar dhjetëra praktika brenda dhe jashtë vendit paralel me studimin që e ka bërë në UBT, ndërkaq tash është koha që studentja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Leara Stavileci të marrë një eksperiencë shumë më ndryshe, të cilën e ka ëndërruar prej kohësh.

Prej këtij viti akademik, ajo do të vazhdojë studimet në Anhalt University of Applied Sciences, falë bashkëpunimit të ngushtë që UBT e ka me këtë universitet të njohur gjerman. Ndonëse vlerëson se në UBT është përgatitur jashtëzakonisht shumë për këtë profesion, Leara tha se është ëndërr jetësore e saj që të vazhdojë ngritjen e mëtejme akademike atje ku është universiteti më i njohur dhe qendra e arkitekturës, sepse në të gjendet fakulteti i mirënjohur, “BAUHAUS”, i cili është krijuar nga grupi i arkitektëve më të njohur gjatë shekullit të kaluar.

“Planet për të ardhmen janë që t’i përfundoj së pari studimet me arritje të larta, e pastaj të kthehem në vendin tim dhe

të kontribuoj”, u shpreh ajo, teksa tregoi se procedurat për aplikim ishin shumë të thjeshta.

“Falë bashkëpunimit që ka UBT me Universitetin e Anhalt-it, procedurat për aplikim nuk ishin të vështira dhe më është njohur lehtësisht niveli paraprak i studimeve. Profesorët kanë qenë gjithmonë të gatshëm të më ndihmojnë në çdo aspekt gjatë studimeve dhe nuk ka munguar as tani ndihma e tyre. Ata gjithmonë më kanë dhënë motiv që të vazhdoj më tutje dhe të arrij suksese të mëtutjeshme”, sqaroi Leara.

Gjatë viteve të studimeve, ajo ka qenë aktive gjithmonë dhe ka përfunduar praktika e është punësuar nëpër kompani dhe institucione të njohura brenda dhe jashtë Kosovës.

Gjatë vitit të fundit të studimeve të nivelit bachelor, ajo ka punuar një vit në Komunën e Prishtinës, saktësisht në Zyren për Regjenerim Urban në Drejtorinë e Urbanizmit.



Rrëfime sukcesi

Studentja e UBT-së, Emira Halimi punësohet në kompaninë ndërkombëtare “Quipu”



Studentja e nivelit master në Fakultetin e Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë në UBT, Emira Halimi është punësuar kompaninë “Quipu”, me seli në Frankfurt të Gjermanisë, kompani kjo e konsulencës dhe zhvillimit të softuerit që ofron zgjidhje gjithëpërfshirëse për bankat dhe institucionet financiare.

Kjo kompani është pjesë e bankës ProCredit Group, ku aktualisht funksionon me tetë zyra rajonale anë e mbarë botës.

Studentja Halimi ka thënë se falë UBT-së dhe njohurive të fituara ajo ka arritur kyçet në tregun e punës dhe të jetë pjesë e kompanive të mëdha e prestigjioze ndërkombëtare.

“Në këtë kompani punoj si inxhinierë e monitorimit, dhe tashmë jam njoftuar me ambientet e punës, me sistemet me të cilat punohet etj. Quipu ofron zgjidhje uniforme për banka ProCredit dhe lehtëson centralizimin e shumë prej veprimtarive të saj”, ka thënë Halimi.

Ajo ka theksuar se institucioni i ka mundësuar të ngritet profesionalisht dhe të jetë pjesë e projekteve të shumta që janë zhvilluar në kuadër të institucionit.

Në UBT gjendet shkolla më e madhe e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë në Kosovë dhe rajon, që zhvillohet me standardet më të larta ndërkombëtare, prandaj diploma e UBT-së njihet edhe ndërkombëtarisht.

Studentja e UBT-së, Egzona Rexhepi arkitekthe në kompaninë “Archides & D&f”

Studentja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, Egzona Rexhepi tash e disa vite është punësuar në kompaninë “Archides & D&f”, ku në cilësinë e arkitektes projektton objekte të ndryshme, si dhe merret me dizajnin e enterierit dhe eksterierit.

Studentja Rexhepi tha se njohuritë e fituara në UBT dhe dashuria për profesionin, i kanë ndihmuar që të gjenerojë njohuritë profesionale, por edhe të fitojë vendin e saj të punës.

“UBT sigurisht që më ka ofruar shumë mundësi sepse gjatë studimeve në jemi njohur edhe me aspektin praktik të profesionit dhe si rezultat jemi përgatitur për tregun e punës. Po ashtu, gjitha njohuritë e fituara nga institucioni unë po i gjej në zbatim në punën që e bëj çdo ditë”, tregoi Rexhepi. Ajo pas përfundimit të studimeve të nivelit bachelor ka filluar edhe studimet master në UBT, ku po vazhdon ngritjen profesionale e akademike në fushën e arkitekturës.

Fakulteti i Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT është njëra ndër shkollat më të mëdha për arkitekturë në vend e rajon, teksa shumica e studentëve arrijnë të kyçen në tregun e punës ende pa i përfunduar studimet themelore.



Studentja Vildane Maliqi pranohet në Anhalt University

Studentja e nivelit master në Fakultetin e Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Vildane Maliqi është një nga dhjetëra studentët të UBT-së që falë bashkëpunimit të institucionit me Anhalt University of Applied Sciences, tashmë do të vazhdojë studimet në Gjermani.

Ajo tha se për pranim kishte vetëm procedura teknike dhe se ky proces ka qenë shumë i lehtë për faktin që diploma e UBT-së njihet ndërkombëtarisht.

“Stafi akademik dhe dekanati kanë qenë ndër shtytësit krye-

sorë të aplikimit tim në Gjermani, ata kanë iniciuar procesin dhe i kanë përkrahur të gjithë studentët që e kanë merituar për të vazhduar studimet atje”, u shpreh Vildanja.

Ajo vlerësoi se ka marrë vendimin më të duhur për vazhdim të studimeve në UBT, ndërkaq synimi i saj është që ciklin e studimeve ta vazhdojë edhe me doktoraturë.

“Kam zgjedhur UBT-në për shkak që i avancon ata të cilët e meritojnë dhe i përkrahë studentet që tregojnë aftësi dhe përkushtim gjatë studimeve. Pas eksperiencës që do ta fitoj

në punë e studime do të vazhdoj me studimet e doktoraturës në një universitet evropian”, tregoi studentja në fjalë.

UBT, përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me mbi 300 institucione partnere në botë, e ka bërë të mundur realizimin e ëndrrës së qindra të rinjve kosovarë për të studiuar në shtete të ndryshme dhe për të njohur njerëz e kultura nga e mbarë bota.

UBT e ka shndërruar Leara Stavilecin në arkitekthe profesioniste, tash do të vazhdojë studimet në Universitetin e Anhalt-it

Ka përfunduar dhjetëra praktika brenda dhe jashtë vendit paralel me studimin që e ka bërë në UBT, ndërkaq tash është koha që studentja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor, Leara Stavileci të marrë një eksperiencë shumë më ndryshe, të cilën e ka ëndërruar prej kohësh.

Prej këtij viti akademik, ajo do të vazhdojë studimet në Anhalt University of Applied Sciences, falë bashkëpunimit të ngushtë që UBT e ka me këtë universitet të njohur gjerman. Ndonëse vlerëson se në UBT është përgatitur jashtëzakonisht shumë për këtë profesion, Leara tha se është ëndërr jetësore e saj që të vazhdojë ngritjen e mëtejme akademike atje ku është universiteti më i njohur dhe qendra e arkitekturës, sepse në të gjendet fakulteti i mirënjohur, “BAU-

HAUS”, i cili është krijuar nga grupi i arkitektëve më të njohur gjatë shekullit të kaluar.

“Planet për të ardhmen janë që t’i përfundoj së pari studimet me arritje të larta, e pastaj të kthehem në vendin tim dhe të kontribuoj”, u shpreh ajo, teksa tregoi se procedurat për aplikim ishin shumë të thjeshta.

“Falë bashkëpunimit që ka UBT me Universitetin e Anhalt-it, procedurat për aplikim nuk ishin të vështira dhe më është njohur lehtësisht niveli paraprak i studimeve. Profesoret kanë qenë gjithmonë të gatshëm të më ndihmojnë në çdo aspekt gjatë studimeve dhe nuk ka munguar as tani ndihma e tyre. Ata gjithmonë më kanë dhënë motiv që të vazhdoj më tutje dhe të arrij suksese të mëtutjeshme”, sqaroi Leara.

Gjatë viteve të studimeve, ajo ka qenë aktive gjithmonë dhe ka përfunduar praktika e është punësuar nëpër kompani dhe institucione të njohura brenda dhe jashtë Kosovës.

Gjatë vitit të fundit të studimeve të nivelit bachelor, ajo ka punuar një vit në Komunën e Prishtinës, saktësisht në Zyrën për Regjenerim Urban në Drejtorinë e Urbanizmit. Pas përfundimit të studimeve ka kryer edhe disa praktika në byrotë e Prishtinës dhe tash e dy vite ka qenë duke punuar në byronë arkitektonike, “ANARCH”, në Prishtinë. Po ashtu, gjatë kësaj vere ajo ka qenë në Pragë të Çekisë, ku ka kryer praktikën në kompaninë e njohur, “Aukett Swanke”.

Rrëfime sukcesi

Dikur student i Arkitekturës në UBT, tash i punësuar në Zvicër

Studentët e UBT-së gjatë studimeve themelore përfitojnë aftësi, njohuri dhe praktika profesionale në fushat përkatëse, ku falë këtyre vlerave, ata arrijnë të punësohen në shtete të ndryshme të Evropës dhe jo vetëm.

Sukseset e ish-studentit Egzon Jusufi janë shembull që tregojnë se të studiosh në UBT, do të thotë të ndërtohet një karrierë të suksesshme dhe të jesh pjesë e kompanive të njohura në botë.

Tash e disa muaj, ish-studenti i Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, është punësuar në byronë e arkitekturës “BSA Architecture”, me seli në kantonin Vaud në Zvicër. Ish-studenti Jusufi është punësuar në pozitën e arkitektit dhe merret me projektimin e farmacive “SunStore” në gjithë Zvicrën, bëjnë renovimin dhe transformimin e objekteve të ndryshme, etj. Ai tregoi se së fundmi ka filluar të hartoj projekte individuale si shtëpi e banesa kolektive.

Duke folur për studimet në UBT, ai ka theksuar se institucioni ka arritur të nxjerr quadro profesionale dhe ekspertë të fushave të ndryshme, teksa tha se mundësitë që ofrohen nga institucioni janë të pakrahasueshme.

“Ajo që i bën të veçanta studimet në UBT është kualiteti i profesorëve, të cilët janë në nivel të lartë të profesionalizmit dhe për këtë arsyeje dalin studentë të suksesshëm nga ky institucion”, theksoi ai.

Tutje, ai tha se studentët e UBT-së kanë arritur tregun ndërkombëtar të punës falë studimeve cilësore që ofrohen nga institucioni.



Dikur studente në Fakultetin Shkencat Politike, tash e punësuar në UBT



Samire Sadiku ka qenë studente e Fakultetit Shkencat Politike në UBT, e cila sivjet ka përfunduar studimet themelore në specializimin “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci”.

Tashmë ajo është punësuar në UBT dhe mban pozitën e koordinatores së programit të Shkencave Politike, teksa në semestrin ardhshëm pritet të angazhohet si tutore në një lëndë semestrale.

Studentja Sadiku vlerësoi se UBT është zgjedhja e duhur që bëjnë mijëra studentë, siç tha ajo, sepse përveç mundësive të shumta që i ofron, UBT u mundëson studentëve të vet punësim si staf administrativ ose akademik.

“Fillimisht ngrohtësia që institucioni na jep është e jashtëzakonshme, më pas cilësia në studime në UBT nuk krahasohet me asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë. Andaj, secili student që dëshiron të ketë karrierë të suksesshme do t’ia rekomandoja UBT-në për vazhdimin e studimeve universitare, ndërkaq punësimi është i garantuar ende pa përfunduar studimet”, potencoi Sadiku.

Ajo theksoi se UBT ka infrastrukturë moderne dhe mbi gjitha ka edhe bibliotekën që është pasuruar me qindra tituj shkencor.

Cilësia e lartë e studimeve, indikator i njohjes së diplomave të UBT-së në Gjermani

Tash e 17 vite, UBT është prezantues dhe promovues i cilësisë së arsimit të lartë të Kosovës nëpër botë. Kjo dëshmohet përmes suksesit të ish-studentëve e studentëve tanë aktualë, të cilët po arrijnë të vazhdojnë studimet nëpër universitetet më të mira botërore, falë nivelit paraprak të studimeve të kryer në Kosovë.

Se UBT është referencë e cilësisë në arsim, e dëshmon edhe sukcesi i ish-studentit, tash edhe asistent në UBT, Albert Mustafa, të cilit së fundmi i është bërë njohja e dy gradave të shkollimit të përfunduara në UBT, nga institucioni për njohjen e diplomave në Gjermani, Kultusminister Konferenz-Zentralstelle für ausländisches Bildungswesen.

Rëndësia e tërë kësaj qëndron tek fakti që tashmë edhe secilit student tjetër të Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, do t’i njihet niveli i shkollimit paraprak, nëse ata do të duan që shkollimin e mëtejshëm ta vijojnë në Gjermani.

Mustafa vlerësoi se i tërë ky sukses është rezultat i punës së madhe që kryhet për dhe me studentët e UBT-së.

“Tërë kjo është meritë e punës që bëhet në UBT, për ndërtimin e një sistemi edukimi dhe një institucioni arsimor i cili njihet ndërkombëtarisht”, theksoi ai.

Për të sqaruar edhe më tej këtë çështje, Mustafa tregoi rëndësinë dhe ndikimin që do të ketë njohja e diplomave

të UBT-së nga Zyra Qendrore për Arsimin e Huaj, në Gjermani.

“Kjo është e rëndësishme për faktin se studentët kanë mundësinë që pasi të dërgojnë diplomën e tyre atje, do t’u njihet shkollimi dhe kështu mund të punësohen në kompani të ndryshme edhe në Gjermani, normalisht duke përfillur rregullat e përcaktuara nga Oda e Arkitektëve-Architektenkammer”, shtoi ai.

Nën sloganin “Come to UBT, go International”, UBT ka përgatitur e ndihmuar qindra studentë të vet që studimet t’i vazhdojnë nëpër universitete prestigjioze botërore.

Agron Krasniqi, model i përgatitjes së studentëve të UBT-së për tregun e punës

Kanë kaluar disa vite prej kur Agron Krasniqi ka përfunduar studimet themelore në UBT, në Fakultetin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, por ai nuk e ka harruar suksesin të cilin e ka arritur falë përkushtimit të tij dhe studimeve në UBT, që kanë qenë hapi i parë i bërë drejt formimit dhe ngritjes në karrierë.

Sot Agroni është student i nivelit master në UBT, si dhe është përgjegjës për asortiment, përkatësisht menaxher i kategorive në kompaninë “SPAR INTERNATIONAL”, si rrjet i marketeve me pakicë me renome botërore dhe me seli në Holandë, që operon në 48 shtete të ndryshme, mbi 12500 markete dhe mbi 350000 punëtorë anë e kënd botës. Ai tha se kjo punë kërkon përvojë dhe përgjegjësi të madhe

profesionale, por po e kryen me sukses falë marrjes së njohurive në UBT dhe përvojës së fituar ndër vite në tregun e punës.

“Puna të cilën e bëj këtu është shumë e rëndësishme dhe njëherësh e ndjeshme, për arsye se jam personi përgjegjës për asortimentin e “SPAR KOSOVA”, ku i gjithë asortimenti i përzgjedhur nga unë do jetë i gatshëm për konsumatorët kosovarë. Duke e marrë parasysh këtë, është punë mjaftë komplekse, por nga ana tjetër është e mrekullueshme, duke marrë parasysh që puna ime do të shihet dhe shijohet nga shtetasit e Kosovës”, theksoi Agroni.

E tërë këtë sukses në tregun e punës, ai vlerëson se nuk do ta arrinte në nivelin e tanishëm, nëse nuk do të studionte në

UBT dhe në profesionin që gjithmonë e ka dashur.

“UBT ka qenë “dera hyrëse” në tregun e Kosovës dhe i inkurajoi të gjithë studentët aktualë dhe ata potencialë që t’i shfrytëzojnë maksimalisht vitet e studimit në UBT. Mësoni shumë dhe mbi të gjitha dijani vlerën vetes tuaj”, potencoi Agroni.

Përpos suksesit të treguar në studime dhe treg të punës, ai ka qenë edhe përfitues i bursës së programit Erasmus+, përmes UBT-së, me ç’rast edhe e përfundoi vitin e fundit të studimeve bachelor në University of Limerick, në Irlandë.

Rrëfime sukcesi

Studenti i SHKI-së, Arton Jashari pjesë e stafit të UBT-së



Studenti i dalluar i Fakultetit Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, Arton Jashari është në vitin e parë të studimeve në nivelin master, por njëherësh është i punësuar si zyrtar i IT-së në UBT.

Jashari është mbështetësi kryesor i stafit dhe studentëve në aspektin teknik sidomos në punën në laboratorë.

Duke folur për përvojën e tij të punës, ai tha se në këtë rrugë i kanë ndihmuar njohuritë e fituara gjatë studimeve në UBT.

“UBT më ka ofruar hapat e parë në fushën e teknologjisë dhe mundësinë për të filluar karrierën e më pas edhe zhvillimin profesional. Mund të them me plot bindje se njohuritë që i kam marrë në UBT, më kanë shërbyer shumë gjatë përvojave në punë”, ka theksuar Jashari.

Tutje, ai tha se programi në të cilin ka përfunduar studimet themelore dhe tash që po vijon nivelin master, pra Shkencat Kompjuterike dhe Inxhinieri në UBT, ka infrastrukturë dhe laboratorët më bashkëkohor dhe është destinacioni më i kërkuar nga studentët që dëshirojnë të vazhdojnë studimet universitare.

UBT ka qendrën më të madhe të Shkencave kompjuterike dhe Inxhinierisë në Ballkanin Perëndimor, ku krahas studimit, studentët certifikohen nga CISCO, Microsoft, CompTIA etj

Studenti Afron Rada fillon internship në Turqi


Studenti i Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, Afron Rada ka filluar punë praktike në njërin ndër kompanitë më të mëdha në Turqi, “CIVIL”.

Përgjatë praktikës tremujore, ai do të punojë në pjesën e marketingut dhe të tregtisë ndërkombëtare. Kompania në fjalë merret me prodhimtarinë e tekstilit për fëmijë dhe kozmetikë, ku ka 70 pika vetëm në Turqi, si dhe shumë të tjera në disa vende të botës.

Afroni tregoi se në UBT është përgatitur dhe i ka marrë të gjitha njohuritë bazë për profesionin që ka zgjedhur, andaj edhe është sistemuar kaq lehtë në këtë praktikë.

“Studimet në UBT më kanë ndihmuar shumë për të nisur karrierën time. Përmes njohurive që i kam marrë, falë gatishmërisë dhe bashkëpunimit të profesorëve, procedurat e punës nuk më duken të vështira dhe jam avancuar në zhvillimin e profesionit tim”, vlerësoi ai.

Studenti Afron Rada është vetëm një ndër studentët e shumtë të Fakultetit Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi, në UBT, që kanë nisur praktikë dhe kanë gjetur punë, sepse programi është dizajnuar duke marrë në konsideratë kërkesat e tregut vendor e ndërkombëtar të punës.



Studentet e UBT-së, përfitojnë përvojë ndërkombëtare falë programeve të mobilitetit



Vesa Moria dhe Shqipe Sejdiu, janë vetëm dy nga shumë studentë të UBT-së, të cilët janë apo kanë qenë pjesë e universiteteve më të njohura në Evropë, falë marrëveshjeve të bashkëpunimit që institucionit ka me mbi 300 universitete botërore.

Studentet Morina dhe Sejdiu, kanë pak ditë që janë kthyer nga Universiteti i Portugalisë “NOVA de Lisboa”, të cilat kanë ndjekur studimet për një semestër në këtë universitet.

Ato janë shprehur të privileguara që patën rastin që falë UBT-së dhe programit të mobilitetit të fitojnë bursë për të qëndruar disa muaj në Portugali.

Tutje, ato thanë se në Universitetin “NOVA de Lisboa”, fituan eksperiencë profesionale dhe akademike, teksa vlerësuan se UBT punon me praktika të ngjashme sikurse me ato të universiteteve ndërkombëtare.

Pas kthimit nga Portugalia, studentet në fjalë menjëherë janë kyçur në tregun e punës. Vesa është angazhuar në UBT si asistente në disa lëndë, ndërsa Shqipja është punësuar në një kompani vendore. Ato falënderuan UBT-në për mundësinë e dhënë, derisa inkurajuan studentët që të vijnë në UBT për të vazhduar studimet, si në nivelin bachelor ashtu edhe në atë master.

Tradicionalisht studentët e UBT-së, veç tjerash, kanë mundësinë që automatikisht t’i vazhdojnë studimet jashtë vendit, për një semestër ose vit akademik në universitetet më të njohura në botë.

Studenti Dëfrim Zenuni punësohet në Spitalin Rajonal të Ferizajt

Dashuria për mjekësinë, njohuritë e shkathtësitë profesionale dhe dëshira e madhe për të ndihmuar njerëzit, ka bërë që Dëfrim Zenuni të bëhet student i gjeneratës së parë të Fakultetit të Infermierisë në UBT.

Puna e tij intensive brenda dy viteve të studimeve është shpërblyer menjëherë, pasi tashmë ai ka filluar që ta zbatojë në praktikë profesionin që ka zgjedhur.

Ai po punon në pozitën e infermierit të përgjithshëm me shkollim të mesëm në Spitalin Rajonal të Ferizajt, pas një procesi seleksionimi përmes provimit me shkrim dhe intervistës me gojë. “Kjo punë për mua është shumë e rëndësishme duke marrë parasysh nevojat e spitalit për staf të mesëm, pasi që ka qenë gjithmonë një problem për vijimin normal të

punës në spital, e sidomos në repartin e Emergjencës, ku vihet re mungesa e punëtorëve, andaj pozita e infermierit është shumë e rëndësishme në përmirësimin shërbimeve shëndetësore”, tha Dëfrimi. Për këtë punë humane, ai i jep merita edhe UBT-së, prej ku thotë se i mori bazat e para të profesionit, si dhe format më të duhura për kujdes ndaj pacientëve. “Në UBT kam arritur të përveçtohem shumë njohuri mbi degën e infermierisë. UBT ka një staf adekuat për ngritje profesionale të studentëve, gjithashtu ka sjellë profesorë nga shtetet më të zhvilluara të botës, të cilët shpallorën para nesh eksperiencën e tyre. Kjo ishte një ndihmë shumë e madhe për mua dhe për studentët e tjerë në aspektin e formimit si një kuadër sa më cilësor”, u shpreh Dëfrimi.

Vizita studimore të studentëve

Studentët e Fakultetit Media dhe Komunikim vizituan Portalin Telegrafi

Studentët e vitit të dytë në Fakultetin e Medias dhe Komunikimit në UBT, vizituan portalin Telegrafi, ku u pritën nga kryeredaktori, njëherësh edhe ligjërues në UBT, Muhamet Hajrullahu.

Hajrullahu i informoi studentët për sistemin e brendshëm të funksionimit, natyrën e punës në portal, realizimin teknik, mënyrën e ndarjes së punëve dhe përgjegjësi, teksa në të njëjtën kohë, studentët patën mundësinë të bëjnë edhe pyetje.

Ai po ashtu ka folur për mundësinë e bashkëpunimit dhe të punësimit për studentët në këtë portal.

Vizitat studimore po realizohen me qëllim të informimit dhe të njoftimit të studentëve në mënyrë të drejtpërdrejtë me kushtet dhe mundësitë që ofron tregu i punës. Studentët e këtij drejtimi edhe më parë kanë vizituar shtëpi mediale, teksa edhe më tutje ata do të vazhdojnë të vizitojnë medime televizive, portale e gazeta vendore.



Studentët e Shkencave Politike vizituan organizatën Demokraci Plus



Studentët e vitit të parë në Fakultetin e Shkencave Politike në UBT, kanë realizuar vizitë studimore në organizatën Demokraci Plus (D+).

Vizita u realizua në kuadër të lëndës “Qeverisja dhe Institucionet Politike”, nën shoqërimin e profesorit, Alfred Marleku.

Studentët u pritën nga drejtori ekzekutiv i organizatës, Valmir Ismaili, i cili është edhe njëri nga themeluesit e kësaj organizate.

Me këtë rast, ata patën mundësi unike që të dëgjojnë një ligjëratë, pjesa e parë e të cilës u fokusua në përvojën personale të tij lidhur me zhvillimin dhe të arriturat profesionale, me theks në sfidat e hasura në themelimin dhe zhvillimin e organizatës. Ndërkaq, në pjesën e dytë u trajtuan profili i organizatës dhe projektet të cilat aktualisht zbatohen në kuadër të aktiviteteve të përditshme, duke i shtjelluar në detaje mekanizmat e funksionimit të institucionit.

Studentët u njoftuan edhe për mundësitë për praktikë profesionale dhe shkathtësitë që duhet të posedojnë praktikantët për të punuar në D+ dhe institucione tjera të ngjashme.

Studentët e Inxhinierisë së Energjisë vizituan Hidrocentralin e Fierzës

Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Energjisë realizuan vizitë studimore në Hidrocentralin e Fierzës, në Shqipëri.

Gjatë kësaj vizite studimore ata u shoqëruan nga profesorët në UBT, Vehbi Sofiu, Sami Gashi dhe Afrim Osmani.

Studentët panë nga afër digën, ujëmbledhësin dhe tunelet e turbinave të këtij hidrocentrali, i cili është ndër më të mëdhenjtë në Ballkan, që ka filluar punën në vitin 1975.

Përveç kësaj, studentët vizituan edhe sallën e komandës, sallën e makinave, sallën e turbinave dhe sallën e baterive.

Pos stacionit bazë të hidrocentralit, studentët panë nënstationin e afërt për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe transformimet dhe tensionit, teksa u njoftuan me sistemin e mbrojtjes, të komandimit dhe qendrën e operimit.



Studentët e UBT-së vizituan kampin ushtarak “Bondsteel”



Studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakultetit të Arkitekturës dhe Planifikimit Hapësinor në UBT, të shoqëruar nga profesorët e departamenteve, Hazir Çadraku dhe Bekim Selimi, kanë vizituar kampin ushtarak amerikan në Kosovë “Bondsteel”.

Studentët vizituan këtë kamp ushtarak për të parë nga afër infrastrukturën e Bondsteel-it, furnizimin me ujë të pijshëm, njëherësh ata janë njohur edhe me mënyrën e trajnimit të ujërave të zeza.


Valdet Gashi, zyrtar për mbrojtjen e mjedisit në kampin “Bondsteel”, ka sqaruar detajet që lidhen me procesin teknologjik të marrjes, përpunimit dhe jonizimit të ujit, teksa bashkërisht me studentët kanë vizituar edhe impiantet për prodhimin e ujit të pijes dhe atë të trajtimit të ujërave të zeza.

Gashi ka thënë se procesi i prodhimit të ujit në këtë kamp bëhet sipas standardeve të kërkuara nga ushtria amerikane, ku kampi ka të instaluar edhe rrjetin e shpërndarjes se ujit deri tek përdoruesit brenda kampit.

Kampi Bondsteel ndodhet pranë qytetit të Ferizajit dhe është baza kryesore për ushtrinë amerikane në Kosovë.

Shtëpia nëntokësore – koncepti i ri i banimit individual

Zana Prelvukaj, Lulzim Beqiri



Shtëpitë nëntokësore, si ndërtim i ri, plotësojnë dy kushtet kryesore, sigurimin e strehimit dhe mbrojtjen e ambientit përreth saj. Teknikat e shtëpive nëntokësore janë veçanërisht të rëndësishme në zonat urbane sepse u mundësojnë komuniteteve të ndërtojnë hapësirë banimi dhe të ruajnë hapësirën e gjelbëruar. Hapësirat në sipërfaqen e tokës janë burim i madh për t'u përdorur dhe eksploruar. Këto hapësira tani sigurojnë edhe sistemet e transportit, sistemin e ujësjellësit, sistemin e ngrohjes, ruajtjen e gazit, rrjetet për ruajtjen e mineraleve të ndryshme, etj. Në aspektin ekologjik dhe estetik, në botë ekziston nevoja për peizazhe të ndryshme, të përbëra nga pyje, kullota, kënetat, liqenjtë, pellgjet dhe shumë zona të tjera natyrore, të cilat mundësojnë sigurimin e ushqimit.

Ndërtesat nëntokësore nuk mund të jenë shumë ndryshe nga hapësirat e strehimit të paraardhësve tanë të hershëm. Ky lloj ndërtimi mbështet arritjen e ndikimit të reduktuar mjedisor, të ilustruar nga ripërtëritja e tokës dhe ujit, rritja e bimëve, kthimi i shumë llojeve të kafshëve dhe rritja e stabilitetit të ekosistemit.

Qëllimi përfundimtar për shtëpitë është të arrijnë atraktivitetin, efikasitetin e energjisë (ngrohje dhe ftohje), mirëmbajtje më të ulët, si dhe një strukturë e cila funksionon mirë me mjedisin.

Shfrytëzimin e nëntokës e shpjegojnë edhe disa nga llojet e kafshëve, shpendëve, insekteve, etj. Dhelpra e cila është një ndër kafshët gjitare, urithi, miu, buburreci, merimanga, gjarpëri, e shumë gjallesa të tjera, e shfrytëzojnë mjaftë mirë tokën, duke ndërtuar nën tokë strehimore, për shkak të performancave të cilat i ofron natyra. Natyrisht që kushtet pozitive apo negative varen gjithmonë nga lloji i tokës, në aspektin se sa përmban lagështi, gjerësi, lartësi, ngjyra e sipërfaqes, këndi i pjerrtësisë, mbulesa vegetative dhe kushtet klimatike të përgjithshme.



Shfrytëzueshmërinë e tokës mjaftë mirë e sqaron edhe fotografia e bashkëngjitur më poshtë: Shfrytëzimi i tokës si strehimore nga gjallesa të ndryshme (<https://www.pinterest.com/pin/534661786983951312/>, 2018)

Mirëpo, çfarë mund të ofrojë vendi ynë në adaptimin dhe ndërtimin e shtëpive nëntokësore, sa është parashikuar aspekti legjislativ për ndërtim, çfarë lloj banimi aplikon vendi ynë?

Njohja e këtij lloj ndërtimi të ri do të zgjidhte probleme të mjaftueshme në ruajtjen e zonave të gjelbërta në hapësira urbane, ruajtjen e pyjeve, tokave bujqësore, do të mundësonte reduktimin e ndotjes së ujit dhe ajrit, zvogëlimin e dioksid karbonit, ruajtjen e resurseve natyrore, e shumë


të tjera.

Kosova deri më tani ende nuk ka realizuar ndërtim të shtëpisë nëntokësore.


Ndërtimi i shtëpive nëntokësore mund të konstatohet që i përket periudhave të herëshme të banimit. Një sinonim i këtyre shtëpive shpjegon mirë jetesën në shpella, si strehimoret e para në jetën e njeriut. Si rezultat final, mund të themi se ndërtimi i shtëpive nëntokësore nuk është i ri dhe as i zbuluar për strehimin e njeriut.

Ruajtja e ushqimit në nivelin e tokës, toka e gërmuar apo bodrumet e shtëpive, tregojnë aftësinë e efikasitetit gjatë ndryshimeve të temperaturave. Pronarët e shtëpive nëntokësore të ndërtuara, pretendojnë zvogëlimin e faturave të energjisë deri në 90 për qind. Po ashtu, arrihet një ndikim i reduktuar mjedisor, i ilustruar nga ripërtëritja e tokës dhe ujit, rritja e bimëve vendase përreth shtëpive, kthimi i shumë llojeve të kafshëve të egra dhe rritja e stabilitetit të ekosistemit. Për më tepër, ato janë të ndërtuara prej betonit, tullave dhe materialeve lokale, të cilat shpesh janë më të disponueshme, më të lehta për t'u përdorur, më të qëndrueshme, dhe ndoshta, më pak shkatërruese për mjedisin. Kati i mbuluar me tokën mbështetë bimët dhe objekti i banimit përzihet me peizazhin natyror. Ndërsa, në ndërtesat konvencionale, kulmet dhe sipërfaqet e forta nuk mbështesin mbulesën e bimëve dhe parashikimet e drurit dhe qelqit nuk përzihen në peizazhin natyror. Shtëpitë nëntokësore mund të jenë të paçmueshme nga njerëzit për shkak ndërtimit me materiale në dispozicion në nivel lokal, ato nuk lejojnë hapje me sipërfaqe të lartë por arrijnë të përmirësojnë bimësinë dhe habitatin e kafshëve të egra. Megjithatë, këto veçori duhet paraprakisht të planifikohen në dizajnin e shtëpive nëntokësore. Shtëpitë nëntokësore bëhen anëtarë të përhershëm të komunitetit natyror, duke përdorur energji në mënyrë efektive dhe efektive. Pemët janë në ekuilibër me mjedisin dhe janë pajisje të përhershme që marrin pjesë në rrjedhën e energjisë dhe materialeve. Për shkak se shtëpia nëntokësore është një strukturë e përhershme me mirëmbajtje të ulët, ndërsa shtëpia konvencionale ka një efekt negativ të vazhdueshëm që përsëritet çdo herë që ndërtohet. Zgjedhja e një shtëpie të përshtatshme për të ruajtur energji nuk është e lehtë për t'u bërë. Ka edhe arsye të estetikës, përdorimit të tokës dhe mjedisit, zvogëlimin të zhurmës, mirëmbajtjes dhe mbrojtjes. Kushtet e banimit dhe klima mund të favorizojnë disa veçori të dizajnit. Prandaj, mund të jetë e nevojshme të përzgjedhim një kombinim të strategjive diellore konvencionale, aktive dhe pasive, si dhe kontaktet me tokën. Disa kryejnë më mirë në ftohje (kontakt tokësor), ndërsa të tjerët vlerësojnë jashtëzakonisht mirë në mbajtjen e nxehtësisë (lloje të izoluar) – në disa raste disa dizajne bëhen mirë në disa rajone, dhe jo në të tjerat.

Më poshtë janë prezantuar dy raste të ndërtimit të shtëpive nëntokësore në terren të pjerrët dhe në terren të rrafshët.



Projekti arkitektonik, "Villa Vals", Zvicër (https://mulher.uol.com.br/casa-e-decoracao/album/search_villavals_album.htm#fotoNav=3, 2014).



Projekti në formën tredimesionale, EKO-zero karbon (Pham, 2010)

Përparësitë dhe mangësitë e shtëpive nëntokësore

Përparësitë:

Shtëpitë nëntokësore ofrojnë një strehë të sigurt nga moti ekstrem, si tornado, uragane, erëra të forta dhe stuhi breshëri.

Toka që rrethon shtëpitë siguron izolim natyral, duke krijuar një hapësirë të qetë jetese me privatësi.

Shtëpitë nëntokësore përzihen mirë në mjedis, d.m.th: arkitektura modeste është e mundshme, ndryshe nga shtëpitë mbi tokë, në të cilën është e vështirë të përputhet me shtëpinë me peizazhin përreth.

Toka duke qenë një izolues natyror, i mban shtëpitë e tilla të ngrohta në dimër dhe të ftohta në verë. Kjo redukton kërkesat e energjisë në shtëpi, veçanërisht në zonat me erë.

Për shkak të temperaturës konstante të shtëpive

nëntokësore, shpenzimet për energji janë zvogëluar ndjeshëm. Në fakt, këto shtëpi kushtojnë 80 - 95% më pak se shtëpitë tradicionale për të ngrohur dhe ftohur.

Me planifikim dhe ndërtim të duhur, këto shtëpi mund të kenë kushte të mira drite.

Këto janë miqësore me mjedisin, për shkak të faktit se ndërtimi dëmton fare pak ekologjinë përreth. Eficienca e lartë e energjisë ndihmon në ruajtjen e mjedisit. Gjithashtu, ato mund të ndërtohen nga materiale të ricikluara

Një shtëpi nëntokësore nxjerr një ndjenjë të afërsisë me natyrën, për shkak të faktit se është e rrethuar nga toka.

Meqenëse më shumë se 90% e shtëpisë është e përbërë prej betoni, ka më pak pjesë të tij që mund të përfshihen nga zjarri.

Shtëpitë nëntokësore janë të mbrojtura mirë nga tërmetet. Në fakt, edhe një tërmet i madh mbi tokën do të jetë vetëm një e pesta si destruktive nën të.

Për shkak të rreziqeve më të vogla, është e lehtë të sigurohet sigurimi, dhe po ashtu, me kosto më të lirë.

Këto shtëpi kërkojnë pak ose aspak mirëmbajtje të jashtme, si ri-pikturë, duke zvogëluar kështu kostot e mirëmbajtjes.

Këto shtëpi, ndërtohen nga materiale të forta si blloqe betoni dhe zhir, andaj janë të forta dhe të qëndrueshme.

Shtëpitë nëntokësore mund të ndërtohen në sipërfaqe me terrene të pjerrëta.

Këto shtëpi sigurojnë përdorimin e duhur të tokës, meqë struktura e shtëpisë është nën tokë. Në fakt, ndërtimi i një shtëpie nëntokësore është një mënyrë e mirë për të rritur vlerën e një ngastre toke.

Këto shtëpi ofrojnë më pak mundësi për insektet dhe dëmtuesit e tjerë, për shkak të numrit më të vogël të hapjeve. Kjo është tërësisht në kundërshtim me shtëpitë mbi tokë.

Këto shtëpi janë pothuajse të sigurta nga grabitësit dhe hajdutët, kur krahasohen me shtëpitë tradicionale, pasi që vetëm një anë e shtëpisë duhet të mbrohet.

Ato janë të sigurta nga pasojat radioaktive të shpërthimeve bërthamore dhe situatave të tjera shpërthyes, në rast të një konflikti global. Shtëpia mund të bëhet e ajrosur në rast të një sulmi biologjik.

Mangësitë e shtëpive nëntokësore:

Mund të ketë një rregullim psikologjik që nevojitet për një person që zhvendoset nga një shtëpi tradicionale mbi tokë në një shtëpi nëntokësore. Këto shtëpi janë të pazakonta dhe kërkojnë planifikim të kujdesshëm.

Një nga problemet kryesore me shtëpitë nëntokësore është se ato nuk mund të ndërtohen në një zonë të prirur nga përmbytja.

Këto shtëpi kërkojnë kujdes të konsiderueshëm për të mbajtur lagështinë, si gjatë ndërtimit, ashtu edhe në jetën e shtëpisë.

Procesi i aplikimit të lejës së ndërtimit dhe hipotekës, gjithashtu mund të jetë sfidues për këto shtëpi.

Është sfiduese që të përshtaten pajisjet katrore ose kornizat të cilat janë projektuar për mure të drejta në shtëpitë nëntokësore për shkak të lakimit të murit.

Ndërtimi i shtëpive të tilla kërkon procedura komplekse të ventilimit

Llojet e shtëpive nëntokësore

Varësisht nga vendi i ndërtimit dhe analizave të terrenit, shtëpitë nëntokësore ndahen në kategoritë e mëposhtme:

Shtëpia nëntokësore;

Shtëpia nëntokësore me atrium;

Shtëpia nëntokësore me një fasadë të lirë;

Shtëpia me dy fasada të lira;


Shtëpia e kombinuar;

Të gjitha llojet e shtëpive nëntokësore gjejnë aplikimin e tyre në bazë të përzgjedhjes të terrenit, terrene të pjerrëta, terrene me sipërfaqe të rrafshët, në shkëmbinj, etj.


Tipologjia 1 - Shtëpia nëntokësore




Tipologjia 2 - Shtëpia nëntokësore me atrium



Tipologjia 4 - Shtëpia nëntokësore me dy fasada të lira (penetrational)



4.5 Tipologjia 5 - Shtëpia nëntokësore e kombinuar



Ndriçimi natyral tek shtëpitë nëntokësore

Për projektim dhe dizajnim për sigurimin e ndriçimit natyral të mjaftueshëm, që konsiderohet si element i domosdoshëm për të kryer funksionin si shtëpi banimi, është orientimi i hapësirave të brendshme. Orientimi në pjesën jugore, jug-lindje dhe jug-perëndim, do të ofron mundësi të mira për sigurimin e hapjeve që mundësojnë ndriçim dhe ventilim natyral. Duke u bazuar se shtëpitë nëntokësore ndahen në kategori të ndryshme, forma e sigurimit të dritës ndahet në bazë të tipologjive dhe llojit të terrenit, në të cilin shtëpia projektohet.

Shpërndarja e dritës përgjatë thellësisë të hapësirave, gjithashtu është e rëndësishme për krijimin e një mjedisi komod të banimit.

Zhvillimi i teknologjisë dhe prodhimit të fundit të elementeve ndriçuese ndihmon mjaftueshëm në zgjidhjen e problematikave, në aspektin e ndriçimit tek shtëpitë nëntokësore.

Ana Luura Mohrit, e cila realizoi një studim rreth sigurimit të ndriçimit tek shtëpitë nëntokësore, në librin "Natural Lighting and Psychological Barriers in Underground Houses", ka arritur të sqarojë disa nga format e aplikimit të materialeve dhe formave, të cilat mund të përdoren tek shtëpitë nëntokësore, që ofrojnë një rezultat të mirë për sigurimin e dritës.

Pasqyrat konsiderohen elemente të cilat ndihmojnë në thyerjen e dritës, dhe përdorimi i pasqyrave në ambientet e brendshme rezultojnë me shpërndarjen e dritës në zonat e brendshme të pandriçuara tek shtëpitë nëntokësore. Xhami është material transparent që ndihmon në izolimin e hapësirave nga ndryshimet atmosferike, siguron edhe depërtimin e dritës në hapësirat e brendshme. Rëndësi të

SHTËPIA NËNTOKËSORE NË KOSOVË

Kosova nuk ka ndonjë përvojë ndërtimi të këtyre llojeve të shtëpive, pavarësisht nga potenciali që ka Kosova për ndërtimin e këtyre llojeve të shtëpive. Megjithatë, Kosova, për implementimin e kësaj shtëpie, ka disa pengesa që janë:

Psikologjike;

Legjislative;


Sociale-mentaliteti.

Në aspektin legjilativ, Kosova nuk ofron normativë për ndërtimin e kësaj shtëpie, si edhe shumë shtete në rajon e më gjerë. Normativat e qarta për Kosovën do të duhej të analizohen për një kohë më të gjatë dhe me një qasje shumë profesionale, me qëllim të krijimit të standardeve adekuata për implementimin e këtyre shtëpive. Këto standarde mund adaptohen edhe nga legjislacioni i shteteve me konfiguracion dhe përbërje gjeologjike dhe seizmike të njëjtë apo të përafërt me Kosovën.

Në aspektin psikologjik dhe social, ky lloj ndërtimi është jo edhe aq i rekomanduar për njerëzimin, për faktin që nën nivelin zero njeriu zakonisht është në fazën e përfundimit të jetës se tij (varrosja), prandaj ky lloj objekti nuk është që mund lehtë të pranohet nga banorët. Ky edhe është një motivim që ky lloj objekti të ndërtohet në fillim për qëllime turizmi, me qëllim të thyerjes së barrierave psikologjike, në mënyrë që shtëpia me lehtë të pranohet si banim i përherëshëm dhe me përmasa pak më të gjera.

Ndryshimet klimatike, në veçanti rritja e temperaturës, e "detyron" objektin e banimit të "mbrohet" nga kushtet klimatike dhe kjo mbrojtje e këtij objekti mund të realizohet përmes "uljes" së objektit të banimit në thellësi të ambientit ku ndërtohet. Mbrojtja e objektit duke ndërruar nivelin nga ai pozitiv, në atë negativ, nga niveli zero rezultojnë në përfitime të ndërsjella. Objekti mbrohet nga ndikimet klimatike dhe energjinë që shkëmben me ambientin ku ndërtohet, u ofron banorëve një komoditet energjetik, duke ndihmuar në mbrojtjen e ambientit dhe në eliminimin e pengesave vizuale në terrenet ku ndërtohet shtëpia.

madhe, e cila duhet të merret si analizë në projektim, kanë edhe llojet e hapjeve të cilat mund të aplikohen tek shtëpitë nëntokësore, forma, madhësia dhe orientimi ndikojnë në sigurimin e ndriçimit të hapësirave të pandriçuara.



Analizë e ndriçimit tek shtëpitë nëntokësore

Shkolla Profesionale e UBT-së ka dëshmuar se është lider në Kosovë

Këtë vit në UBT janë mbajtur trajnime nga fusha të ndryshme, si: Project Online, SPSS, Marketing Digjital, Cobit 5, IBM SAN Fundamentals, IT Essential, ArcMap, Gjuhë Angleze, Gjuhë Gjermane, përgatitje për TOEFL. Gjatë vitit 2019 planifikojmë që të organizojmë trajnime për Menaxhimin e projekteve, CCNA Cyber Security, CCNA 1 – Introduction to Networks, CCNA 2 – Routing and Switching Essentials, MCSA – Windows Server 2016, CCNP Routing



Dr. Besnik Skenderi

Në kohën e globalizmit dhe të konkurrencës agresive, bizneset dhe individët duhet të përshtaten me nevojat e kërkesave nga tregu i punës, dhe për më tepër, ndryshimet vijnë si pasojë e inovacioneve dhe ndryshimit të proceseve të punës.

Sot gjatë ditës mund të shfaqet nevoja për profesion të ri, dhe po ashtu, gjatë ditës disa profesione mund të zhduken. Për këtë arsye shumë kompani kanë themeluar qendrat e tyre për hulumtim dhe zhvillim dhe investojnë në ngritjen e kapaciteteve të punëtorëve të tyre, mirëpo ballafaqohen me probleme të ndryshme, si mungesa e përvojës në mbajtjen e trajnimeve, planprogramet e dobëta dhe mungesën e infrastrukturës për trajnim dhe certifikim.

Në ambientin aktual ku veprojmë, një diplomë e edukimit formal që nuk përditësohet me trajnime dhe me certifikime profesionale, shumë shpejt e humb vlerën dhe një person nuk mund të konsiderohet profesionist i një fushe nëse nuk i përditëson njohuritë dhe nuk i përcjell trendët botërorë.

Ne në UBT kemi përvojën dhe njohuritë se si t'i iden-

tifikojmë nevojat e pjesëmarrësve për trajnime dhe ne besojmë në konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Për më tepër, ne mund të ndihmojmë edhe në ndryshimin e karrierës dhe në fillimin e jetës së dytë profesionale për persona që kualifikimi dhe përvoja e tyre më nuk është aktuale dhe nuk ka kërkesë nga tregu i punës për atë profesion.

Si pasojë e zhvillimit të madh të teknologjisë së informacionit, prodhuesit e harduerit dhe të softuerit kanë krijuar planprogramet dhe certifikimet e tyre, dhe kur bëhet fjalë për përcjelljen e trendëve botërorë, Shkolla Profesionale e UBT-së ka dëshmuar se është lider në Kosovë. Aktualisht ne jemi partnerë të Microsoft dhe UBT këtë vit po ashtu ka implementuar Microsoft Imagine Academy, dhe tani, stafi dhe studentët e UBT-së kanë qasje në planprogramet dhe në materialet trajnuese nga Microsoft. Po ashtu, UBT është pjesë e Microsoft Certified Education dhe është në proces të certifikimit të mësimdhënësve.

Në kuadër të Shkollave Profesionale të UBT-së ofrojmë edhe certifikime nga CompTia, Certipoint, PearsonVue, CISCO, SAP.

Përveç se UBT ofron trajnime dhe certifikime sipas planprogrameve të prodhuesve, nga ky vit UBT ka filluar me ofrimin e trajnimeve të përshtatura UBT dhe tani do të vazhdojë me ofrimin e trajnimeve dhe të zgjedhjeve praktike dhe efektive për nevojat e industrisë dhe të bizneseve. Kjo do të arrihet lehtësisht si rezultat i misionit dhe vizionit të qartë, përkushtimit dhe profesionalizimit të ekipit të UBT-së dhe besimit që konsumatorët e kanë tek UBT.

Në kuadër të UBT-së funksionon Departamenti për Zhvillim Profesional dhe në këtë departament ofrohen tra-

jnime dhe certifikime profesionale. Aktualisht, Shkollat Profesionale të UBT-së janë të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve për profesionet:

- Zhvillues i Aplikacioneve
- Administrator Rrjeti dhe i Sistemeve Kompjuterike
- Asistent Administrativ
- Teknologji Informative dhe Komunikim
- Gjuhë angleze

Gjatë vitit 2019 UBT do të organizojë garën për MOS (Microsoft Certified User Specialist) dhe kjo garë do të jetë e hapur për të gjithë shtetasit e Kosovës, ndërkaq pjesëmarrësit me rezultatet më të mira do të marrin pjesë në MOS Olimpiadën që do të mbahet në New York, në muajin korrik të vitit 2019.

Këtë vit në UBT janë mbajtur trajnime nga fusha të ndryshme, si: Project Online, SPSS, Marketing Digjital, Cobit 5, IBM SAN Fundamentals, IT Essential, ArcMap, Gjuhë Angleze, Gjuhë Gjermane, përgatitje për TOEFL. Gjatë vitit 2019 planifikojmë që të organizojmë trajnime për Menaxhimin e projekteve, CCNA Cyber Security, CCNA 1 – Introduction to Networks, CCNA 2 – Routing and Switching Essentials, MCSA – Windows Server 2016, CCNP Routing.

Të gjitha këto trajnime mbahen në UBT në Prishtinë, në kampuset dhe degët e UBT-së në Lipjan, Prizren, Gjilan, Pejë dhe Ferizaj.

UBT mbetet e përkushtuar që të ofrojë trajnime profesionale që ndërlidhen me nevojat e tregut të punës, dhe po ashtu, UBT është institucioni i parë në Kosovë që ofron trajnime të përshtatura sipas nevojave të konsumatorëve.



Shkolla Profesionale

Administrator i sistemeve
dhe i rrjetit kompjuterik



Faktorët e sigurisë në komunikacionin rrugor




Dr. Nol Dedaj

Komunikacioni është një fenomen i komplikuar në të cilin krijohen shumë situata të konfliktit. Për t'u rritur siguria në komunikacion, është e nevojshme të merren një numër masash, qëllimi i të cilave është të largohet apo minimizohet rrezikun në rrugë. Rreziku nga aksidentet e komunikacionit, të cilat rrjedhin nga lëvizja e automjeteve dhe këmbësorëve, mund të tregohet në gjendjen e sistemit të faktorëve të cilët paraqiten në moment. Duke analizuar faktorët e mundshëm, komunikacioni rrugor thjesht mund të shikohet përmes tre faktorëve kryesorë: Njeri, Automjet dhe Rrugë.

Në strukturën e komunikacionit rrugor mund të vërehet sistemi mekanik, i cili përbëhet prej lidhjes "Automjet-Rrugë", dhe sistemit biomekanik, i cili përbëhet prej lidhjes "Njeri-Automjet" dhe "Njeri-Rrugë". Ndikimi i këtyre tre faktorëve në sigurinë e komunikacionit



Në fig.1 shihet lidhshmëria ndërmjet faktorëve Njeri (N)-Automjet(A)-Rrugë (RR). Rrethina, gjithashtu, është faktor i sigorisë së komunikacionit. Çdo gjë që gjendet rreth nesh ndikon në sjelljet tona në komunikacion. Për sigurinë e komunikacionit domethënie të veçantë ka hapësira ku përputhen që të tre faktorët. Disa autorë, në vend të faktorit Rrugë, e marrin faktorin Rrethinë. Nëse shqyrtohet sistemi kibernetik, i cili përbëhet prej tre faktorëve "Automjet", "Rrugë" dhe "Rrethinë", vërejmë se funksionin e drejtimit e ka ngasësi, objekt i ngasjes është automjeti, derisa rrethina është burim i informatave në bazë të të cilave definohet gjendja e sistemit. Në fig.2 është paraqitur lidhja elementare ndërmjet elementeve të sistemit Njeri – Automjet – Rrethinë.



Nga fig.2 shihet qartë se ekziston ndërrimi i informacioneve dyfish në relacionin rrethinë-ngasës dhe ngasës-automjet, si dhe ndërrimi i informacioneve njëfish, rrethinë-ngasës. Në faktin rrethinë, si element sigurie dhe bartës i informacioneve është rruga (elementet teknike të rrugës të papërputhshme, gjendja e rrugës e dobët, kushtet atmosferike të dobëta, ndryshime të ndryshme gjatë qarkullimit të automjeteve, etj.). Në bazë të informacioneve të marra në rrugë dhe përcaktimeve subjektive të rrethinës, ngasësi drejton automjetin motorik.

Sipas disa autorëve, faktori "rrethinë" ka një kuptim shumë më të gjerë dhe jo të precizuar, sepse krijon shumë paqartësi (p.sh. si hapësirë mund të merret edhe vendi ku gjendet ngasësi, temperatura dhe atmosfera ku ngasësi qëndron, etj.), ndërsa si faktor i tretë merret "Rrugë".

Faktori "Njeri", "Automjet" dhe "Rrugë", nuk i përfshinë të gjitha elementet të cilët mund të ndikojnë në siguri, si p.sh. rregullat e qarkullimit në komunikacion rrugor, drejtimi dhe kontrolli në komunikacion, etj. Pra, është e nevojshme që të ndahet edhe faktori i katërt me emrin "Komunikacioni në rrugë".

Faktorët e sigorisë "Njeriu", "Rrugë", "Automjet" dhe "komunikacioni në rrugë" gjithnjë paraqiten, gjegjësisht, janë prezentë në rrugë gjatë lëvizjes së automjeteve në komunikacion. Këta faktorë i nënshtrohen rregullave të caktuara, por nuk i përfshijnë elementet tjera, të cilat paraqiten papritmas (befasishëm), të pasistemuar, por të cilët ndikojnë gjendjen e sigorisë.

Këtu kryesisht mendohet në kushtet atmosferike ose elementet tjera, si p.sh. Gurët në rrugë, vaji dhe balta në rrugë, etj. Për këtë paraqitet nevoja që të caktohet edhe një faktor që do t'i përfshinte të gjitha elementet e cekura. Ky faktor mund të quhet "Faktori incident", që të përkufizohet dhe sistemohet në sistemin e faktorëve të sigorisë me mënyrën e paraqitjes së tij në komunikacion (befasishëm). Prandaj, mënyra e paraqitjes së rrezikut (aksidenteve) në komunikacion mund të jetë i shtyrë, gjegjësisht, në funksion

E këta janë:

1. Faktori "Njeri"
2. Faktori "Automjet"
3. Faktori "Rrugë"
4. Faktori "Komunikacioni në rrugë"
5. Faktori "Incident"

Sot në botë ekzistojnë mendime të ndryshme lidhur me përqindjen e ndikimit të faktorëve të sigorisë në aksidente të komunikacionit rrugor.

Në bazë të analizës së statistikave të të dhënave të aksidenteve të komunikacionit rrugor të vendeve të ndryshme, mund të vihet në përfundim se tre faktorët kryesorë të aksidenteve të komunikacionit rrugor: "Njeriu" (rreth 88%), "Automjet" (rreth 3-4%) dhe "Rrugë" (rreth 7-9%).

Sipas të dhënave të disa autorëve, faktori "rrugë", si shkaktar i aksidenteve të komunikacionit rrugor, paraqitet me një përqindje të gjerë prej 0,5-35%.

Në shumë shtete të Evropës merret se faktori "rrugë" është shkaktar i aksidenteve të komunikacionit rrugorë prej 20-30% të rasteve. Duke pasur parasysh se rrjeti rrugor i Evropës është shumë më kualitativ se i yni, në bazë të kriterëve të njëjta, duhet të parashikojmë se faktori "Rrugë" ndikon në aksidente të komunikacionit me një përqindje më të madhe. Diferenca në përqindje të ndikimit të faktorit rrugë në aksidente të komunikacionit është mënyra e trajtimit të ekspertëve gjatë zgjidhjeve të aksidenteve të komunikacionit rrugor.

Shumica e autorëve janë të mendimit se faktori:

1. "Njeri" është 85% shkaktar i të gjitha aksidenteve të komunikacionit rrugor;
2. Faktori rrugë është shkaktar i aksidenteve të komunikacionit rrugor me 8-10%;
3. Faktori "Automjet" është shkaktar i aksidenteve me 3-5% të rasteve;
4. Faktori "Komunikacioni në rrugë" është shkaktar i aksidenteve me 1-2% të rasteve;
5. Faktori "Incident" është shkaktar i aksidenteve me 1-2% të rasteve.

Mbrojtja dhe Siguria në punë



Dr. Hazir Çadraku

Mbrojtja dhe siguria në punë nuk njohin kufij, në të kanë të drejtë të gjithë njerëzit në botë. Si e tillë, mbrojtja dhe siguria paraqet një proces i cili daton që nga fillimi i veprimtarisë së njeriut. Kështu që, edhe në ditët e sotme mbetet një sfidë globale. Të dhëna të shkruara dhe elektronike tregojnë se në sektorë të ndryshëm pune, të punësuarit ballafaqohen me lëndime të llojeve të ndryshme, të shoqëruara në jo pak raste edhe me humbje të jetës së tyre në vendet e punës. Sot, edhe pse teknika, teknologjia dhe shkenca janë zhvilluar në shkallë të lartë, duke ofruar kushte në kryerjen e punëve në mënyrë më të lehtë, më të shpejtë dhe më të sigurt, megjithatë lëndimet dhe vdekjet në vende pune mbeten një sfidë e cila duhet të konsiderohet me prioritet nga çdo sistem dhe shoqëri.

Mund të themi se është e pa mundur që të arrihet siguri dhe mbrojtje absolute gjatë kryerjes së aktiviteteve në një vend pune. Një përgjigje e kësaj që theksuam më sipër, do të ishte parandalimi. Parandalimi do të ishte zgjedhja më e mirë, sepse i njëjti argumenton pohimin: “parandalimi është më i mirë se kurimi”.

Koncepti i parandalimit tanimë është një qasje e cila theksohet në direktiva të vendeve të Bashkimit Evropian, që paraqet në vete një qasje praktike ndaj problemeve të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë e shëndetit në punë. Kjo do të thotë se është me prioritet që të vlerësohen dhe analizohen vendet dhe proceset e punës për të identifikuar të gjitha rreziqet e mundshme, të cilat mund të jenë afatshkurtra dhe afatgjata, me qëllim që më pas të ndërmerren aktivitete, veprime dhe masa për parandalimin (shmangjen) e tyre, duke u mbështetur në praktika, teknika, teknologji dhe punë kërkimore shkencore.

Mbrojtja dhe siguria e shëndetit në punë nuk është një degë e re shkencore. Ajo është e vjetër po aq sa është edhe vetë njerëzimi, e aplikuar në praktikë me mënyra, metoda dhe mjete të kohës.

Në lidhje me mbrojtjen dhe sigurinë në punë, shënime të shkruara në nivelin global gjenden qysh në vitin 1437, ndërsa në nivelin rajonal, respektivisht në vendet e Ballkanit, ku ndodhet edhe vendi ynë, mbrojtja dhe siguria e shëndeti në punë zë fill në vitin 1833.

Në territorin e Kosovës mbrojtja dhe siguria e shëndetit në punë filloi të përcaktohet me dispozita ligjore që nga viti 1922. Në atë kohë, respektivisht në harkun kohor të viteve 1921-1922, ishte nxjerr ligji i parë për mbrojtje në punë. Pas përfundimit të luftës së dytë botërore, në vitin 1965, del ligji i mbrojtjes në punë. Këto të dhëna kanë rëndësi historike: e para për të treguar se mbrojtja në punë nuk është një lëmi e re, dhe e dyta, për të treguar se në atë kohë territori i Republikës së Kosovës (së sotme) ishte në kuadër të ish-sistemit juridik të Jugosllavisë. Sot, mbrojtja dhe siguria e shëndetit në punë në Republikën e Kosovës është e rregulluar me akte juridike.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila është akti më i lartë juridik në shkallë vendi, garanton të drejtën në punë dhe zgjedhjen e profesionit (neni 49), si dhe në nenin 51 thekson mbrojtjen shëndetësore dhe sociale. Pra, në mënyrë më të zgjeruar është theksuar

se e drejta në punë garantohet dhe secili person është i lirë të zgjedh profesionin dhe vendin e punës. Prandaj, në këtë këndvështrim, mund të themi se bashkë me të drejtën e garantuar për punë, është edhe e drejta për mbrojtje dhe siguri gjatë ushtrimit të veprimeve dhe aktiviteteve gjatë realizimit të një pune. Në përgjithësi mund të theksoj se Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka normuar mbrojtjen dhe sigurinë në punë, si një e drejtë e njeriut e cila realizohet përmes ndërmarrjes së masave dhe veprimeve që sigurojnë kushte të sigurt pune, mbrojtjen e shëndetit dhe mbrojtjen e integritetit fizik dhe moral. Më hollësisht, e drejta për mbrojtje dhe siguri në punë në Republikën e Kosovës është e rregulluar me ligje, udhëzime administrative, rregullore dhe aktet tjera juridike, të cilat rrjedhin apo detyrohen nga ligjet. Pra, siguria dhe shëndeti në punë është rregulluar në ligjin Nr. 04/L-161, qëllimi i të cilit është përcaktimi i masave për përmirësimin e shkallës së sigurisë dhe shëndetit të të punësuarve në punë. Sipas ligjit Nr. 04/L-161, siguria dhe shëndeti në punë definohej si pjesë përbërëse e organizimit të procesit të punës, duke ndërmarrë masat parandaluese, që kanë synim përmirësimin e kushteve të punës, mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, përmirësimin e ambientit të punës, mbrojtjen fizike dhe psikike të të punësuarve dhe të të tjerëve, që marrin pjesë në procesin e punës. Çështjes së mbrojtjes dhe sigurisë së shëndetit në punë kujdes i veçantë i është kushtuar edhe në ligjin Nr. 03/L-212, respektivisht në kreun VI, neni 42, në të cilin theksohet mbrojtja dhe siguria në punë. E një rëndësi të veçantë për sa i takon sigurisë dhe shëndetit në punë, është edhe rregullorja për kriteret minimale për mbrojtje dhe sigurinë e shëndeti në punë. Po ashtu, edhe kuadri institucional në të dy nivelet, në atë qendror dhe lokal, është mjaftë mirë i konsoliduar, si në aspektin hartimit të kuadrit ligjor (transpozim të direktivave të BE-së), po ashtu edhe në hartimin e strategjive, planeve të veprimit dhe ngritjes së kapaciteteve humane, për të menaxhuar dhe kontrolluar zbatimin e dispozitivave ligjore për sa i takon mbrojtjes dhe sigurisë së shëndetit në punë. Ndonëse ende kërkohet angazhim, koordinim, bashkëpunim ndër-institucional, përfshirë këtu institucionet akademike kërkimore shkencore, siç është në këtë rast UBT, është një nga institucionet e arsimit të lartë më kredibile, që ofron mundësi për të zhvilluar programe dhe projekte kërkimore për avancimin e lëmit të mbrojtjes dhe sigurisë në punë.

Po të kthehemi për të parë se cila është detyra e mbrojtjes dhe siguria në punë, atëherë themi se qëllimi kryesor i saj është parandalimi i numrit të vdekjeve, lëndimeve, sëmundjeve profesionale etj., në vendet e punës, si dhe humbjeve financiare dhe materiale të cilat janë apo mund të jenë rrjedhojë e vdekjeve, lëndimeve, sëmundjeve në vende pune, përfshirë këtu edhe përcaktimin e rregullave dhe sjelljet në mjedisin e punës.

Vendi i punës definohej ai vend pune ose ajo hapësirë, nën mbikëqyrjen direkte dhe indirekte të punëdhënësit, ku të punësuarit qëndrojnë dhe kryejnë veprimtari dhe aktivitete pune brenda një orari të caktuar kohor. Në përgjithësi, vendi i punës është një vend apo hapësirë, ku i punësuarit pjesën më të madhe të ditës e kalon aty. Mbrojtja në punë definohej si bashkësi e aktiviteteve teknike, juridike, shëndetësore, sociale, psikologjike, pedagogjike, etj., me ndihmën e të cilave parandalohet dhe minimizohet rreziqet të cilat mund të jenë potencial për rrezikimin e jetës dhe shëndetit të të punësuarve gjatë kryerjes së punëve në një vend pune. Ashtu siç janë të ndryshme profesionet dhe punët që bëjnë, po ashtu edhe vendet e punës janë të ndryshme.

Pra, dallohen në aspektin e paraqitjes së rreziqeve dhe masave të cilat duhet të ndërmerren për parandalimin e tyre. Në vendin tonë, ndër vendet e punës të cilat konsiderohen me shkallë të lartë rreziku janë: vendet e punës në miniera dhe në ndërtimtari, duke mos anashkaluar edhe sektorë të tjerë. Mirëpo, mbështetur në të dhënat nga raporte institucionale, të cilat kanë përgjegjësi dhe detyrë për të menaxhuar, kontrolluar, monitoruar dhe raportuar për mbrojtjen dhe sigurinë e shëndetit në punë, rezultoi se puna në sektorin e ndërtimit është me shkallë rreziku të lartë. Ky pohim argumentohet nga të dhënat zyrtare të publikuara në raporte të cilat, që nga viti 2000, e deri më sot, sektorin e ndërtimit e nxjerrin me numrin më të madh të të punësuarve, të cilët kanë humbur jetën dhe kanë pësuar lëndime në shkallë të ndryshme. Kështu, vetëm në këtë vit (2018), është raportuar se kemi 23 të punësuar të cilët kanë humbur jetën në vend pune në sektorin e ndërtimit. Kjo e dhënë dhe të dhënat nga vitet para-prake janë shqetësuese dhe sinjalizojnë apo janë një alarm, i cili duhet të dëgjohet me kujdes nga të gjitha institucionet me përgjegjësi direkte dhe indirekte për të ndërmarrë masa për parandalimin e tyre.

Pse vjen deri tek këto ngjarje/ndodhi me fatalitet, është vështirë të definohej me saktësi, për arsye se në këto ndodhi ndikojnë një numër i madh faktorësh. Pra, nuk kemi të bëjmë me vetëm një faktor, edhe sepse sipas të dhënave statistikore të publikuara, tregohet se “Faktori Njeri” tek lëndimet është i pranishëm në 90% të rasteve. Prandaj, me të drejtë psikologjia e punës shtrihet disa pyetje të cilat kërkojnë përgjigje: Pse ngjajnë lëndimet?, Cili është shkaku që njeriu të gabojë? Në mos ekziston tek individët prirja për lëndime?.

Për t’iu dhënë përgjigje pyetjeve të shtruarat janë bërë shumë matje dhe hulumtime, të cilat si përfundim kanë nxjerrë se lëndimet asnjëherë nuk ndodhin për efekt të një shkaku. Si përfundim, del se lëndimet janë kombinim i shumë rrethanave që favorizojnë ndodhjen e lëndimit, apo janë të paraqitura në të njëjtën kohë. Në anën tjetër, çdo aksident ndodh për shkak të gabimeve, e ato vijnë nëse i punësuarit nuk di të punojë sigurt, nuk mund të punojë i sigurt dhe nëse nuk do të punojë i sigurt. Si konstatim, nga kjo që theksuam më lartë, del të jetë se aksidentet të cilat sot ndodhin në vende pune në sektorin e ndërtimit në vendin tonë lidhen me to. Pra, ka të punësuar në sektorin e ndërtimit të cilët nuk dinë të punojnë sigurt. Ky pohim mbështet në praktikën e moshës së të të punësuarave në sektorin e ndërtimit, ku vlerësohet se mbi 60% janë me moshë të re (17-35 vjeç), dhe si të tillë, të rinjtë kanë më tepër prirje të vetëbesimit, i mbivlerësojnë mundësit e veta dhe nuk kujdesen aq për rreziqet, pra kanë prirje për të sjell veten në rrezik. Pra, janë më pak vigjilent, nuk vlerësojnë si dhe sa duhet rrezikun dhe pasojat që mund t’i kenë prej tij. Element tjetër pse ata nuk dinë të punojnë sigurt është edhe përgatitja profesionale (p.sh. shkolla profesionale teknike ndërtimore, etj.), apo arritja e shkathtësive teknike dhe operative për të punuar sigurt, përmes trajnimeve e formave të tjera.

Pse nuk mund të punojnë sigurt? Përgjigja në këtë pyetje gjendet tek punëdhënësi, i cili ka për detyrë dhe përgjegjësi (sipas Ligjit Nr. 04/L-161, Nr.03/L-212 etj.) të sigurojë kushte pune me standarde të cilat parandalojnë lëndimet, aksidentet me fatalitet, etj. Një ndihmesë apo kontribut i theksuar në këtë përgjigje do të vinte nga shtimi i intensitetit të kontrollit dhe monitorimit nga ana e inspektoratit të punës në nivel qendror dhe lokal në kantier ndërtimi (vendpunishte). Nuk do të punojë sigurt? Përgjigja për këtë pyetje do të gjendet me kombinim të një vargu veprimesh, si —

Trendët e rinj të zhvillimit të kurrikulave të Shkencave Kompjuterike, të orientuara drejt kompetencave



Dr. Krenare Pireva

Duke analizuar trendët e rinj të zhvillimit të teknologjisë dhe ndryshimet e teknologjive ekzistuese në mënyrë mjaft rapide, shihen qartë ndryshimet e kërkesave të tregut të punës, dhe si rrjedhojë e gjithë këtij evoluimi, ndihet edhe reflektimi i këtyre kërkesave për posedimin e kompetencave të reja të të mësuarit në kurrikulat e shkencave kompjuterike.

Nga aspekti akademik, një ndjekje e ndryshimeve kaq rapide është mjaft sfiduese kur kemi të bëjmë me planifikimin, përkatësisht implementimin e kurrikulave të reja në domenin e shkencave kompjuterike dhe parashikimet afatgjate që duhet vlerësuar.

Bazuar në [ref] punësimi i individëve që posedojnë kompetencat e TIK-ut është e renditur në top 5 pozitat më të larta, megjithatë hulumtimet e fundit nga aktorë të ndryshëm, qoftë hulumtues individualë, organizata qeveritare apo joqeveritare [ref], kanë theksuar se shumë individë që kanë përfunduar studimet e tyre nuk janë në gjendje të dëshmojnë posedimin e këtyre kompetencave, të cilat parashihen të transferohen gjatë ciklit përmblyës të kurrikulave të këtyre disiplinave. Se a është problemi esencialisht tek mungesa e trajtimit të këtyre kompetencave në kuadër të akademisë, apo metodologjive të mësimdhënies, të cilat ende janë duke u ofruar në mënyrë klasike, ajo ende është duke u diskutuar. Por, mjafton të keni kontakt me kompanitë lokale apo rajonale, dhe të gjitha njëzëri theksojnë mungesën e kompetencave adekuate, të cilat do të favorizonin të diplomuarit për tregun lokal, rajonal, apo edhe atë global. Kjo pasi që, vendet e reja të punës u kërkojnë të rinjve të diplomuar të punojnë në një mjedis industrial që përdoret teknologji e përparuar, me ç'rast aludohet se këto njohuri/kompetenca tanimë veç janë të fituara gjatë studimeve të tyre. Problemi vjen e theksohet sidomos kur studentët e diplomuar ekspozohen ndaj projekteve me probleme reale, që rrjedhin nga shoqëria, si dhe nga industrinë në të cilat duhet pasur qasje sipas të menduarit kritik, për të ofruar zgjidhje inovative për të gjitha këto probleme.

Ndryshueshmëria mes kërkesave të tregut të punës, dhe asaj se çka institucionet edukuese janë duke ofruar, çdo vit është duke u theksuar më shumë, ndërkaq industria dhe asociacionet e ndryshme të teknologjisë, këtë çështje vetëm se e kanë ngritur si një problem me të cilin duhet të merremi qysh tani, duke identifikuar problemet veç e veç, si dhe pasojat ndërlikuese që mund të përjetojmë, në rast të identifikimit të rrezikut dhe mosndërmarrjes së hapave të duhur për të lokalizuar problemin, përkatësisht për ta kontrolluar atë. Problemet më të mëdha që janë identifikuar në shumë forume, konferenca dhe në shumë diskutime të tryezave të rumbullakëta, mund të kategorizohen si: (i) studentët e disiplinave inxhinierike kanë mangësi në shkathtësi të buta, (ii) të posadipomuarit nuk janë të gatshëm për kërkesat e tregut dhe (iii) tranzicioni nga akademia në industri është shumë i ngadalshëm, duke pasur parasysh mungesat e aftësive për të punuar në grupe, neglizhenca e shkathtësive të buta dhe fokusi i tyre vetëm në shkathtësitë e forta (ndoshta edhe jo sipas trendëve më të rinj), fokusi i tyre vetëm teknik e assesi trajtimi i problemeve nga perspektiva interdisciplinare, pamundësia për të ndjekur trendët e teknologjive të reja, mungesa e materialeve relevante, etj.

p.sh: identifikimi i elementeve që e shtyjnë të punësuarin, pra pse ai/ajo “nuk dëshiron të punojë sigurt” (njohuria e pamjaftueshme, sëmundje, pakënaqësi shpirtërore, etj.), ndërrimi i pozicionit të punës-vendit të punës, trajnimit teorik, praktik dhe testit të njohurive, masave sociale etj., dhe nëse pas këtyre masave nuk do të vërehej ndonjë përmirësim, do të duhej të nxirrej nga aktivitetet ndërtimore dhe të rekomandohej për ndonjë aktivitet në sektorë të tjerë.

Në përgjithësi, mund të themi se disa nga faktorët e mundshëm të cilët shpijnë në lëndime, fatalitet dhe ndikime në funksione psikologjike në një vend pune, janë: aftësia, karakteristikat e personalitetit, kushtet e mjedisit të punës, mjedisi social i punës, motivimi për punë, qëndrimi, gjendja psikofizike të organizmit, etj. Në kuadër të faktorëve, një rëndësi të veçantë ka edhe lodhja, ku sipas disa statistikave, rezultojnë se 25% e fatkeqësive vijnë nga lodhja. Po ashtu, shqetësimi i tepërt, kënaqësia dhe pakënaqësia i sjellin lëndimet. Sipas statistikave, rezultojnë se rreth 50% e lëndimeve janë nga depresioni shpirtëror. Përdorimi i pijeve alkoolike në vende pune (në veçanti në ndërtimtarë, ku puna është në lartësi dhe thellësi), sjell shkallë të lartë rreziku, jo vetëm për të punësuarin në gjendje të dehur, por edhe për të punësuar të tjerë dhe për mjedisin rrethues në përgjithësi. Rol të rëndësishëm luan edhe udhëheqja. Udhëheqja joadekuate sjell pakënaqësi të të punësuarit dhe si efekt i këtyre pakënaqësive vjen deri tek lëndimet dhe aksidentet e tjera. Pra, në një masë të vogël apo të madhe, këta janë disa nga treguesit të cilët dërgojnë ose edhe janë duke dërguar në lëndime, vdekje dhe elemente të tjera të të punësuarave në sektorin e ndërtimit. Ka mendime se 98% e lëndimeve në vende pune mund të parandalohen. Për sa më lartë, tejkalimi apo për të dhënë përgjigje afatgjate me qëllimin e vetëm për të parandaluar dhe minimizuar sa më shumë numrin e të lënduarve dhe vdekjeve në sektorin e ndërtimit në shkallë vendi, do të duhej të ndërmerren masat si në vijim: organizative, teknike, sociale, pedagogjike, psikologjike, ergonomike, etj.

Si përfundim:

- Sektori i ndërtimit në shkallë vendi mbetet me shkallë të lartë të rrezikut;
- Ka një shqetësim sa i takon trendit në rritje të vdekjeve dhe lëndimeve në vendet e punës;
- Mungesa e investimeve nga punëdhënësit në organizmin e trajnimeve për të punësuarit;
- Në shumë situata punëdhënësit nuk aplikojnë masat e mbrojtës për sigurinë e shëndetit në punë;
- Në shumë raste punëdhënësit nuk zbatojnë dispozitat ligjore për siguri në punë;
- Ka mungesë të kontrollit dhe monitorimit nga ana e inspektoratit të punës në kantiere ndërtimi;
- Ka mungesë të planeve për mbrojtje dhe sigurinë e shëndetit në punë në kantier ndërtimi;
- Mungesë e bashkëpunimit institucional dhe institucioneve të arsimit të lartë për gjetjen e zgjidhjeve teknike, teknologjike dhe shkencore, të cilat do të parandalonin lëndimet dhe aksidentet në punë;

Disa rekomandime:

- Rritja e shkallës së kontrollit dhe monitorimit nga inspektorati i punës;
- Zbatimi i dispozitave ligjore nga punëdhënësit dhe të punësuarit;
- Investime më të mëdha nga punëdhënësit në masat parandaluese për mbrojtje dhe sigurinë e shëndetit në punë;
- Hartimi i planeve për mbrojtje dhe siguri në punë nga punëdhënësit;
- Punëdhënësit të ndërmarrin masa për trajnime profesionale dhe masa e veprime konkrete për mbrojtje në punë;
- Rritja e shkallës së koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, institucioneve të arsimit të lartë dhe punëdhënësve, në gjetjen e zgjidhjeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit në punë;

Andaj, në këtë aspekt, ekspertet e fushave të apostrofuara aludojnë se problemet siç janë, puna në grupe, njohuritë interdisciplinare, kompetencat për të aplikuar principet teorike dhe praktike në problemet reale, mund të minimizohen, vetëm atëherë kur do të kemi një komunikim të standardizuar dhe intensiv në mes akademisë dhe industrisë, si në fazën e krijimit të kurrikulave, ashtu edhe në atë të implementimit të saj. Përfshirja e industrisë brenda universiteteve dhe përfshirja e problemeve reale në mësimdhënie, përkatësisht reaktiviteti dhe proaktiviteti ynë ndaj trendëve të zhvillimeve teknologjike, do të pasuronte edhe me shume nivelin profesional dhe etik të të gjithë aktorëve me interes, duke filluar nga studentet, e deri tek mësimdhënësit.

Andaj, duke u bazuar në çështjet e theksuara më lartë, mendojmë se qasja e krijimit të kurrikulave të reja, të orientuara në kompetencat e kërkuara, gjithëherë në bashkëpunim me industrinë, është mjaftë e qëlluar. Këto kompetenca do t'ju ofronin studentëve të niveleve të ndryshme mundësi të reja të krijimit të njohurive që janë të kërkuara në treg, ngritje të shkathtësive të buta dhe të forta, për të trajtuar në mënyrë adekuate problemet reale, si dhe shkathtësi të të menduarit kritik për të ofruar zgjedhjen e problemeve në mënyrë sa më efikase dhe të qëndrueshme. Këto përvoja të trashëguara nga ambientet punuese do të merreshin drejtpërdrejt nga industria. Andaj, qëllimi kryesorë në modelimin, përkatësisht krijimin e kurrikulave të reja në të ardhmen, do të duhej të lidhej ngushtë me kërkesat e kompetencave të tregut të përshtatura nga industria, me inkuadrimitin e sugjerimeve të asociacioneve inxhinierike, që kanë një reputacion të lartë në domenin tonë dhe specifikisht me kornizat e modeluara lidhur me kompetencat afatgjate që duhet të posedojë një inxhinier i ardhshëm. Ky qëllim do të përmbushej në mënyrë edhe më efikase, sikur të ofronim kurse përmes metodologjive “problem orient-ed”, duke ngritur interdisciplinartetin e kurrikulave prej vitit në vit, dhe duke ndjekur trendët e zhvillimeve të reja të teknologjisë.

Në këtë drejtim, strategjia e UBT-së, përkatësisht e Shkencave Kompjuterike, me misionin dhe vizionin e saj të qëndrueshëm, gjithmonë përpiqet të parashikojë zhvillimet e reja në kohë afatgjate dhe tenton t'i integrojë ato parashikime në çdo propozim të ri të kurrikulave. Këto strategji do të parashikonin sfidat e të diplomuarve, e sidomos gjatë fazës së tranzicionit nga akademia në industri. Në këtë aspekt, UBT, si pjesë të kuadrit të saj posedon ekspertet të fushave që do të ndihmonin stabilizimin e sistemit të edukimit të Kosovës, për të trajtuar çështjet e lartcekura dhe për të balancuar nevojën me kërkesën.

Kjo mund të dëshmohej nga studentët dhe të diplomuarit e Shkencave Kompjuterike dhe Inxhinierisë, të cilët janë në gjendje të përshtaten shpejt me nevojat e tregut të punës, posaçërisht ndaj kërkesave të industrisë. Studentet tanë, pas përfundimit me sukses të studimeve të tyre, janë në gjendje të përshtaten ndaj teknologjive të reja, sepse metodologjia e ofruar e mësimdhënies thekson lartë krijimin e njohurive të reja, mirëpo edhe krijimin e shkathtësive të studentëve për t'ju përshtatur ndryshimeve të shpejta të teknologjive, duke theksuar rëndësinë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.





INTERNATIONAL KNOW HOW TRANSFER AND TECHNOLOGY IN MY COUNTRY

International Memberships:

- EOQ - European Organization for Quality
- IPMA - International Project Management Association
- IFAC - International Federation for Automatic Control
- ITA - Information Technology for Automotive Industry
- Tempus Projects
- Erasmus Mundus Project
- SEECCEL - South East European Countries Entrepreneurship Learning
- PLAN - Procurement Law Academic Network
- AESOP - Association of European Schools of Planning
- EUROSIM - Federation of European Simulation Societies

Education

Higher education for Bachelor and Master level in several disciplines
Training and Professional Education
Non-formal Education

Certifications

Systems Certification
Certification of Persons
Offering price (for Excellence, Entrepreneur, E - Technology, Leadership, Management, etc.)

Certifications

Professional Consulting
Professional supervision
Products and systems Development (Design)
Project Management

Research

Applied Research
Opinions Research
Scientific Research

Publications

Newspaper: UBT News
Journal of graduates: Alumni
Science Journal: International Journal for Business and Technology,
University and Professional Books
Books Papers presented at conferences in UBT
Masters and Doctorate threads
Publications of a Professional and scientific field

-  **ITALY**
- Polytechnic University of Milan
 - University of Cassino and Southern Lazio
 - Polytechnic University of Milan
 - Accordi di cooperazione accademica, Torino
 - University of Milan
 - Parthenope University of Naples
 - Università degli studi di Cassino, Facoltà di Ingegneria

-  **CZECH**
- Republic University of Pardubice
 - Masaryk University
 - University of Economics, Prague
 - Technology agency - Czech invent, Prague

-  **FRANCE**
- CIFE - Centre international de formation européenne, Nice
 - European Institute of High International Studies, Nice
 - Université de Nice Institut du droit de la paix et du développement
 - University of Nice Sophia Antipolis
 - University of Limoges
 - École nationale d'administration (ENA), Strasbourg
 - Institut des Hautes Etudes Internationales - Université Paris
 - University of Montpellier
 - Master de Manadement Intercultural a l'universite' de Limoges

-  **BULGARIA**
- Bulgarian Diplomatic Institute - Ministry of foreign affairs
 - Bulgarian Academy of Science - CLMI-BAS, Sofia
 - The Diplomatic Institute To the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Bulgaria
 - European Polytechnical University (Erasmus +)
 - Technical University Sofia (Erasmus +)
 - Bulgarian Diplomatic Institute

-  **SPAIN**
- Madrid School of Marketing, Madrid

-  **GREAT BRITAIN**
- City, University of London
 - Institute for Manufacturing - IFM, University
 - University of Cambridge
 - The University of Edinburgh
 - Staffordshire University
 - College of I.T & Ecommerce (CITEC)

-  **AUSTRIA**
- Vienna University of Technology
 - Institute for Handling Device and Robotics - IHRT - TU Wien
 - University of Salzburg
 - Diplomatic Academy of Vienna
 - Donau-Universität Krems
 - University of Innsbruck
 - University of Applied Sciences
 - Vienna University of Economics and Business
 - WUS Austria
 - Institute for Business Promotion - WIFI
 - ARGESIM
 - Institute for Danube Region and Central Europe - IDM
 - Quality Austria
 - One point Software GmbH
 - BOC Information Systems GmbH
 - TUEV Austria
 - Institute for Analysis and Scientific Computing
 - Department für Raumentwicklung, Infrastruktur und Umweltplanung,
 - Fachbereich Regionalplanung und Regionalentwicklung - TU Wien*
 - Institut f Analysis und Scientific Computing d TU Wien
 - Fachhochschul-studiengänge der wirtschaft, Viena Studiengang marketing & sales
 - Vienna School of International Studies
 - Wirtschaftsförderungsinstitut (WIFI)
 - ASIM (Arbeitsgemeinschaft Simulation in der Gesellschaft für Informatik GI Bestattung zum Beitritt ASIM)
 - Department für Raumentwicklung, Infrastruktur und Umweltplanung,
 - Fachbereich Regionalplanung und Regionalentwicklung

-  **USA**
- Oakland University Michigan
 - The California State University San Bernardino
 - University of Rochester
 - St.John's University School of Law
 - Embry-Riddle Aeronautical University, Prescott Arizona
 - Tiffin University, tiffin, Ohio
 - Iowa University
 - General Motores
 - General Electrics
 - University of Kentucky
 - DELMIA

-  **PORTUGAL**
- University of Minho, Civil Engineering Department, Braga
 - Universidade Nova de Lisboa

-  **SLLOVAKIA**
- University of Technology in Bratislava,
 - Spectra Centre of Excellence of the EU Bratislava

-  **SWITZERLAND**
- IPMA (International Project Management Association) and Kosova Association for Management
 - Università degli Studi di Genova-UNIGE

-  **MOLDOVA**
- State Chancellery Republic of Moldova
 - Special Telecommunication Center

-  **IRELAND**
- Waterford Institute of Technology WIT, Ireland
 - Universitu of Limerick, Limerick
 - University College Cork-UCC

-  **CANADA**
- University of Manitoba

-  **SWEDEN**
- Linnaeus University

-  **FINLAND**
- Lappeenranta University of Technology

-  **NORWAY**
- Gjøvik University College

-  **NETHERLANDS**
- University of Twente
 - Van Hall Larenstein University of Applied Sciene, Stichting Van Hall Larenstein, Velp


-  **TURKEY**
- Kadir Has University: Istanbul
 - Mimar Sinan University of fine Arts - Fındıklı Istanbul: Istanbul
 - Polytechnic University of Izmir
 - Turkish Standard Institute, Ankara
 - Fatih University, Istanbul
 - Pamukkale University (Erasmus +)
 - Marmara University (Erasmus +)

-  **CROATIA**
- University of Rijeka
 - University of Split, Split
 - Hungary
 - Pázmány Péter Catholic University, Budapest
 - Corvinus University of Budapest
 - Szent István University, Budapest
 - University of Pécs, Pécs
 - Budapest University of Technology and Economics
 - Faculty of Geodesy, University of Zagreb (MoU)
 - Institut IGH d.d. from Zagreb

-  **ROMANIA**
- University of Bucharest, Bucharest
 - Technical University of Cluj-Napoca
 - University "Gheorghe Cristea" - Bucuresti

-  **GERMANY**
- Freie Universität Berlin
 - Dortmund Univesitz of Technolozg, Dortmund
 - Munich Univesitz of Technology
 - Deutsche Gesellschaft für Technische Zusammenarbeit, Berlin
 - SIEMENS, Munich
 - FESTO, Germany
 - University of Freiberg
 - Anhalt University of Applied Science, Architecture - Faccul ty Management, Kothen
 - Rwth Aachen University
 - Hochschule Offenburg
 - Institut für Keramik, Glas- und Baustofftechnik
 - Arbeitsgemeinschaft Simulation (ASIM)

-  **ALBANIA**
- University of Tirana
 - Univesity of Vlora "Osmail Qemajli, Vlorë
 - University of Shkoder
 - Politechnic University of Tirana
 - Academy of Science in Albania
 - University "Marin Barleti, Tirana
 - Aleksandër Moisiu university, Faculty of Professional Studies, Durrës
 - Polis University, Tirana
 - European University of Tirana
 - Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike
 - Universiteti "Fan S. Noli" Korçë

-  **SLOVENIA**
- Primorski Tehnološki Park-Nova Gorica
 - Stajerski Tehnološki Park-Maribor
 - Technology park Ljubljana
 - International School for Social and Business Studies, Celje

-  **BOSNA AND HERCOGEVONA**
- University of Sarajevo
 - University of Tuzla

-  **MACEDONIA**
- State University of Tetova
 - South East Europea University, Tetovo
 - University "St. Kliment Ohridski" Bitola
 - University of Cyril and Methodius- Skopje-SIGMA
 - Login Electronics Skopje
 - "Mother Tereza" University Skopje

-  **INDONESIA**
- ITS - Institute of Technology Sepuluh

-  **MONTENEGRO**
- University of Montenegro, Faculty of Architecture, Podgorica

-  **SERBIA**
- University of Nis-EM2STEM
 - University of Novi Sad -EM2STEM

-  **LATVIA**
- Latvia University of Agriculture

-  **LITHUANIA**
- Vilniaus Kolegija/University of Applied Sciences (Erasmus +)

-  **HUNGARY**
- Pázmány Péter Catholic University, Budapest
 - Corvinus University of Budapest
 - Szent István University, Budapest
 - University of Pécs, Pécs
 - Budapest University of Technology and Economics

-  **SOUTH KOREA**
- Korean Advanced Institute for Science and Technology, Seoul

-  **JAPAN**
- Bankyo University-Japan

-  **POLAND**
- University of Warsaw
 - University of Wrocław
 - Pawel Wlodkowic University College of Plock



- 17 vite Lider i Arsimit të Lartë - I vetmi i çertifikuar për ekselencë (EFQM)
- I çertifikuar sipas standardit ISO 9001:2008 për cilësi
- Përfutës për herë të katërt nga Kosova i Programit Evropian ERASMUS MUNDUS
- Përfutës i Programit për bursa AEP, Albach
- Përfaqëson Kosovën në Organizata Evropiane dhe Botërore
- Kampion Evropian në Robotikë
- Kampusi i parë për Shkencë dhe Inovacion

ZGJEDH MË TË MIRIN QË TË BËHESH MË I MIRI!

Come to UBT and Go International...

PROGRAMET E AKREDITUARA

SHKENCA KOMPUTERIKE DHE INXHINIERI

- Inxhinieri e Sistemeve Softuerike
- Baza e të Dhënave dhe Sistemet e Informacionit
- Grafika Kompjuterike dhe Multimedia
- Web Programim
- Rrjeta dhe Telekomunikacion
- Robotikë dhe Sistemet Inteligjente
- Informatikë Biomjekësore
- Siguria dhe Sigurimi i Informacionit
- Multimedia dhe Vizualizim
- Inxhinieri e Komunikimit
- Shkenca e të Dhënave Statistikore
- Informatikë Mjekësore

MENAXHMENT, BIZNES DHE EKONOMI

- Financa, Banka dhe Sigurime
- Kontabilitet, Auditim dhe Tatime
- Marketing dhe Shitje
- Menaxhment, Ndërmarrësi dhe Inovacion
- Biznes Ndërkombëtar
- Logjistikë dhe Menaxhim i Prokurimit

MEKATRONIKË DHE MENAXHMENT

- Menaxhim i Mekatronikës
- Automatizim Industrial dhe Kontrolli i Procesit
- Robotikë dhe Sisteme Inteligjente
- Inxhinieri Biomjekësore
- Inxhinieri e Telekomunikacionit
- Inxhinieri Mekanike
- Inxhinieri e Aeronautikës
- Dizajn i Produkteve Industriale
- Inxhinieri e Proceve të Prodhimit

SISTEMET E INFORMACIONIT DHE MENAXHMENT

- Sistemet e Informacionit të Biznesit
- Sistemet e Informacionit - GIS (Geo Information Systems)
- Sistemet e Informacionit të Bibliotekave dhe të Arkivave
- Statistika, Procesimi dhe Simulimi i të Dhënave
- Siguria e Informacionit dhe Privatësia
- Komercit Elektronik (E-Komerc)

ARKITEKTURË DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR

- Arkitekturë e Qëndrueshme
- Menaxhim Urban
- Restaurim Arkitekturor
- Dizajn i Interierit

INXHINIERI NDËRTIMOR (NDËRTIMTARI) DHE INFRASTRUKTURË

- Inxhinieri Strukturore - Konstruktiv
- Menaxhim i Ndërtimtarisë dhe Teknologjisë
- Infrastruktura Rrugore
- Inxhinieri e Ujrave - Hidro
- Inxhinieri e Gjeoteknikës
- Inxhinieri e Materialeve

SHKENCA POLITIKE

- Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci
- Integritet Evropiane
- Administratë Publike

JURIDIK

- Civile
- Penale
- Ndërkombëtare

E DREJTA BIZNESORE NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE

MEDIA DHE KOMUNIKIM

- Gazetari
- Komunikim
- Menaxhimi i Medias
- Marrëdhënie me Publikun
- Regjia Televizive
- Gazetaria On-Line
- Kamera dhe Fotografia

POLITIKA PUBLIKE DHE MENAXHIM

- Politika Publike
- Menaxhimi Publik

INXHINIERI E ENERGJISË

- Bazat e Burimeve të Energjisë
- Ruajtja e Energjisë
- Energjia Efiçiente
- Teknologjia e Informacionit
- Menaxhimi i Energjisë
- Elektrikë Elektronikë
- Sistemet e Qëndrueshme
- Izolimi i Ndërtesave
- Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes

INXHINIERI E ENERGJISË EFIÇENTE

- Burimet e Energjisë
- Konzervimi i Energjisë
- Efiçenca e Energjisë
- Menaxhimi i Energjisë
- Inxhinieri Elektrike
- Konzervimi i Energjisë në Ndërtesa
- Sistemet e Ngrohjes dhe Ftohjes
- Energjia Gjeotermike

INFERMIERI

FARMACI

STOMATOLOGJI

DIZAJN I INTEGRUAR

- Dizajn Grafik dhe i Komunikimit
- Dizajn Mode dhe Tekstil
- Dizajn i Produkteve
- Dekorim i Ndërtesave dhe Mobilimi

SHKENCAT E USHQIMIT DHE BIOTEKNOLOGJI

- Teknologji e Ushqimit
- Nutricion (Të Ushqyerit)
- Menaxhimi me Cilësinë dhe Sigurinë e Ushqimit

REGJISTRIMI

Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

Diploma, dëftesat e notave, certifikata e pikëve të maturës, certifikata e lindjes dhe kopja e letërnjoftimit.

Gjuha e studimeve:

Gjuha Shqipe dhe Gjuha Angleze si dhe mundësia e studimit në gjuhë të tjera.

Mënyra e studimit:

UBT organizon ligjërata të rregullta dhe me korrespondencë, si dhe ofron mundësinë e studimit në distancë. Për të punësuarit ofrohen ligjërata pas orarit të punës dhe gjatë fundjavës.

Që suksesit juaj të jetë i garantuar, UBT ofron për secilin studentë:

- Orientim profesional, kurse përgatitore, praktika profesionale, vizita studimore dhe çertifikime ndërkombëtare
- Sistem online dhe qasje në kompjuterë
- Licensa falas për softuer
- 100% Internship në kompanitë dhe institucionet më prestigjioze vendore dhe ndërkombëtare
- Libraria me numrin më të madh të titujve dhe qasja online në libraritë më të mëdha elektronike
- Praktika dhe Eksperimente në Laboratorë bashkëkohorë.
- Trajtime: CISCO, Microsoft, AutoCad, ECDL, IPMA etj.
- Çertifikime për kontabilitet në bashkëpunim me SCAAK

Financat dhe pagesat:

- Çmimi i studimeve për një vit akademik Bachelor është 1200 €, për nivelin Master është 1500 € me mundësi pagese deri në 12 kështe.
- Për të gjithë nxënësit e dalluar UBT ofron bursa studimi.

UBT ofron zbritje deri në 50% edhe për këto kategori:

- Të punësuarit në Doganat e Kosovës
- Pjesëtarët e FSK-së dhe Policisë së Kosovës
- Të punësuarit në Institucionet Publike të Kosovës
- Familjarët e dëshmorëve dhe veteranëve të luftës
- Studentët që vijnë nga e njëjta familje dhe si grup
- Studentët që paguajnë në fillim të vitit akademik
- Studentët e punësuar në Policinë e Kosovës
- Studentët me sukses të shkëlqyeshëm
- Studentët të cilët kanë arritur 100% në testin kombëtar dhe kanë të gjitha 5 në shkollimin paraprak
- Studentët e Luginës së Preshevs, Malit të Zi
- Studentët që marrin pjesë në programin përgatitor të maturës